# Rruga Arbërit

GAZETË E PAVARUR. NR. 5 (61). MAJ 2011. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO

**Market KEN**

*Laprakë, Tiranë*
*Tel: +355 4 22 50 480*
*Cel. 068 20 36 394*


FESTIVALI

## 150 artistë sjellin këngën qytetare

Nga: **DR. FEJZULLA GJABRI** - FAQE 14

INTERVISTË

## T'u mësojmë fëmijëve të flasin shqip

Nga: **DR. JORGJI MUZAKA** - FAQE 8-9

LETËRSI

## Miti i Mërkunës së zezë "dita e Martë"

Nga: **DR. ROVENA VATA** - FAQE 11

HOMAZH

## Lamtumirë Balzaku shqiptar!

Nga: **ALI HOXHA** - FAQE 23

**SHËNIM**

## Suksese Maturantë!

*Nga:* **NERILDA MEDA**

Edhe disa ditë kanë mbetur për të finalizuar vitin shkollor 2010-2011 në shkollat e vendit dhe në sytë e nxënësve arrin të dallosh dy emocione të forta: lumturinë e mbylljes me sukses të njërës nga etapat e shumta të jetës, si dhe frikën e provimeve për në universitete. Por ndonëse janë larguar më herët nga bankat e shkollës për të përqendruar vëmendjen e tyre drejt studimit intensiv, maturantët vazhdojnë të jenë në qendër të vëmendjes, pasi kanë detyrën e vështirë të kalimit me sukses të punës katërvjeçare si dhe caktimin e studimeve për të ardhmen.

Por edhe pse maturantët janë në qendër të vëmendjes, ata nuk janë të vetmit, pasi edhe klasat e 10-ta dhe të 11-ta do të përballen me disa sfida më të lehta, pasi janë klasat që u është futur për herë të parë sistemi i ri i vlerësimit. Një sistem i ri vlerësimi sipas modelit perëndimor ka filluar të aplikohet dhe në vendin tonë, në të gjitha gjimnazet e vendit. Ky sistem i ri ka çorientuar në radhë të parë nxënësit që nuk dinë se ku të përqendrohen, pastaj dhe mësuesit që janë përballur me një gjë të re. Ky sistem konsiston në vlerësimin e nxënësit me provime, që mban peshën 50%, në përgjigje ditore 40% dhe në projekte 10%. Kështu që, nxënësit ndryshe nga vitet e tjera, përveç provimeve duhet të punojnë edhe shumë projekte, të cilat kërkojnë punë dhe përkushtim. Gjithashtu, secili nga gjimnazistët duhet ta ketë të qartë profesionin që dëshiron të kryejë në të ardhmen, pasi duhet të bëjë zgjedhje korrekte të lëndëve, që do të mbajnë koeficientin më të lartë në universitet.

Por, kudo ku ka rini - ka lumturi, ka emocione, ka dhe ankth. Na ngelet vetëm t'u japim kurajo gjimnazistëve, sidomos maturantëve, për të vazhduar drejt finales së këtij labirinti. Të urojmë që maturantët tanë të shënojnë "gol" në penalltinë e parë të jetës së tyre, duke pasur kështu mundësinë e zgjedhjes së profesionit të dëshiruar, për t'u kthyer vlerësimin shkollave ku kanë studiuar dhe mësuesve të tyre, por edhe për t'u dhënë shpresë dhe besim maturantëve të ardhshëm.

Suksese Maturantë!

** Gjimnaziste në gjimnazin "Sami Frashëri", Tiranë*

# Varfëri mbi pasuri

Bulqiza, një minierë ari për të tjerët dhe një plagë dhembjeje për banorët e saj. Historia e qytetit të paradoksit, aty ku në përpjekje për mbijetesë ekonomike, njerëzit bëjnë pakt me vdekjen. Plaga sociale nuk kursen as një: burrat, gratë dhe fëmijët...

*Nga:* ***ULKIE SINANI***

Me një grup të vogël miqsh e shokësh udhëtojmë me një fuoristradë në drejtim të qytetit të vogël të Bulqizës. Qëndrojmë pak çaste përpara teqesë bektashiane për të nderuar dervishin që fle aty në banesën e tij të përjetshme, e cila u rrezikua të shembej për shkak të hapjes së rrugës së re. Banorët kundërshtuan që teqeja të prishej dhe falë tyre ajo qëndron si fitimtare mbi truallin në të cilin lëshoi rrënjë shumë e shumë vite më parë. Vijojmë edhe ca kilometra në rrugën me asfalt që gjarpëron mes kodrash të buta për të mbërritur në qytetin e minatorëve. Zbresim nga makina dhe pasi vëmë shallet dhe dorashkat për t'u mbrojtur nga era e fortë që e karakterizon këtë qytet, fillojmë të ngjitemi në malin e Duriçit ku është dhe miniera. Na shoqëron një vendas, rreth të dyzetepestave. Ai është një qytetar fjalëpakë, por i zgjuar, njohës i mirë i zonës, banorëve dhe i minierës. Gjej rastin ta pyes për kohën kur është zbuluar kromi, "thesari" i këtij qyteti të varfër. Ai më shpjegoi se tregtia e kromit nisi që në vitet tridhjetë. "Ishin italianët që e kanë diktuar këtë thesar që u kishte rënë për hise pasardhësve të Kastriotëve. Hamit Boriçi, banor i fshatit Vajkal të Bulqizës, teksa po kulloste bagëtinë gjen një gur të zi me shkëlqim gjysmëmetalik, më i rëndë nga të tjerët, të cilin ia dorëzon një oficeri italian. Italianët kërkuan nga banorët që të mblidhnin këta gurë të veçantë.

*(Lexoni ne faqen 2-3)*

## Urdhri "Mjeshtër i Madh" për Liri Rashën

**Liri Rasha u shfaq si një talent i rrallë në interpretimin e këngës popullore dhe posaçërisht si një dukuri e rrallë në interpretimin e këngës dibrane. Ajo hyri fare natyrshëm në skenën madhështore të artit popullor, me një shkëlqim vezullues dhe do të mbetet si një relikt e përjetshme në piedestalin historik të saj**

**SPECIALE FAQE 12-13**

**NË BRENDËSI:**


### Gurëgdhendësi që nderohet në të gjithë Zakynthos-in

FAQE 8

### 77 maturantët që do të nderojnë emrin e shkollës "Sarina"

FAQE 5

### Vendi ku populli përulet para dëshmorëve

FAQE 4


cyan magenta yellow black 1

Posta e Rruga Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 5 (61). 1 - 31 Maj 2011

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës. Shkrimet priten në redaksi deri më **datë 20** të muajit.
Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**
**JU LUTEMI, QË SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAILIT, TË KENË PATJETËR ZANOREN "Ë".**
Gazeta publikohet falas në internet me datë 7 të muajit pasardhës.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!



DREJTOR:
Rakip Suli

KËSHILLI BOTUES:
Musa Riçku
Shaqir Skarra
Bujar Karoshi

Kontribuan për këtë numër:

Ulkie SINANI
Bernard ZOTAJ
Jorgji MUZAKA
Rexhep TORTE
Fejzulla GJABRI
Xhafer MARTINI
Rovena VATA
Gjokë BECI
Përparim TOMÇINI
Naim PLAKU
Selman MEZIU
Bujar PLLOSHTANI
Mentor HOXHA
Mevlud BUCI
Ali HOXHA
Zabit LLESHI
Xhelal ROÇI
Faik PRENÇI
Shehat CAMI

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

# Nisma europiane për 'Takime me Civilizimet'

Një libër i ri që eksploron përvojën dhe ten sionet e njerëzve që janë marrë me civilizimet dhe kulturat e ndryshme nga të tyret tani mund të gjendet në Europën kontinentale pas botimit prej *Transaction Publishers* në SHBA në shkurt.

*'Takime me Civilizimet: Nga Aleksandri i Madh deri te Nënë Tereza'* i sociologut të Universitetit të Birminghamit Dr. Gëzim Alpion mbulon katër vende të ndryshme me tema të tilla si historia, media, çështje sociale dhe të politikës duke bërë vlerësimin e eksportimit të kulturës.

Të 15 esetë, që janë përzgjedhur dhe paraqitur nga studiuesi kanadez Gaston Roberge, mbulojnë Shqipërinë, Egjiptin, Britanine e Madhe dhe Indinë. Ato eksplrojnë se si këto vende janë formatuar nga kultura të ndryshme. Në epokën e komunikimit masiv dhe të migracionit global ky libër ngre çështje të rëndësishme për nënshtetësinë, multikulturalizmin dhe integrimin.

Alpion shpjegon se: *'Civilizimet mund të bashkë-ekzistojnë, por jo nëse disa vendosen si footnote ndërsa të tjerët imponohen si normativë.'*

Libri eksploron se si kultura dhe politika egjiptiane janë formatuar nga dominimi i huaj ndërkohë që kanë ruajtur zakonet e lashta në nivelin social. Në krahasim me të, Britania e Madhe ka qenë një fuqi perandorake predominanca kulturore e së cilës ka formatuar imazhet e vendeve më të vegjël në sytë e botës.

Alpion shkruan për imazhet angleze të vendlindjes së tij Shqipëri dhe ofron një analizë penetruese të Nënës Terezë si një misionare




kristiane në Indinë hindu dhe myslimane, duke u përqendruar në paraqitjen e saj kulturore përmes medias dhe kultit të celebritetit.

# "Laseri në Oftalmologji"

Libri "Laseri në Oftalmologji" i Dr. Ali Tonuz it, është teksti i parë që botohet në fushën e Oftalmologjisë në vendin tone për llojet dhe përdorimet e shumta të tij në këtë fushë. Libri është shkruar thjeshtë, i ilustruar me shumë figura duke e bërë tekstin shumë të kuptueshëm për të gjithë gjeneratën e oftalmologjistëve dhe më gjerë.

Vitet e fundit ka pasur një shpërthim të teknologjisë së përdorimit të laserit në fushën oftalmologjike edhe në vendin tonë, gjë që shtronte nevojën e bërjes së një teksti bazë, i cili të shërbente për të siguruar njohuritë më të domosdoshme, për të shmangur përdorimet e gabuara e pa kriter të laserit në oftalmologji.

Libri është ndarë në pesë seksione: Seksioni i parë për principet bazë dhe arsyetimi terapeutik për laserat oftalmologjike, seksioni i dytë tregon në mënyrë të detajuar përdorimin e laserit në sëmundjet retinale, seksioni i tretë tregon përdorimet e laserit për glaukomën dhe sëmundjet e tjera të segmentit anterior, seksioni i katërt tregon përdorimin e laserit për katarakten dhe kirurgjinë refraktive dhe seksioni i pestë tregon aplikacionet e tjera të laserit në kirurgjinë e segmentit anterior.

Laserat tani përdoren rutinë në diagnostikimin, parandalimin dhe trajtimin e shumë patologjive okulare. Megjithë volumet e gjera të literaturës së lejuar në përdorimin klinik të laserit për shoqërimet okulare, është e vështirë për një mjek të përgjithshëm të zbërthejë këtë tekst dhe të përfitojë një informacion praktik të nevojshëm për përdorim të përditshëm.

Ky libër është konceptuar që të shërbejë si një bashkudhëtar i fuqishëm për oftalmologjistët klinikë dhe siguron një ilustrim të mirë të koncepteve bazë të terapisë së laserit, për shoqërime okulare të ndryshme, të lidhur me kapakët, kornenë, kristalinin dhe retinën.

Principet bazë të përdorimit të laserit, puna preoperative, teknikën egzakte të shpërndarjes së laserit, terapinë pas aplikimit të laserit dhe komplikacionet shoqëruese të kësaj terapie, janë shpjeguar gjerësisht në këtë tekst.

Teksi mbulon trajtimin me laser të retinopatisë diabetike, sëmundjet vaskulare të retinës, degjeneracionin makular të lidhur me moshën, glaukomën primare me kënde të hapur, glaukomën primare me kënde të mbyllur, përdorimin e laserit në kirurgjinë e kataraktit dhe komplikacionet e tij, përdorimin e laserit në sëmundjet refraktive dhe menaxhimin e sëmundjeve korneale me trajtimin me laser në shtesë të shoqërimeve të ndryshme të tjera.

Libri "Laseri në Oftalmologji" do të sigurojë një informacion reference praktike të përdorshme për të gjithë mjekët specialistë.

**Prof. SULEJMAN ZHUGLI**

# Bulqiza, një minierë ari për të tjerët dhe një plagë dhembjeje për banorët e saj. Historia e qytetit të paradoksit, aty ku në përpjekje për mbijetesë ekonomike, njerëzit bëjnë pakt me vdekjen. Plaga sociale nuk kursen as një: burrat, gratë dhe fëmijët...

***Nga: ULKIE SINANI***

Me një grup të vogël miqsh e shokësh udhëtojmë me një fuoristradë në drejtim të qytetit të vogël të Bulqizës. Qëndrojmë pak çaste përpara teqesë bektashiane për të nderuar dervishin që fle aty në banesën e tij të përjetshme, e cila u rrezikua të shembej për shkak të hapjes së rrugës së re. Banorët kundërshtuan që teqeja të prishej dhe falë tyre ajo qëndron si fitimtare mbi truallin në të cilin lëshoi rrënjë shumë e shumë vite më parë. Vijojmë edhe ca kilometra në rrugën me asfalt që gjarpëron mes kodrash të buta për të mbërritur në qytetin e minatorëve. Zbresim nga makina dhe pasi vëmë shallet dhe dorashkat për t'u mbrojtur nga era e fortë që e karakterizon këtë qytet, fillojmë të ngjitemi në malin e Duriçit ku është dhe miniera. Na shoqëron një vendas, rreth të dyzetepestave. Ai është një qytetar fjalëpakë, por i zgjuar, njohës i mirë i zonës, banorëve dhe i minierës. Gjej rastin ta pyes për kohën kur është zbuluar kromi, "thesari" i këtij qyteti të varfër. Ai më shpjegoi se tregtia e kromit nisi që në vitet tridhjetë. "Ishin italianët që e kanë diktuar këtë thesar që u kishte rënë për hise pasardhësve të Kastriotëve. Hamit Boriçi, banor i fshatit Vajkal të Bulqizës, teksa po kulloste bagëtinë gjen një gur të zi me shkëlqim gjysmëmetalik, më i rëndë nga të tjerët, të cilin ia dorëzon një oficeri italian. Italianët kërkuan nga banorët që të mblidhnin këta gurë të veçantë. Banorët filluan të mbledhin gurët e veçantë, i transportuan me mushka në qafën e Buallit. U grumbulluan kështu 2000 tonë krom, por italianët nuk mundën ta tërhiqnin kromin në vendin e tyre. Ka qenë 14 shkurt i vitit 1948, kur një ekip inxhiniero-teknik, i ardhur nga Tirana bëri të mundur që me 18 shkurt të po këtij viti të dëgjohen shpërthimet e para të minierave. Pikërisht këto shpërthime shënuan dhe datëlindjen e kësaj miniere. Arriti të punohej në gjashtëmbëdhjetë nivele(kate nëntokë) që thellë nëntokës u krijua një Bulqizë tjetër si "urithore" e ngritur nga duart e njerëzve. Këta të fundit lanë bujqësinë që mezi ia merrnin mbitokës për të "shkallmuar" nëntokën. Me vite pasi mori jetë miniera, një minator i vjetër në këtë zanat do të kujtonte se "është rrëmuar aq shumë, dikur bashkë me të burgosurit, sa qyteti pret të bjerë në çast brenda tij". Duhet të jetë një ndjesi e fortë kjo zhytje se dhe ne që po i ngjitemi kësaj rrëpire na duket sikur sakaq do hapet toka dhe do na përpijë në thellësinë e saj. "Qyteti do fundoset, sepse poshtë tij janë hapur 16 nivele galerish", më kishte thënë një minator nga lagjja ime që humbi jetën në një nga galeritë e minierës. E kam kujtuar pak muaj më parë kur kam kaluar në tërmetin që e kishte epiqendrën pak kilometra më andej. Por toka nuk ka pranuar të hapet. Bulqiza ka mbetur po aty. Duket se edhe fatkeqësia ka normat e saj. Ajo të merr atëherë kur nuk e mendon. E sikur kjo të pllakoste për këta qytetarë do të quhej kob. Ndërsa ecim, burri që po na drejtonte për te stoqet e kromit na tërheq vëmendjen të

# Varfëri mbi pasuri

*Shkrimi fitues i çmimit "Dritan Hoxha"*

***ULKIE SINANI, studentja nga Bulqiza, diplomante për gazetari është fituesja e edicionit të parë të konkursit "Dritan Hoxha", organizuar nga Fondacioni Mediatik që mban emrin e themeluesit të një prej mediave më të mëdha në vend, "Top Media". Ky fondacion u krijua në tetor të vitit 2010, me nismën për të mbështetur të rinjtë, për t'i inkurajuar në rrugën e tyre dhe për të promovuar talentet e reja në media, art dhe kulturë. Mbi 100 shkrime morën pjesë në konkurs, të cilët u përzgjodhën nga një juri profesionistësh: Aleksandër Çipa, kryeredaktor i gazetës "Shqip"; Bledar Zaganjori, drejtor i informacionit në "Top Channel", dhe gazetarja Monika Stafa. Ulkie Sinani, 21-vjeçarja nga Bulqiza, studente në vitin e fundit të gazetarisë, u shpall fituese me një shkrim problematik mbi minierën e Bulqizës. Duke qenë vet banore e këtij qyteti, Sinani ka konkurruar me një reportazh që synon të vërë në pah paradoksin mes pasurisë minerare të Bulqizës dhe jetës në kufijtë e ekzistencës së banorëve të tij. "Jam shumë e emocionuar dhe e surprizuar, sepse nuk e prisja të isha fituesja. Fakti që ky çmim mban emrin e themeluesit të 'Top Medias', më bën të nderuar. Ky është çmimi i parë që marr në fushën e gazetarisë dhe është një çmim prestigjioz", - tha fituesja për mediat pas marrjes së çmimit. Ulkie Sinani nuk ka pasur përvoja të mëparshme mediatike dhe tashmë që është diplomante shpreson që të jetë pjesë e departamentit të informacionit, sepse i pëlqen të vjelë lajmin në terren. "E kam zgjedhur gazetarinë, sepse më pëlqen të jem gjithmonë pranë publikut, të marr informacionin dhe të ndikoj për formimin e opinionit publik. Më pëlqen media, prandaj kam vendosur të luftoj që të bëhem dikush. Kjo ishte një nga arsyet pse mora pjesë në këtë konkurs, doja të provoja veten", - thotë ajo. Për sa i përket temës që ka zgjedhur, Sinani thotë se, "duke qenë banore e atij qyteti, e njoh nga afër situatën e Bulqizës. Vendosa të shkruaj për të ndërgjegjësuar opinionin publik që të bëhet diçka për këtë qytet, sepse është për të ardhur keq që ka gjithë ato pasuri minerare dhe është aq shumë i varfër".***

***Ne po e ribotojmë shkrimin e Ulkie Sinanit, për dy arsye: e para se ajo është një bashkëpatriote që synon të jetë një gazetare e zonja në të ardhmen, por edhe sepse në shkrimin e saj trajton një problematikë që rrallë mediat qëndrore e kanë trajtuar me seriozitet, por ndërkohë gazeta "Rruga e Arbërit" e ka trajtuar gjithmonë duke u përpjekur që të bëjë publike dhe kombëtare një tragjedi që po luhet me jetën e fëmijëve në qytetin e vogël të minatorëve.***

***REDAKSIA***

shikojmë ca pisha. Çuditërisht nuk e kuptuam përse. Aty nuk kishte asgjë të veçantë përveç pishave jeshile që mbretërojnë në këto anë. E pyesim se çfarë ka të veçantë apo çfarë fshihet poshtë atyre pishave dhe ai na shpjegon se aty në kohën e socializmit varroseshin të burgosurit politikë që punonin në minierë. Me keqardhje për këto qenie njerëzore, nisim të ecim përsëri. Destinacioni jonë ishte miniera. Jemi në një prej anëve të minierës ku grumbuj të stërmëdhenj kromi pengojnë gjithçka. Dëgjojmë sakaq një zhurmë fadrome. Më në fund na shfaqen para syve disa njerëz. Burra, gra dhe fëmijë...Ata janë të gjithë bashkë poshtë një pirgu të madh me gurë. Fadroma hap vendin kurse ata rrëmojnë pa folur, veçojnë dhe pastaj i mbledhin diku. Ky është rituali i banorëve të Bulqizës që vijnë çdo ditë e gërryejnë zemrën e malit për të nxjerrë bukën e gojës. Rrëmojnë e rrëmojnë pa fund. Nga mëngjesi deri pasdite vonë. Lodhen shumë, por nga djersa që u shkon çurg, fitojnë shumë pak. Teksa të tjerët po ecnin ngadalë, sepse kishte shumë gurë, afrohem dhe gjej rastin të flas me një grua. Edhe pse e hequr në fytyrë, një buzëqeshje i lëvizi cepat e buzëve kur i zgjata dorën për ta takuar. "C'e mer të ka pru mi bija e nanës në kto anë", më pyeti me të folurën dialektore të Bulqizës. Edhe unë i buzëqesha, por pa mundur t'i kthej përgjigje. Ulemi pak më tutje pirgut të madh me gurë për t'u ruajtur nga masivet e kromit që shkëputeshin herë pas here e që kërcënonin jetët e tyre. Miqësohemi shumë shpejt me njëra-tjetrën dhe ia nisim bisedës. Gruaja quhet Zira Partalli dhe më thotë se ka katër vjet që punon në zonën 1 duke mbledhur krom. Punon që në orën tetë të mëngjesit e deri në katër të pasdites. Fiton maksimumi tetëqind lekë të reja në ditë. "Jam e detyruar të vij këtu çdo ditë bashkë me djalin, sepse nuk kemi të ardhura të tjera. Burri nuk punon, sepse para disa vitesh u aksidentua në minierë dhe humbi këmbën e majtë. Pensioni prej invalidi i burrit nuk na del", më thotë Ziraja me zë të ngjirur nga i ftohti. Pa e kuptuar, të tjerët pasi kishin bërë fotografi, ishin ulur pranë nesh. Fadromisti na thotë të ngrihemi që aty. Ishim ulur aty ku fadroma do të gërryente për të nxjerrë gurët e kromit. Me vështirësi, duke u mbajtur për krahu te njëritjetri, zbresim pak më poshtë dhe e lëmë gruan rreth të dyzetave të rrëmojë. Aty poshtë na tërheqin vëmendjen ca fëmijë që po gajaseshin me të madhe, ndërsa me një lëvizje të shpejtë të duarve zgjedhin gurët e kromit dhe i hedhin pak më tutje. Njërit nga ne i rrëshqiti këmba dhe gurët që u rrokullisën poshtë i bënë fëmijët të kthejnë kokën. Sapo na panë u shtangën dhe buzëqeshja u ngriu në buzë kur në duart e miqve të mi panë aparate fotografish. Filluan të bërtisnin e të iknin sikur aparatet të ishin armë. "Mos na fotografoni, nuk duam të na shohin shokët në televizor duke mbledhur krom. Ikni andej nga keni ardhur e na lini në hallin tonë". Këto fjalë dëgjuam nga ata fëmijë, të cilët sa hap e mbyll sytë dolën në anën tjetër të minierës. Era frynte me furi dhe flokët më mbulonin fytyrën. Kthehem në anë të kundërt me erën për të rregulluar flokët dhe aty poshtë një stoku me krom shoh një djalë që po fërkonte puplën e këmbës së djathtë dhe lotët i rridhnin faqeve të rrumbullakëta. I afrohem dhe kuptoj se djali ka vrarë këmbën në një gur teksa po ikte me shokët. I jap një facoletë për të fshirë lotët që i buronin nga ata sy jeshilë plot jetë. Më falënderon dhe nga kurioziteti fillon të flasë me mua. Quhet Ervin. Ashtu si moshatarët e tij vjen çdo ditë për të mbledhur krom. Ka mbaruar tetëvjeçaren dhe nuk shkon më në shkollë nga pamundësia ekonomike. "Vij çdo ditë me mamin. Punoj shpejt e shpejt që të iki më herët e të luaj futboll me shokët. Më pëlqen shumë futbolli, dua të bëhem si Andrea Pirlo. Kjo është një ëndërr dhe e tillë do të mbesë përderisa në vend të topit luaj me kromin nëpër duar çdo ditë", më thotë ndërsa vështron si i përhumbur vendlindjen e tij. Bulqiza, qyteti e ka nisur jetën e tij në vitin 1952. Por vetëm disa vite më vonë ai ka marrë këtë formë pa ngjyrë që mund ta vëzhgosh nga miniera. Nga lartësia e minierës shikohet një qytet anemik, me një rrugë që humbet përtej dhe që bashkon në një vijë të drejtë dy pjesët e qytetit. Në këtë fushë të paanë ka luftuar Skënderbeu, në betejën e Vajkalit. Gjithsesi, nga lavdia e Skënderbeut nuk ka mbetur më asgjë në fytyrat e vrara të këtyre punëtorëve të ndrydhur që çuditërisht janë veshur të gjithë njësoj. Banorët e Bulqizës banojnë në dy krahët e fushës, mbushur me pallate të vjetra trekatësh dhe ato më të rejat(20-vjeçare) katër-pesë katëshe. Një pjesë e tyre janë stacionuar në qytetin e vjetër, ku është gjithashtu edhe miniera dhe disa nga ndërtesat kryesore të qytetit. Kjo pjesë ka ekzistuar edhe më parë, ndërsa në anën tjetër është qyteti i ri, i cili shtrihet deri në këmbët e malit. Quhet i ri, sepse është ndërtuar në vitin 1987. Në qendër të qytetit të vjetër shohim një monument. Nuk është i ndonjë heroi kombëtar apo i ndonjë njeriu të shquar, por është i një minatori të thjeshtë. Ky monument simbolizon minierën, sepse i gjithë qyteti pothuajse mbahet me minierën. Miniera është për ta burim të ardhurash për mbijetesë, por nga ana tjetër edhe një gllabëruese jetë njerëzish të pafajshëm. Njerëzit janë fjalëpakë, sepse duket se pjesën tjetër ja u marrin hallet e qëndrimit shumë metra nën tokë. Kryefjalë në bisedat e tyre është miniera dhe të përkulur në veshët e njëri-tjetrit krijojnë zinxhirë të pakuptimtë formash. Janë të qetë, një qetësi që duket se e kanë marrë nga qëndrimi prej vitesh të tëra nën tokë. Familja jonë, na thotë një minator, ka bërë njëqind e ca vjet punë në minierë. Në këtë kalkulim ai rendit breza të tërë nga fisi i tij. Historia e minierës pas socializmit është një luftim i vërtetë administrativ mes pronësisë së saj me format kapitaliste dhe minatorëve. Pastaj vdekje, vdekje. Nga viti 1947 e deri më sot ka pasur rreth 600 viktima në minierë, thonë minatorët, shumë prej të cilëve punojnë atje prej të paktën 25 vjetësh. Njëri prej tyre, duke treguar një gisht të prerë të dorës së djathtë, sqaron se në çdo pesëmbëdhjetë ditë pune në minierë, ka dhjetëra aksidente gjatë të cilave minatorët plagosen duke rrezikuar jetën. Pak ditë më parë dy prej tyre u masakruan pasi fitili i dinamitit që po përdornin u dogj më herët duke mos u lënë kohë të largoheshin në momentin e duhur. Për të mos folur për kushtet e punës. Nëse dikur e nxirrnin mineralin me vagonë pas privatizimit të minierës nga kompania DARFO, ata e nxjerrin me karroca dore. Ashensorët që të çojnë në fundin e galerisë nuk punojnë normalisht. Ndodh që punëtorët të presin me orë të tëra derisa ashensori të rivihet në punë. E kështu miniera në fjalë, e cila nxjerr një prej kromit me cilësinë më të lartë në tregun aktual ndërkombëtar, nuk ka parë asnjë investim serioz. Miniera e Bulqizës, thënë ndryshe gjiganti i industrisë nxjerrëse të kromit në vendin tonë dhe më gjerë, aktualisht po shkon drejt "asfiksimit" të plotë të saj. Kjo minierë e ka renditur Shqipërinë në vendin e parë në Europë dhe të tretin në botë, për nga sasia e nxjerrjes së mineralit të kromit me cilësi e veti tepër të larta. Eh, kjo po që është një jetë e vështirë. Pasi u përshëndetëm me të gjithë nisemi për te makina. Rrëmihësit dhe minatorët na përcjellin me sy që andej. Ardhja jonë i ka bërë të harrojnë për pak çaste varfërinë e tyre. Dhe sërish duke rrëmuar.

*(Marrë nga gazeta "Shqip", date 24 maj 2011)*

> Familja jonë, na thotë një minator, ka bërë njëqind e ca vjet punë në minierë. Në këtë kalkulim ai rendit breza të tërë nga fisi i tij. Historia e minierës pas socializmit është një luftim i vërtetë administrativ mes pronësisë së saj me format kapitaliste dhe minatorëve. Pastaj vdekje, vdekje. Nga viti 1947 e deri më sot ka pasur rreth 600 viktima në minierë, thonë minatorët, shumë prej të cilëve punojnë atje prej të paktën 25 vjetësh.

Rruga Arbërit nr. 61

homazh

Shoqëria jonë shkon tek dëshmorët, tek gurët e varrit të tyre duke vendosur lule, sepse kjo është një e drejtë që e kanë ata dhe që buron nga sakrificat sublime, nga vetëflijimi që bënë në emër të lirisë, pavarësisë dhe demokracisë.

# Vendi ku populli përulet para dëshmorëve

Në gjendje të mjerueshme paraqiten dhe monumentet, lapidarët si dhe të gjitha simbolet që flasin për dëshmorët e atdheut e ngjarjet historike

**Dr. BERNARD ZOTAJ**

Në kuadrin e 100 vjetorit të shtetit shqiptar nga Ministri i Mbrojtjes Zoti Arben Imani është ngritur dhe funksionon një grup pune për të verifikuar në vend të gjithë grupvarrezat e Dëshmorëve në shkallë vendi, e për të parë nga afër gjendjen konkrete të tyre. Ky evidentimi i Dëshmorëve të Atdheut për çdo bashki, qark e komunë bëhet sipas ligjit Nr. 8607, datë 27. 04. 2000, "Statusi i Dëshmorit të Atdheut", VKM Nr. 151, datë 25. 04. 2002 "Për Statusin Dëshmori i Atdheut", i ndryshuar, Vendimi Nr. 503, datë 23. 06. 2010 "Për një ndryshim në Vendimin 151, datë 25. 04. 2002 të Këshillit të Ministrave për statusin "Dëshmor i Atdheut'', i ndryshuar dhe Urdhër i Ministrit të Mbrojtjes Nr. 2076, datë 12. 11. 2010 "Për krijimin e Grupit të Punës për vlerësimin e nevojave për riparimin dhe mirëmbajtjen e varrezave të Dëshmorëve të Atdheut".

Në ekipin e verifikimit përveç përfaqësueseve të grupit të punës kanë marrë pjesë dhe specialistë (inxhinierë të fushave të ndryshme) nga ISPMb-ja të cilët i kanë paraprirë fazës së hartimit të projekteve për rikonstruksionin e tyre.

Gjatë kësaj periudhe është marrë takim me autoritetet më të larta të Pushtetit Vendor në Qarqe, Bashki e Komuna ku ndodhen këto grupvarreza, dhe strukturat që janë përgjegjëse për to. Në këto takime është diskutuar gjithë problematika e trajtuar në Urdhrin e Ministrit të Mbrojtjes.

Nga takimet e organizuara me autotitetet vendore është vënë re një vlerësim nga ana e tyre e kësaj nisme. Në këto takime janë krijuar pikat e kontaktit për vazhdimin e mëtejshëm të këtij projekti. Një takim të tillë patëm dhe në Bashkinë e Peshkopisë, ku u pritëm nga kryetari zoti Ilir Krosi. Ai na informoi për gjendjen e vorrezave të dëshmorëve të qytetit, si dhe kujdesin që është treguar në këto vite për mirëmbajtjen e tyre.

Vorrezat e Dëshmorëve të Peshkopisë kanë një sipërfaqe prej 2600 m2. Në këtë grup vorreza prehen eshtrat e 192 dëshmorëve të atdheut.

Dëshmor i atdheut është ai që vritet në luftën për liri e për drejtësi shoqërore, ai që fal jetën për të mirën e popullit e të atdhut. Kështu ranë në fushën e nderit mjaft dëshmorë edhe nga Peshkopia për çlirimin e atdheut të tyre. Midis tyre janë Heronjtë e Popullit Nazmi Rushiti, Hibe Palikuqi, por dhe luftëtari i çështjes kombëtare, Isamil Strazimiri që ra dëshmor në moshën 75 vjeçare për atdhenë.

Dibra dhe dibranët në shekuj janë shquar për tradita atdhetare dhe luftarake. Të "Nandë Malet e Dibrës" gjithmonë kanë qenë mbështetje e fortë për veprimet patriotike të popullit shqiptar. Në Lidhjen e Prizrenit si Kryetar i Këshillit Qendror të saj u zgjodh delegati i Dibrës Iljaz Pashë Dibra. E veçantë është se Dibra ka dëshmorë të atdhetur, para vitit 1912, gjithsej 75 dëshmorë.

Mjaft efektive ka qenë pjesëmarrja e dibranëve në kryengritjen e përgjithshme të vitit 1912. Dibranët e pritën me entuziazëm Shpalljen e Pavarësisë, ku morën pjesë edhe përfaqësuesit e Dibrës, ndërsa Dom Nikoll Kaçorri nga Lura u zgjodh nënkryetar i qeverisë së Vlorës, Vehbi Dibra kryetar i pleqësisë, si organ këshillues i qeverisë.

Të parë që sulmuan Dibrën pas shpalljes së pavarësisë ishin serbët. Beteja të përgjakshme u zhvilluan në Kolosjan ku forcat dibrane të udhëhequar nga patriotët Baftjar Doda, Elez Isuf Ndreu dhe Suf Xhelil Ndreu, bashkë me popullin e Lumës i shkaktuan disfatë të plotë ushtrisë së rregullt të kralëve të Serbisë.

Lufta e rreptë e popullit të Dibrës e detyroi ushtrinë serbe të tërhiqet përfundimisht në dhjetor 1921, jashtë kufijve të vitit 1913. Dibra në këto vite u dogj e u shkatërrua tri herë nga serbët dhe ushtritë e tjera të huaja, por populli dibran kurrë nuk u mposht dhe as nuk u përkul. Për këtë periudhë janë shpallur dëshmorë të atdheut 337.

Nderimi ndaj veprës së dëshmorëve merr përmasa shenjtërimi sepse ata dolën në fushën e betejës dhe u përleshën me pushtusit në çdo kohë, duke patur besim të plotë se Shqipëria do të çlirohej. Ata nuk nguruan të binin në fushën e nderit, në luftën e drejtë siç ishte dhe LANÇ që u zhvillua nga mbarë populli ynë, popujt dhe shtetet demokratike të botës.

Më 20 gusht 1944 në Sllatinë të Peshkopisë u krijua Brigada e XVIII Sulmuese, ku u inkuadruan batalioni partizan i Dibrësi përbërë tërësisht nga bij dhe bija dibranë. Dëshmorë që ranë për Dibrën janë dhe dy ushtarë italianë Antonio e Mario që prehen në vorrezat e dëshmorëve të saj. Dëshmorë të LANÇ janë gjithsej 190. Ndërsa nga çlirimi i vendit dhe deri më sot janë shpallur dëshmorë të atdhut 150.

Dëshmorët, çfarëdo bindjeje politike që kishin, nuk ngatërruan bindjet e tyre me idelin kombëtar, por u ngritën në luftë dhe luftuan gjer në fitore. Këta luftëtarë sypatrembur u frymëzuan nga idealet e larta për ta parë atdhuen dhe popullin të lirë, të pavarur në vendin e vet. Ata u frymëzuan nga dëshira dhe ndjenja kombëtare për një jetë të lirë, në demokraci të vërtetë dhe u flijuan në emër të lirisë në gojë e të demokracisë në zemër.

Dëshmorët, këta bij dhe bija të lavdishëm të kombit tonë me heroizmin e tyre, me veprën dhe daljen në luftë, ngritën peshë zemrat e popullit. Motivet që ushqyen këtë si heroizmi masiv ishte tek vetëdija kombëtare, dashuria për lirinë dhe urrejtja ndaj pushtuesit. Ndaj dhe ata u mbuluan me flamurin e kombit për aktin sublim që bënë, duke dhënë jetë për Atdhenë. Ata u shtrinë në altarin e lirisë, u futën në marshe e u bënë hymne që u shkojnë për shtat vetëm trimave të kombit.

Është detyrë humane dhe atdhetare t'i përkujtojmë e të kujdesemi për vendprehjen e tyre në gjithë Shqipërinë, e në mbarë kombin, sepse ata nuk vdiqën duke menduar për aktin e lavdisë dhe nderimin ndaj tyre. Ata vdiqën në fushën e nderit sepse ishin nga ajo rracë që nuk ju nënshtruan armikut. Nderimi ndaj aktit dhe veprës së tyre ka qenë dhe mbetet një detyrim moral deri në përmasa shenjtërimi dhe simboli për kombin. Ata na vijnë dhe flasi edhe sot me ne përmes veprën dhe bëmave të tyre, përmes testamentit që lanë, ndaj dje ishin të rreshtuar në llogore e sot janë të rreshtura në flamur.

Të gjitha këto na çojnë të gjithëve që vendprehjen e tyre ta shikojmë jo në çdo 5 maj, apo në nëntor, por gjatë gjithë kohë dhe të mos i lëmë ato në gjendje të mjerueshme. Ka ardhur koho që grupvorrezat të ngrhen në lartësinë e duhur dhe të rregullohen e riparohen nga pushteti vendor.

Kur shkuam në vendprehjen e dëshmorëve, në një ambjent mjaft të bukur dhe të rrethuar me gjelbërim, gjendja e tyre linte shumë për të dëshiruar.

Pasi bëmë verifikimin dhe gjendjen konkrete të tyre u hartuan relacionet teknike ku u pasqyruan në mënyrë të detajuar të gjitha problemet e konstatuara përsa i përket infrastrukturës së tyre, si gjendjes së varreve, rrethimit, ndriçimit, gjelbërimit, shesheve e mureve, etj.

Gjendje të mjerueshme paraqiten dhe monumentet, labitarët si dhe të gjitha simbolet që flasin për dëshmorët e atdhuet e ngjarjet historike të vendit tonë.

Shoqëria jonë shkon tek dëshmorët, tek gurët e varrit të tyre duke vendosur lule sepse kjo është një e drejtë që e kanë ata dhe që buron nga sakrificat sublime, nga vetëflijimi që bënë në emër të lirisë, pavarësisë dhe demokracisë.

## 5 Maji / Presidenti Topi bën homazhe në "Varrezat e Dëshmorëve" në Peshkopi

*Me rastin e 5 Majit, ditës së nderimit të veprës heroike të të rënëve të kombit, Presidenti i Republikës, Prof. Dr. Bamir Topi, i shoqëruar nga anëtarë të Kabinetit, bëri homazhe në "Varrezat e Dëshmorëve" në Peshkopi, ku pas ceremonisë zyrtare solemne dhe ekzekutimit të himnit kombëtar në prani të Truprojes së Nderit, vendosi një kurorë me lule në nderim të kujtimit të veprës heroike të tyre. Në qytetin e Peshkopisë, Presidenti Topi u prit nga Prefekti i Dibrës Genc Sharku, deputeti i zonës Sherefedin Shehu, autoritetet vendore dhe u takua përzemërsisht me qytetarë të shumtë, veteranë, intelektualë, etj.*

*Presidenti i Republikës, në nderim të Ditës së Dëshmorëve, u shpreh para mediave: "Dëshiroj në këtë ditë të shënuar, Ditën e 5 Majit, Dita e Dëshmorëve të Kombit, të vlerësoj veprën e tyre që përkujtohet sot nga mbarë shqiptarët, kudo në mbarë Shqipërinë. Erdha për ta përkujtuar këtë ditë në Dibër, sepse Dibra si çdo qelizë e tokës shqiptare është një zonë e shquar patriotizmi me vlera të mëdha historike dhe besoj që gjithçka që ne gëzojmë sot, gjithçka që ne po ndërtojmë sot drejt rrugës për në Bashkimin Evropian patjetër, është ndërtuar mbi një bazament vlerash patriotizmi që i dedikohet të gjithë dëshmorëve të kombit, të gjithë patriotëve dhe kjo është arsyeja që ne përulemi sot për të nderuar veprën e tyre. "*

*Më pas, në përkujtim të Ditës së Dëshmorëve, Presidenti Topi i shoqëruar nga Kryetari i Bashkisë së Peshkopisë, Ilir Krosi, Prefekti Genc Sharku, deputeti Sherefedin Shehu dhe anëtarë të Kabinetit, zhvilloi më pas vizita në familjet e dëshmorëve dibranë të rënë për atdheun: tek mbesa e Heroit të Popullit Nazmi Rushiti, familja e Dëshmorit Irfan Hajrullaj dhe tek familja e dy vëllezërve të rënë, Tahsim dhe Hamza Shehu, ku bashkëbisedoi me familjarët e tyre, duke përçuar mesazhin se vepra heroike dhe vetëmohuese e dëshmorëve të kombit për lirinë e vendit do të mbesë përherë shembull i simbolit të vlerave më të larta njerëzore e të atdhedashurisë.*

*Vorrezat e Dëshmorëve të Peshkopisë.*

*Monumenti kushtuar Br. XVII S.*

matura

## FESTË NË SHKOLLËN JOPUBLIKE "SARINA"

# 77 maturantët që do të lartësojnë emrin e shkollës

Epremtja e fundit e majit ishte një ditë fes të në shkollën "Sarina". Nxënësit dhe mësuesit e kësaj shkolle, kishin organizuar me rastin e diplomimit të 77 maturantëve të kësaj shkolle, një program artistik, i cili për nga mënyra e organizimit dhe cilësia e programit, ishte për tu pasur zili nga shumë bashkëmoshatarë të tyre në institucione të tjera të këtij lloji.

Të pranishëm në këtë festë ishin Bilbil Hoxha, drejtor i drejtorisë arsimore; Agron Tufa, shkrimtar; Stefan Qirici, rektor i universitet: "Sevasti dhe Paraqeshevi Qiriazi"; Enkeleida Zeko, gazetare sportive; Migena Kraja, prezantuese; Elona Gaxhaj, ish mësuese e kësaj shkolle dhe shumë prindër e të afërm të maturantëve të kësaj shkolle.

Drejtori i shkollës, Besim Toçi, duke ju drejtuar 77 maturantëve, mes të tjerash tha: "Ju jeni 77 maturantët që formoni një gjerdan me emrin Sarina. Me dijen e marrë në kërë shkollë, ju vezulloni pambarimisht në një hapësirë tredimensionale".

"Shumica juaj, të ulur sot këtu në këtë platformë nderi, jeni rritur, jeni burrëruar, jeni maturuar ndër vite..., jeni integruar me kërkesat e shkollës sonë, të monitoruar gjatë gjithë kohës, në çdo moment, në shkollë e jashtë saj, me synimin që të bëheni qytetar të nderuar të këtij vendi. Dhe besoj se ja kemi dalë mbanë, duke bërë për ju më të mirën e mundshme", tha ai. "Ju nuk jeni më të mirët e më të mirëve, por të paktën jeni më të mirët me të cilët unë kam pasur të bëj kohët e fundit si maturantë".

Në fjalën e tij, Presidenti i shkollës "Sarina", Liman Hoxha, falënderoi nxënësit maturantë dhe iu uroi atyre suksese në provimet e maturës. Ai falënderoi edhe mësuesit dhe drejtuesit e shkollës, për punën e shkëlqyer që kanë bërë me nxënësit, duke e ngritur emrin e shkollës "Sarina" çdo vit e më lart.

Shkëlqim Salillari, Zv/drejtor i shkollës, Miftar Veliu, mësuesi kujdestar 12-a, Nafiz Topi, mësues kujdestar 12-b, Shkëlqim Çollaku, kujdestar 12-c dhe Azem Teta, drejtues artistik i spektaklit, dhe Sonela Totraku ishin disa nga protagonistët e kësaj dite, duke u ndarë kështu nga nxënësit e tyre, me urimin që ti shohin lart e më lart në studimet dhe karrierat e ardhshme profesionale.

Në fillim të spektaklit iu dhanë certifikatat që maturantëve më të mirë: Lunada Methasani, Egzon Çakraj, Besmira Matoshi, Kledia Hoxha, Adenis Kastrati, Blerta Çejku, Emi Aliseni, Esmeralda Xheka, Jetmira Abdija, Alda Picari, Daut Shira, Orjada Shoti. Më pas, u ngjitën në skenë dhjetë nga dhjetë maturantë dhe secili prej tyre shprehte një mirënjohje për mësuesit, duke treguar kështu se mes nxënësve dhe mësimdhënësve ka pasur një harmoni të shkëlqyer, shumë shpresëdhënëse për sukseset e tyre.

Edhe në vitet e kaluara, maturantët e shkollës "Sarina" kanë pasur suksese në provimet e Maturës Shtetërore, por këtë vit, thotë Presidenti i Shkollës z. Liman Hoxha, kemi një pritshmëri të madhe, pasi ky grup nxënësish kanë qenë shumë të përkushtuar dhe së bashku me stafin pedagogjik, besojmë se kemi bërë një punë shumë të mirë që do ti ngrejë lart emrin shkollës.

Në skenë, nën prezantimin e mrekullueshëm e plot emocione të babë e bijë, Defrim e Lunada Methasani u ngjitën nxënës të klasave të tjera, të cilët uruan shokët e tyre të shkollës me plot emocione për suksese në provimet e Maturës, duke hapur kështu që rrugë të re për të ardhmen. Xhulia Gjoka, Tea Marku, Rovena Kuqaj, Lusila Murati, Gabriela Pera, Sindi Mitku, Enisilda Aga, Eriola Puci, Kadri Cahani, Sara Muça, Gesiana Secula etj., u ngjitën në skenë duke kënduar, përshëndetur, vallëzuar e recituar, tregues këto se shkolla "Sarina" nuk do të nxjerrë në të ardhmen vetëm nxënës shembullorë, por edhe artistë me pasion.

Emocionues ishte edhe vlerësimi për mësuese Sabrije Uruçi, e cila e ka nisur punën e saj me koshtin "Sarina" 10 vite më parë, dhe tani sheh "fëmijët" e saj të rriten dhe të edukohen vit pas viti në shkollë.

Në fund, me uniformat e reja të "Sarinës", ngjiten në skenë 77 maturantët dhe nën himnin e këngës hodhën lart kapelet, me urimin dhe besimin: Lart e më lartë në udhën e jetës!

***B. Karoshi***

# Pasqyrë e vlerave dhe e reformimit

*Nga:* **MEVLUD BUCI**

Nëse njeh nga afër ecurinë, orga nizimin dhe arritjet e gjimnazit të Peshkopisë "Said Najdeni" ke çfarë të shkruash. Një shkollë me prova të qarta për shëmbëllimin në mësimëdhënje për kulturën demokratike dhe mbi të gjitha vatër e pasqyrimit të vlerave dhe reformimit. Atje, në qytetin e bukur të Peshkopisë, në zemër të tij, midis aromës së blirëve përhapen dhe zërat e mbi 1000 gjimnazistëve, ku veç mësues janë mbi 40 të përkushtuar. E veçanta e punës në gjimnazin "Said Najdeni" është efektiviteti në punën mësimore-edukative, cilësia e zhvillimit të veprimtarive, marrëdhënjet e shëndosha mësues – nxënës dhe shkollë-komunitet. Është domethënje fakti se si edhe në shkollat e tjera të këtij qyteti punohet me pasion e objektiva, synohet tek thellimi i demokracisë, edukimi i prirjeve të nxënësve, njohja e traditave atdhetare-demokratike. Në gjimnazin "Said Najdeni" krahas rolit organizativ e reformues të drejtorit Ylber Daci e zëvëndës drejtorëve të palodhur Fatmir Bulku e Misire Cuku rrezaton në vijëmësi shembulli aktiv i mësuesve kujdestarë, niveli reformator në mësim dhe përkujdesja e përditshme për edukimin dhe disiplinën.

Një pasdite vonë në këtë pranverë u ndodhëm përpara këtij gjimnazi. Vërtet shikoje mësues që punonin si bletët si i thonë duke vetvepruar e komunikuar me mësuesit, duke u aktivizuar në veprimtaritë për librin, për kulturën, për internetin e olimpiadat. Faktet dëshmojnë se mjaft nxënës gjimnazistë të "Said Najdenit", kanë shënuar arritje cilësore si rrjedhojë e punës shembullore të mësuesve, të përpjekjeve në vijëmësi për të kristalizuar e zotëruar njohuritë e pasqyruara në tekstet mësimore në bashki e prefekturë si dhe mjaft prindër në komunitet u janë mirënjohës punës ideopedagogjike të drejtuesve dhe gjithë stafit pedagogjik të gjimnazit "Said Najdeni"-Ajo që na nxit e ndihmon ne në përparimin tonë është komunikimi dhe përkushtimi i mësuesve tanë, - na thotë maturanti Naim Pira. Rregulli, përpjekja, aktivizimi në veprimtari lidhet me bibliotekën, testimet, sallën e internetit, me ekipet sportive e ato kulturore janë dëshmi e rolit aktiv të drejtorisë së shkollës dhe e Qeverisë së Nxënësve të këtij gjimnazi. Janë nxënësit të cilët i japin jetë gjimnazit të qytetit. Tek vëzhgonim fytyrat e ndritshme të nxënësve veprimtarë në atë mbrëmje pranvere mu kujtuan ish mësuesit e shquar e të paharruar të këtij gjimnazi, të cilët nuk jetojnë më.

Ata janë gdhendur në kujtesën dhe ndërrimin e brezave si(ndjesë paçin): Safet Xhulali, Myfyt Trepça, Qani Përtafi, Fitim Dani, Zabit Trupja, Allaman Xharri etj... Kanë lënë gjurmët e punës pasionante dhe mjaft ish-drejtor të gjimnazit "Said Najdeni" si: Shemsi Manjani, Shuaip Skarra, Selim Alliu, Osman Turja, Myslym Koka, Fatmir Bulku, Agim Shupleka, Tomor Shehu, Munir Sina etj... Patëm fatin të takojmë mësuesin e talentuar të edukimit fizik Sami Hasa, mësuesin shembullor të filozofisë Z. Shefki Çorja, matematikantin dhe veprimtarin, njeriunmjeshtër edhe të alegorisë së odave pedagog Hysni Ramadan Kurtin, si dhe zv. drejtorin, organizatorin e talentuar, mjeshtrin e pedagogjisë e të drejtimit Z. Fatmir Bulku. -Kemi shënuar plot arritje, sepse ne përkrahim përvojat brënda kolektivit si dhe ato jashtë nesh, -thotë zv. drejtori Fatmir Bulku. Ka gati tre dhjetëvjeçarë që Fatmir Bulku shërben në drejtim të këtij gjimnazi. Gjurmët dhe pasioni i Fatmirit, shembulli i tij drejtues e reformator, si mësimdhënës i palodhur, si njeri i korrektësisë pedagogjike rrezaton çdo ditë. Për secilin mësues dëgjuam që nxënësit flisnin me admirim. Pranë nxënësve të këtij gjimnazi e ndjen veten sikur je në një galeri me minerale tepër të çmuara. Në këtë gjimnaz disa pedagog kujtojnë edhe gjurmët e ekipeve të Ministrisë së Arsimit, gjurmët e drejtoreshës Lydra Biçoku dhe Lumtor Ibraliu me ekipin, të cilët vite më parë kanë ndihmuar dhe shpërfaqur përvojat tek "Said Najdeni" i Dibrës, në Peshkopi. Gjimnazi "Said Najdeni" dhe qytetarët e Peshkopisë këtë pranverë patën një festë të veçantë, sepse dy mësuesve shembullorë:Sabri Pira dhe Reshat Kola, bashkia e qytetit i nderoi me Titullin"Mirënjohja e Qytetit". Vërtet s'ka gjë më të çmuar se mirënjohja, ja kjo është themeli dhe drita e nderimit njerëzor, rrezatimi i shpirtit dhe drejtësisë demokratike. Të gëzon fakti sesi shkolla (gjimnazi) "Said Najdeni" në Dibër është vatër e vlerave, vatër e reformimit arsimor.

*Politikanët apo siç i shpreh unë sipas veprave të tyre "politikanucat" janë racë e mbushur me helium që ngrihen direkt në qiell si baloni i Pipit.*

# Kritikë e politikës të *décadence*

*Nga* **BUJAR PLLOSHTANI**

Një politikë "etike apo njerëzore" e tyre po na çmend! Ose atë që unë e them "një politikë që ka vdekur mund të vdesë përditë, andaj çdo fjalë apo premtim i tyre në çdo aspekt është një paralajmërim i vobektë dhe i dëmshëm për qytetarin. Ky paralajmërim është e vërteta e qytetarit apo e shoqërisë, që fatkeqësisht nuk mund ta ndryshojnë prej thelbit. Kur mungon koncepti dhe vetëdija politike për sensibilizimin e institucioneve të ndryshme për hir të qytetarit, atëherë mungon edhe më e bukura dhe më sublimja për to. Sot ende dëgjojmë, madje dhe ndikohemi nga e keqja dhe çumanizmi i tyre duke na mbushur mendtë me avujt e tyre bruto, që të zgjedhim intuitivisht apo instinktivisht atë që mund të jetë e dëmshme për ne, duke e lënë të tillë të dëmshmen si të dëmshme për ne, duke mos mundur ta ndryshojmë zgjedhjen tonë në më të dobishme apo më sublime – kjo është sipas meje afërsisht politika e décadence.

Politikanët apo siç i shpreh unë sipas veprave të tyre "politikanucat" janë racë e mbushur me helium që ngrihen direkt në qiell si baloni i Pipit. Fill pas verbohen, nuk u ndriçojnë sytë për të parë poshtë, Tokës se ç'po ndodh realisht. Gjithsesi, ata e kanë mirë sepse fluturojnë qiejve të kaltër që nuk i reziston kush, pos mjegullave që lehtësisht i përkëdhelin surratit, dhe është e pakuptimtë, ndonjëherë t'i paragjykosh pse nuk zbresin në Tokë. Ata zbresin vetëm kur kanë nevojë tepër të ndjeshme, e nevoja e tyre është m'u atëherë kur vjen në shprehje ekzistenca e tyre për t'u punësuar në institucione shtetërore. Pra, shtrijnë qenien në atavizëm emocional për të lypur një apo shumicë votash të vlefshme! Prandaj, nuk ndiejnë, nuk shpirtërohen, nuk gjykojnë, nuk meditojnë, nuk avancojnë kohën e qytetarit, sepse ata dinë të bëjnë një shenjtësi të rrallë: **të materializohen!** Morali i tyre është i prishur, sepse zbresin në Tokë vetëm kur ata kanë nevojë, e jo kur është në shprehje vullneti dhe nevoja e popullit për t'u ndriçuar vetë ata që të mundësojnë të zgjedhesh. Kjo vërtet është demotivuese dhe injoruese për qytetarët apo individin, mirëpo gjersa të zgjedhim instinktivisht të dëmshmen dhe të keqen për ne, nuk do të jemi asnjëherë në gjendje ta ndryshojmë të ardhmen tonë. Duhet t'i zgjedhim në mënyrë të lirë dhe demokratike, pastaj në rast se cënojnë të dobishmen tonë t'i pezullojmë menjëherë duke zgjedhur metoda dhe mjete të ndryshme qytetareske!

Nuk vlen gati asnjë kritikë për to. Nuk i ndal askush dhe asesi bëmat e tyre. Sepse janë më qiellor se sa ne, ngase lundrojnë sipër nesh me krahët tanë. Mirëpo, ky lundrim i tyre është paralajmërim i keq për individin e qytetarët që rëndë po i ndëshkon. Sipas meje, kritikë e politikës të décadence nuk i vjen fundi kurrsesi, sepse po ndodh krejt e kundërta, shkaku i kopukllëkut të tyre që lypin një votë, një besim, dhe më pastaj po na fundosin duke na shmangur me heshtjen e tyre të zakonshme, tashmë kryeneçe. Gëzojnë autoritet shtetëror, dhe mund të bëjnë të dobishmen e individit dhe qytetarit të padobishme. Kritikë e politikës të décadence ka lindur nga kalbësia e tyre, ku helmojnë ekzistencën e individit dhe qytatarit në mënyrë çumane...

Po i uroj njerëzisht dhe modestisht udhë të mbarë, fatkeqësisht!

"RRUGA E ARBERIT"

*merr kopjen tënde*

eshte koha per tu pajtuar...
telefono: (04) 22 33 283

# Besëlidhja mbeti pezull...

***Nga:*** **Rexhep TORTE**

Ardhja e verës në Dibër të Madhe është lajmëtare e fillimit të dasmave dhe ahengjeve dibrane, është lajmëtare e ardhjes së mërgimtarëve. për t'i kaluar pushimet verore dhe për tu ç'mallur me vendlindjen. Vera dhe dasmat dibrane janë harxhuesit më të mëdhej të buxheteve të familjeve dibrane.

Kriza ekonomike globale dhe papunësia e madhe imponojnë nevojën e kufizimit të shpenzimeve kaqë të larta edhe për ata që janë në gjendje të mirë financiare, e sidomos për ata që hyjnë në borxhe të mëdha për të bërë ceremoni të tepruara në raste dasmash dhe vdekjesh. .

Në bisedat e dibranëve shtrohet sërish pyetja se ku mbeti Besëlidhja Dibrane e para dhjetë viteve për ruajtjen e zakoneve të pastërta dibrane dhe pë flakjen atyre zakoneve që shkaktojnë shpenzime të mëdha e të panevojshme

Në vitin 2000 nja grup dibranësh nga Dibra e Madhe mori nismën për të flakur zakonet dekadente e për të ruajtur dhe vënë në jëtë zakonet fisnike shqiptare dibrane.

Kjo nismë u përkrah nga pushteti vendor, Myftinia e Dibrës së Madhe, partitë politike shqiptare, Dega e Lidhjes së Gruas Shqiptare, Lidhja e Arsimtarëve Shqiptarë, Lidhja e Inteligjencisë Shqiptare dhe Lidhja e Historianëve.

Kështilli nismëtar bëri një punë njevjeçare me biseda, sondazhe në Dibër e diasporë dhe mori mbështetje të gjithanshme. Si rezultat i kësaj u hartua Besëlidhja Dibrane si normë obligative që në rast mosrespektimi sjellte përgjegjësi morale.

Teksti i Besëlidhjes Dibrane është në shërbim të ruajtjes së pastërtisë së zakoneve dibrane dhe flakjes së zakoneve që e rëndojnë së tepërmi jetën e dibranëve me ceremonitë e tepruara me rastin e lindjes së fëmijës, pagëzimit, ditëlindjes së fëmijës, synetit, fejesës, martesës dhe vdekjes.

Në tekstin e kësaj Besëlidhjeje Dibrane janë parashikuar normat fisnike dibrane.

Me rastin e lindjes së fëmijës është parashikuar të njoftohet vetëm rrethi i ngushtë i dy prindërve. Lehonën në spital ta vizitojnë vetëm anëtarët e familjes së ngushtë. Të vazhdohet tradita e dërdimit të petullave në ditën e daljes së lehonës nga spitali, ndërsa të ndërpritet kategorikisht praktika e organizimit të koktejit te nëna e lehonës, si shpenzim i tepërt. Për fëmijën e porsalindur të organizohet darkë vetëm me dy familjet e miqësuara dhe gjatë pagëzimit të kenë përparësi emrat me prejardhje autentike shqipe dhe emrat tradicionalë. Dhurata t'i dërgohen vetëm fëmijës dhe eventualisht lehonës e dhurata të dërgojnë vetëm prindërit e lehonës. Këto dhurata të jenë krevat fëmijësh, veshmbathje dhe dhuratat të mos tregohen para tjerëve, që të mos përfliten jashtë brezit familjar. Ceremonia e të porsalindurit të merr fund me natën e emrit.

Ditëlindjet e fëmijës të festohen në mënyrë modeste vetëm me shokët e moshës së tyre dhe dhuratat të jenë poashtu modeste, lojra dhe libra.

Gjatë synetit të fëmijës të gatuhet hallvë për të ftuarit dhe darkë modeste vetëm për rrethin e ngushtë familjar. Dhuratat duhet të jenë vetëm për synetliun, ndërsa anëtarët tjerë të familjes nuk duhet të figurojnë fare. Nuk është e këshillueshme që synetlinjtë të dërgohen në varreza pasi një gjë të tillë e ndalon edhe feja myslimane. Synetlinjtë të shëtiten nëpër qytet, por pa alarne e zhurma shurdhuese. Ceremonia e synetit të përfundojë ditën e synetit dhe vizitat e grave pas asaj dite duhet të ndërpriten.

Me rastin e ceremonisë së fejesës shkuesi-msyti tradicionalisht duhet ta hapën vetëm një kuti me llokume, apo bombonierë për të konfirmuar fjalën e dhënë pozitive. Ndërimin e nishaneve sipas zakonit duhet ta bëjnë vetë familjet e miqësuara dhe në ndërimin e nishaneve nuses i dërgohet vetëm një unazë e fejesës. Kontakti i parë i familjes së dhëndërit me nusen duhet bërë në mënyrë shumë modeste, të matur dhe të kulturuar dhe asesi nuk janë të preferueshme dhurata të shtrenjta dhe shpenzime të kota. Deri në martesë në rastet festive për festat e Bajramit, 8 Marsit, Vitit të Ri, Shëngjergjit, Maturës, ndalohet rreptësisht çdo dhuratë e shtrenjtë. Kontaktet midis familjeve të miqësuara deri në martesë të bëhen brënda familjeve të ngushta dhe pa përgatitjen e ceremnive të mëdha.

Me rastin e martesës prindërit t'i japin bijës së tyre si pajë një dhomë fjejteje me krevat, perde, abazhur, qilim dhe qëndisma të punura gjatë vajzërisë dhe duhet ndërprerë praktika e dhënies së dhuratave të tepruara si aparate elektrike shtëpiake, pajisje për kuzhinë, dhoma dite etj. Bohçallëqet të përgatiten vetëm për rrethin e ngushtë të familjes së dhëndërit, për vjehrin, vjehrën, vëllezërit dhe motrat me dhëndurët. Të ndërpritet praktika e treguarjes së dhuratave të nuses para grave gjatë xhumasë si pasojë e mëndjemadhësisë, ato duhet të mbeten çështje e brendshme familjare. Fustani i bardhë i nuses në koshere të meret me qira në butik, sepse blerja vetëm për ta përdorur një ditë është jashtë çdo llogjike. Numri i fustaneve të nuses në koshere kufizohet maksimalisht shtatë palë llogaritur edhe kostumet.

Ceremonia e dasmës në natën e kumutrisë duhet bërë duke kufizuar në parim sasinë e sheqerkave, llokumeve dhe çokollatave. Natën e kumutrisë duhet të ndërpritet vajtja e vajzave nga shtëpia e dhëndërit për të vizituar shtëpinë e nuses. Të ndërpritet praktika e obligimit qe çdo pjesëmarrës në dasmë të dhurojë një shumë të konsiderueshme të hollash për darkën në të cilën është ftuar. Për ta evituar këtë organizuesi i dasmës në ftesat për dasmën duhet të shkruajë "Nuk pranojmë asfarë dhuratash. Do të na detyroni t'ua këthejmë dhuratën". Në natën e darkës së madhe pasi të hyjë nusja në sallë në ora 21, bëhet duhaja e kurorëzimit nga personi i autorizuar fetar {pa përdorimin e alkoolit} e pastaj vazhdon gazmendi. Kurorëzimi i çiftit të ri bëhet në ambientet e Bashkësisë Islame duke qenë pjesëmarrës vetë çifti dhe jo i përfaqësuar nga të tjerët. Të nesërmën pas darkës së madhe, në mëngjës të mos bëhet treguarja e bohçallëqeve para mysafirëve. Një gjë e tillë nuk duhet të praktikohet as edhe në xhumanë e madhe. Gjatë xhumasë dhoma e nuses duhet të mbetet e mbyllur dhe të mos u tregohet vizitorëve, sepse pikësynim i vizitorëve duhet të jetë nusja e jo orenditë shtëpiake. Në natën e kollit duhet të ftohen vetëm persona që i takojnë rrethit të ngushtë familjar dhe përsonat që nuk kanë pasur mundësi të marrin pjesë në darkën e madhe të dasmës. Sipas traditës së vjetër dibrane kokat për nusen e re organizohen në shtëpi në një rreth të ngushtë dhe me shpenzime te vogla, e jo si po veprohet tani nëpër restorante dhe me shpenzime të mëdha. Darka "mik së pari"- përviçe ka ruajtur modestinë tradicionale dhe duhet vazhduar dhe ruajtur si të tillë.

Vdekja si ceremoni hidhërimi shpallet dhe bëhet e njohur përmes fjaltorit dhe sallave në xhami. Nga aspekti fetar islam është gjë e tepruar të organizohen vajtime me britma shurdhuese korale që kalojnë në ritual. Kufoma mbetet në shtëpinë e saj deri kur të bëhet varrimi. Zakonisht varrimi bëhet në mesditë ose iqendi, por mund të bëhet edhe në kohë të pakufizuar kur rrethanat janë të jashtëzakonshme. Në konaqe pritet tri ditë radhazi, bura e gra. Konaku mbyllet përfundimisht pas ditës së tretë. Darkat për të vdekurin dhe të ftuarit me lista të posaçme qoftë nga aspekti fetar dhe nga ai material janë të pabaza dhe ndalohet organizimi i tyre. Në konak shtrohet bukë vetëm për përsonat e afërm të cilët presin e përcjellin vizitorët që vijnë të ngushëllojnë. Në konakun e grave të mos bëhen pritje të posaçme për miqësinë e re, konaku është i hapur për të gjithë njëlloj. Ndërpriten vizitat ngushëlluese ditëve të marta e të premte gjashtë javë rrjesht, siç po praktikohet tani. Zija në familje më së shumti mund të zgjasë 6 javë për gratë e reja dhe 6 muaj për gratë e moshuara. Përkujtimet për të vdekurin, 6 javët, 6 muajtë, motmoti, të mbahen në xhami dhe jo me rituale në shtëpi. Ndalohet veshja e grave me të zeza si edhe përdorimi i shallit për gratë e reja.

Këto janë normat e parashikuara të Besëlidhjes Dibrane për të flakur zakonet dekadente e të tepruara dhe për të ruajtur pastërtinë e zakoneve shqiptare dibrane nga çdo ndikim i jashtëm.

U apelua dhe u prit që dibranët ta vënë menjëherë në jetë këtë besëlidhje, me çka gjeneratave të tashme dhe brezave të ardhshëm do tu mbetej vetëm përdorimi i zakoneve të pastërta shqiptare dibrane.

Për fat të keq kjo nuk u arrit, sepse ata dibranë që pritej ta respektonin të parët këtë besëlidhje, e shkelën atë, dhe sot e kësaj dite në të gjitha ceremonitë e lartpërmendura vazhdon avazi i vjetër dhe asgjë nuk ka ndryshuar në këtë drejtim. Kjo punë me sa duket nuk është e lehtë dhe ky akull që duhet thyer nuk është aqë i hollë.

Puna në zbatimin e Besëlidhjes Dibrane duhet vazhduar edhe në të ardhmen. Besëlidhja Dibrane duhet sensibilizuar dhe zbatuar, sepse ngërthen në vete dimension kompleks social, filozofik, psikologjik, kulturor, fetar, bajraktaresk, të sedrës dhe ndikimit nga diaspora.

**Për opinione dhe komente mund të na shkruani në adresën: "rrugaearberit@gmail.com". Tel. 00355 4 22 33 283.**

OPINIONET DHE KOMENTET E BOTUARA NUK SHPREHIN DOMOSDOSHMËRISHT QËNDRIMIN E REDAKSISË

reportazh

# Shumë parti për një kokër lajthi

Ethet parazgjedhore për zgjedhjet e parakohshme parlamentare në Maqedoni i kanë kapur edhe partitë shqiptare.

Për 20 vite të demokracisë në Maqedoni janë themeluar shumë parti shqiptare. Rritje të partive politike shqiptare ka edhe në Shqipëri, Kosovë, Luginën e Preshëvës dhe në Malin e Zi.

A na nevojiten kaqë parti politike ? Me siguri që jo. Sidomos në Maqedoni, Mal të Zi dhe në Luginën e Preshevës, ku në mënyrë të vazhdueshme ekziston rreziku i shpërndarjes së votës shqiptare dhe i majorizimit të faktorit shqiptar. Në të parë numri kaq i madh i partive shqiptare duket begati politike, por nga ana tjetër sjell dobësim të unitetit shqiptar, të forcës prezentuese dhe vendimmarëse në arenën e brendshme dhe atë ndërkombëtare.

Fakti se shqiptarët jetojnë të ndarë në pesë shtete, se më shumë se 15 milionë shqiptarë janë shpërndarë nëpër botë, duke u përballur me fenomenin e asimilimit, flet qartë se është më se i nevojshëm një organizim konstruktiv bashkues partiak e kombëtar.

Po tu hedhim një sy partive politike shqiptare në Maqedoni shohim se programet e tyre janë të përafërta, ndërsa nga ana tjetër në vazhdimësi janë duke u shkaktuar përçarje që reflektohen edhe në diasporë. Bashkimi i forcës shqiptare brënda dhe jashtë, është ajo që gjithmonë na ka munguar, duke e topitur ngulmin shqiptar për zgjidhjen e problemeve madhore. E tërë kjo flet për përgjegjësinë historike kombëtare që duhet ta kenë partitë shqiptare, të cilat me numrin e tyre aqë të madh e kanë dëmtuar çështjen shqiptare në të gjitha trojet.

Numri i madh i partive shqiptare është shkaku kryesor pse ne nuk mund të arrijmë në praktikë të bashkohemi si një grusht i vetëm. Numri i madh i partive politike shqiptare, bën që forca e popullit të shpërndahet nga grushti në gishtërinj, dhe mprehtësia e shpatës për të prerë nyjet antishqiptare topitet dukshëm. Numri kaqë i madh i partive politike shqiptare ndikon që të bëjmë më shumë inat se politikë të mirfilltë.

Shqiptarëve nuk u nevojiten kaqë parti politike. Për të patur efekte pozitive më të mëdha, mëndja dhe energjia kombëtare duhet të përqëndrohet në më pak parti.

Numri kaqë i madh i partive politike nuk mund t'i sjell të mira popullit shqiptar, por vetëm përçarje, realizim vetëm të interesave të ngushta individuale e grupore, qëllimi i të cilëve është përfitimi material, zënia e ndonjë posti deputeti, apo e ndonjë posti tjetër, se sa interesi kombëtar shqiptar.

Për popullin do të ishte më mirë që brënda partive shqiptare të ishte i pranishëm guximi kritik e konstruktiv reformues brëndapartiak, për të luftuar me vendosmëri karierizmin, oportuzimin, familjarizmin dhe korrupsionin atje ku ekziston, se sa krijimi degëzues i një numri kaqë të madh të partive.

I vogël është kulaçi shqiptar në Maqedoni për tu ndarë në kaqë shumë parti politike. Shumë e vogël do të jetë edhe fuqia e votës shqiptare e ndarë në kaqë shumë parti. Është koha e fundit që partitë politike shqiptare të vetëdijësohen e të bashkohen për ta forcuar votën shqiptare dhe për ta rritur numrin e deputetëve tanë.

Populli shqiptar nuk mund të mbajë mbi supe numër kaqë të madh të partive politike. Kjo i ngjan thënies popullore, " Shumë vëllezër e ndajnë një kokër lajthi", me ç'rast dhe vëllezërit edhe populli mbeten sërish të urritur.

**REXHEP TORTE**

# Ditët e Sllatinës

*Nga:* **SHAQIR SKARRA**

Është bërë tashmë traditë e bukur e banorëve të Sllatinës që çdo vit, në javën e parë të majit të mblidhen të gjithë së bashku e të festojnë ditën e Sllatinës. Sivjet ishte viti i gjashtë për sllatinasit që festonin ditën e tyre në metropolin shqiptar tek lokali "Sllatina" në Paskuqan. Jo vetëm kaq, por sllatinasit kanë dhe një datë tjetër që tok së bashku mblidhen përsëri e pikërisht në çdo 30 qershor, por ndryshe nga e para këtu shkojnë në bjeshkët e bukura të Gramës nën këmbët e malit shekullor të Korabit e ky komunitet që ka vite e vite që jeton në Sllatinë një natë e gdhijnë tok të gjithë në bjeshkët e Gramës. E kështu të dyja së bashku këto ditë njihen në popull si ditët e Sllatinës. Kjo traditë e bukur mori udhë në vitin 2000 ku vetëm njëmbëdhjet veta nga Tirana u nisën e bashkë me sllatinasit e tjerë u ngjitën në bjeshkë duke u futur kjo ditë në kalendarin e Sllatinës e duke marrë kështu udhë si dita e Sllatinës. Nismëtarët e parë të këtij aktiviteti komunitar ishin Fuat Beqiri, Urim Çekiçi, Faik Plaku, Emri Çollaku e i ndjeri Shkëlqim Mila, i cili edhe pse në grupin nismëtar nuk mundi të ngjitej bashkë me bashkëfshatarët e tij në bjeshkë pasi vdekja e parakohshme nuk ia dha këtë privilegj të bukur. Por vetë banorët e Sllatinës duke parë lëvizjet e shumta demografike që po ndodhnin vitet e fundit nuk mjaftuan vetëm me këtë datë simbolike si ditë e Sllatinës. Shumë veta ndoshta dhe nga mosha por dhe arsye të tjera nuk mundnin të ngjiteshin në bjeshkë . Kështu që u mblodhën sërish bashkë e vendosën një tjetër datë për Sllatinën por tashmë në metropolin shqiptar pasi shumë familje këtu jetojnë prej vitesh. Ishte viti 2005 kur tek lokali i Besim Çekiçit në Paskuqan në saj të grupit nismëtar si Sait Mila, Uk Plaku, Bajram Çekiçi e Sejdi Hysa u mblodhën herën e parë për të vazhduar çdo vit këtë rit të bukur, këtë festë fshatçe që e nisën bashkë dhe po bashkë po e vazhdojnë për çdo vit. E që nga ky vit më datën 30 qershor bjeshkëve të Gramës si një tubim masiv ngjiten lart mosha të ndryshme por të ardhur dhe nga jashtë djemë të Sllatinës që janë në emigracion. Dhe janë pikërisht këto që sposorizojnë të tilla aktivitete për vendlindjen. . Në bjeshkë çdo vit ftohen dhe nga fshatrat përreth Sllatinës si Venisht, Dypjakë, Sllovë e Shumbat si dhe përfaqësues nga komuna e Sllovës. E në një të ardhme të shpejtë sllatinasit tashmë që kanë ditët e tyre do të formojnë dhe shoqatën "Sllatina". Kanë simbolet e fshatit si emblemën dhe flamurin e tyre një flamur ky i ideuar dhe sponsorizuar nga Hazbi Çollaku, me një sfond të gjelbër dhe një emblemë në formë piramide në mes në ngjyrë të bardhë që simbolizon majën e Pelpenikut, majën më të lartë por dhe maja symbol i Sllatinës. Dhe për këtë maje ka dhe një gojedhënë të bukur e cila ka ardhur deri në ditët tona. Thonë se i mbeti ky emër nga një banor i Sllatinës që jetonte në ato vite në Gramatik (Kumbull) i quajtur Nikë. Ky Nika paska rënë një ditë tek kulloste bagëtitë nga maja e lartë poshtë por kishte rënë pil. Kështu i mbeti emri i kësaj maje "Pil Nika" e sot quhet Pelpeniku. Sllatinasit kanë dhe këngën e fshatit si dhe hitin e tyre muzikor me tekst të Naim Plakut e muzikë të Safat Plakut, e cila këndodhet në çdo aktivitet të fshatit e cila është bërë si në formë hymni për Sllatinën sot. Janë pikërisht moshat e reja sot që kërkojnë të mbajnë ndezur atë traditë të bukur që ka patur fshati vite me radhë, atë traditë që të gjitha fiset e Sllatinës ishin bashkë në ditë të mirë dhe ditë të vështirë. Lëvizjet e shumta demografike bënë që njerëzit të largohen nga fshati por dhe shumë veta të emigrojnë jashtë. Kjo traditë e bukur e sapo nisur përsëri i bashkon sllatinasit si dikur, i bashkon të gjithë në një sofër të përbashkët se Sllatina ka qenë shquar për mikpritje e bujari. Në sofrat bujare të Tafë Dautit, Shemsi Plakut e Bezat Beqirit sa e sa veta janë ulur, të njohur e të pa njohur, miq por dhe rrugëtar, partizan por dhe pushtetarë të asaj kohe. Është shkruar herë pas here për Sllatinën dhe banorët e saj, për vlerat dhe kontributin që kanë dhënë, për njerëzit e saj sa punëtor, me kulturë e arsimdashës. Janë vetë djemtë e Sllatinës, më së shumti ato që jetojnë e punojnë jashtë vendit që çdo vit po sponsorizojnë aktivitete të tilla, aktivitete ku bashkohen në një ditë të vetme të gjitha fiset e Sllatinës bashkë, thua se vërtet është një dasëm e madhe e fshatit. Jo vetëm kaq por Sllatina ka ngritur vetë dhe xhaminë e fshatit, një xhami kjo që ndoshta më e bukura në të gjithë zonën. E ideuar nga Haxhi Daut Çollaku dhe sponsorizuesi kryesor firma "Druri shqip" me administrator Hazbi Çollaku. Për ndërtimin e saj kanë dhënë kontribute dhe mjaft sllatinas të tjerë me banim brenda dhe jashtë Sllatinës si dhe banorë nga zona të tjera ku sot emrat e të gjithëve ruhen jo vetëm në kujtesën popullore të sllatinasve por dhe në shënimet e sakta që ka mbajtur komisioni organizator. . Edhe rruga nga Sllatina për në bjeshkë, distancë kjo prej 8 kilometra nuk u ndërtua me fonde të komunës por ishte fondi personal i familjes së Daut Çollakut ai që bëri të mundur ndërtimin e kësaj rruge e cila i nevojitet fshatit. Sllatina, kjo perlë e natyrës shqiptare, ky fshat ndoshta më i madhi nga ana gjeografike në të gjithë Dibrën ka vlera të mëdha edhe për turizmin malor megjithëse është lënë pas dore dhe investimet këtu kanë qenë me pikatore. Sllatina kufizohet në veri me fshatin Vleshë dhe ndahet prej saj poshtë Gurit të Zi me Përruan e Keq. Në veriperëndim ndahet më Sllovën. Në perëndim me Trojakun. Në jugperëndim me Shumbatin. Në jug me Venishtin dhe në lindje me kufirin shtetëror të Republikës së Shqipërisë, kufi ky që u vendos në vitin 1913. Gjeografia e Sllatinës është e madhe edhe pse vetë fshati pas viteve nëntëdhjetë është tkurrur shumë, kanë emigruar shumë familje brenda e jashtë vendit. Kjo më së shumti është arsya që bën që sllatinasit të mblidhen dy herë në vit tok së bashku, të festojnë me njëri tjetrin të kujtojnë, të mos harrojnë të bukurën, traditat që ka patur fshati dikur. E vetë banorët e sllatinës e kanë dashur gjithmonë të bukurën, artin dhe kulturën por dhe arsimin. Aq kuadro kanë dalë nga Sllatina sa që po t ë kishte patur dhe Universitet të sajin nuk do dilnin të cilët sot drejtojnë e punojnë në sektor të ndryshëm të ekonomisë së vendit tonë.

Sot në fakt Sllatina është një fshat i vogël, me pak banorë që mbijeton me atë pak blegtori e bujqësi, por kryesisht nga kontributi i emigrantëve ku djemtë e sllatinës janë derdhur kudo nëpër botë ku me mundin dhe djersën e tyre kontriubojnë jo vetëm për familjen por dhe vetë për fshatin e tyre Sllatinën që e duan e nuk e harrojnë kurrë. Jo më kot e thamë që në fillim se fshati Sllatinë është një fshat që vërtet ia vlen të investohet e punohet seriozisht. Këtu ka resurse të mëdha për turizmin malor. Sot bjeshkët e Korabit, liqeni i Gramës, burimet me ujë akull të ftohtë, pyjet që sapo kanë filluar të rigjenerohen përsëri, Kumbulla apo qyteti i lashtë antic (pellazg) Gramatiku kanë vlera të pa kontestuara për turistët e huaj e jo vetëm Sllatina por nga këto bukuri që ia ka falur natyra Sllatinës mund dhe duhet të përfitojë e gjithë Dibra.

Rruga Arbërit nr. 61

**Dr. Jorgji Muzaka, nga Nju Jorku, intervistë ekzkluzive me Abdurahim Ashikun: Agronom, publicist, shkrimtar... njeri, në Kumtim në 70 vjetorin e lindjes.**

intervistë

# Prindërit duhet t'u mësojnë fëmijëve të flasin shqip

Nga: **Dr. JORGJI MUZAKA**

*Abdurahim Ashikun e njoh prej shumë ko hësh, qysh në auditorët e shkollës së lartë. I zgjuar, dinamik, i shkathtë, shumë njerëzor dhe me një forcë të fuqishme fjale... kështu e kam njohur. Ai është shfaqur kurdoherë si një intelektual progresiv që cilido prej nesh ka çfarë të mësojë prej tij. Vazhduam bashkëpunimin edhe në emigracion dhe një ditë, në Athinë arrita t'i marr një intervistë të cilën po e përcjell...*

*Por, përpara se të lexoni bisedën...*

*Cili është Abdurahim Ashiku ?*

*Abdurahim Ashiku lindi në katundin Brezhdan (Zdojan) më 11 maj të vitit 1941. Shkollën fillore e mbaroi në fshatin e lindjes. Dy klasë të shtatëvjeçares i bëri në Peshkopi duke udhëtuar çdo ditë 10-12 kilometra në këmbë. Shtatëvjeçaren (klasën e shtatë) dhe klasën e parë gjimnaz i bëri në Shkollën Ushtarake "Skënderbej" kurse tri klasë të shkollës së mesme i mbaroi në Teknikumin Bujqësor Fier. Në vjeshtë të vitit 1959, agronom i mesëm, e nisi punën në fshatin e lindjes, në kooperativën bujqësore Brezhdan – Zdojan, për të vazhduar deri në fund të gushtit 1961 agronom në lokalitetin e Muhurrit dhe atë të Qendrës.*

*Në shtator të vitit 1961 filloi studimet e larta në Institutin e Lartë Shtetëror të Bujqësisë në Tiranë (sot Universiteti Bujqësor Tiranë), studime të cilat i mbaroi më 16 shkurt 1966.*

*Si agronom i lartë e nisi punën si përgjegjës i sektorit të Qendrës në Ndërmarrjen Bujqësore të Dibrës për të vazhduar më tej si mësues i lëndëve teknike në Shkollën e Mesme Bujqësore "Nazmi Rushiti" të Peshkopisë, si gazetar në Agjencinë Telegrafike Shqiptare për rrethet Dibër e Mat, si gazetar i gazetës lokale "Ushtima e Maleve", për ta mbyllur rrethin e jetës në Shqipëri si gazetar i "Zërit të Popullit". Pas 21 korrikut 1996 nisi jetën dhe punën e emigrantit në Greqi, jetë dhe punë që e vazhdon edhe sot kur ka hyrë në dekadën e tetëdhjetë të jetës së tij.*

*Dashuri e jetës së tij ka qenë puna si pjesë e intelektit dibran në krijimin e blloqeve të mëdhenj frutorë të Dibrës dhe gazetaria. Kjo e fundit, siç thotë ai, nisi me një reportazh udhëtimi me bashkënxënësit e klasës në Apoloni të Fierit, reportazh që u botua në vitin 1957 në gazetën "Sporti Popullor", për të vazhduar më tej me "Zërin e Rinisë", nga Fieri gjatë viteve të shkollës së mesme, dhe nga Instituti i Lartë Shtetëror i Bujqësisë gjatë viteve studentore, dashuri të cilën do ta shtrinte në kohë e hapësirë, në bashkëpunime me gazeta e revista të ndryshme, me radion e televizionin, me gazetat në emigracion.*

*Fryt i punës së tij janë edhe përmbledhjet publicistike "Njerëz që i dua", "Rilindësit e kohës sonë", "Shkolla shqiptare e Athinës-Rilindësit e kohës sonë 2", "Po Dibrës! Jo Skavicës" dhe "Rrëfimet e komshiut" me tregime të jetuara, libër që del në qarkullim në 70 vjetorin e lindjes së tij. Të pesë librat me afro 2000 faqe janë pjesë e një serie publicistike nën emrin "Njerëz që i dua".*

*Abdurahim Ashiku është i martuar, ka dy djem dhe një vajzë, dy nipër e një mbesë. Në Greqi jeton me gruan dhe djalin e vogël specialist i lartë për informatikë.*

*Biseda e mëposhtme, e filmuar, është bërë më 9 prill 2007, pak ditë para se unë të largohesha nga Greqia për në Amerikë, freskuar me të rejat e çastit në ditët e para të majit 2011 kur u takova me të në Athinë.*

*Me këtë rast i urojmë Abdurahim Ashikut edhe njëqind vite të tjerë të lumtur, plot shëndet, krijimtari dhe "rendimente t' larta në letërsi", për të mirën e shoqërisë dhe të familjes.*

**Zoti Abdurahim, mendova të ndërrojmë rolet dhe të bëj një intervistë me ju, si thoni, jeni gati ?**

Sigurish që po. Dua të theksoj se është hera e parë që jap intervistë, ndërkohë që gjithë jetën time kam marrë intervista. Nuk di në se do jem i devotshëm për një bisedë kaq të ngrohtë me një njeri, që me thënë të drejtën, e dua shumë.

***Faleminderit! Atëherë fillojmë. Diçka për familjen tuaj, për të parët, për krahinën tuaj të mrekullueshme?***

Po më ktheni shumë vite prapa. Linda në vitin 1941. Në dokumente e kam ditëlindjen më 11 Maj. Nëna me pat thënë se linda pesë ditë para Ditës së Verës, pra i bije të kem lindur më 9 mars. Sipas traditës dibrane këtë ditë ngjyrosen vezë të kuqe dhe njerëzit kishin mbledhur për mua, mbasi isha me i vogli në lagje, një shportë të tërë me vezë të ngjyera me bojë alle. Regjistrimi më 11 maj është i lidhur me kohën e luftës, me evakuimin e familjes nga fshati për shkak të përgatitjeve që bënte Italia fashiste për pushtimin e Jugosllavisë dhe rrethana të tjera të kohës.

U linda në një familje që kishte 5 dynym tokë dhe një zabel me gështenja, frutat e të cilave mund të them se na mbajtën shpirtin gjallë gjatë luftës dhe në vitet e vështira pas çlirimit. Ato ishin për ne edhe bukë edhe të ardhura në para nga shitjet në pazar.

Babai im, Hajredin Ashiku, rridhte nga një familje fshatare. Gjyshi im, Rexhepi, është vrarë nga serbët në vitin 1919 kur babai ishte 6 vjeç, ndërsa gjyshja ime, Shamja, e la babanë vetëm 12 vjeç. Ai u rrit derë më derë deri sa u martua me Defen, nënën time. Babai dhe nëna nuk jetojnë. Babai vdiq në mars 1991, ndërsa nëna në prill 1992. Shkuan, siç themi ne në Dibër "Si mal me lule", duke lënë pas pesë djem, dy vajza dhe 25 nipër e mbesa, një lagje të tërë ashikësh të rinj. Lindën dhe u rritën në fshatin Brezhdan, fshati më i madh i Dibrës me mbi 300 shtëpi. Në vitet 50-të ai u nda dhe ne na ra të jetonim në fshatin Zdojan, emër i vjetër i lidhur me toponimi të lashtë dhe me emrin e një lagjeje të madhe sot. Babai nuk ka qenë asnjë ditë në shkollë. Shkrim dhe lexim mësoi "vjedhurazi". Kishte një shkrim shumë të bukur dhe lexonte shumë libra që i sillja. Nëna mësoi pak të shkruaj e lexojë në kurset kundër analfabetizmit. Zdojani ndodhet, kreu në trojet e fisit të Ashikëve, 5 kilometra, kurse fundi në trojet e Mane, 7 kilometra larg qytetit të Peshkopisë. Është shumë i bukur. Ka në sfond Drinin në tallazet e të cilit mësova notin, ka një fushë të madhe dhe një radhë kodrash, ka një perëndim të mrekullueshëm kur dielli fshihet mbas Runjës e Gjagjishtit për ti ndalë paksa rrezet mbi gjelbërimin dhe kaltërsinë e liqeneve të Lurës. Lindja e diellit vjen majave të maleve që nisin me Korabin e mbarojnë me Valivarin, Kërçinin, vargmaleve që pushojnë paksa në ultësirën e Maqellarës dhe Dibrës së Madhe, qytetit në anën tjetër të kufirit shqiptaro-shqiptar, për të vazhduar me malet e Gollobordës.

***Diçka për fëmijërinë tuaj të hershme?***

Kujtimet e hershme të fëmijërisë time lidhen me klasën e parë në shkollën e fshatit ku u linda dhe nisa të mësoj. Mësuesi i klasës së parë, Bajram Çipuri ishte dibran, ndërsa tre tjerët kanë qenë Gavril Kote nga Përmeti, Nigjare Velçani nga Berati dhe Mark Kalaj nga Shkodra. Me Gavrilin dhe Nigjaren, pas një shkrimi për mësuesit në vitin 1993, si përgjigje, kam dy letra që i ruaj me mall e dashuri, letra që do ti gjeni në librin "Rilindësit e kohës sonë".



Mes minatorësh

Pasi mbarova katër klasë të fillores u rashë këmbëve dhe shkova në shkollën shtatëvjeçare në qytetin e bukur të Peshkopisë, duke bërë çdo ditë 10-12 kilometra rrugë më këmbë. Mësoja nën dritën e kandilit dhe me vonë të llambës me vajguri. Drita elektrike në fshatin tim erdhi në vjeshtën e vitit 1955 kur unë isha nis rrugës së madhe të jetës. Theksoj se kanali që furnizonte me ujë hidrocentralin kalonte rrëzë themeleve të avllisë sonë, mes përmes tokës sonë, për tu ndalur në një hauz e për të rënë me forcë nëpërmjet një tubi të çeliktë që zbriste mes përmes vreshtit tonë.

***Kam parë foto tuajat në moshë të re, midis të tjerave edhe ushtarak, si shpjegohet?***

Në fillim të gushtit 1954, duke qenë se isha nga nxënësit më të mirë në mësime në 7-vjeçare, trokitën në derën e shtëpisë sime dy oficerë dhe i kërkuan babait të më jepte leje që të shkoja në shkollën ushtarake. Në fund të gushtit 1954 mora rrugën drejt Tiranës, në shkollën"Skënderbej" ku mbarova klasën e 7-të dhe të parën gjimnaz. Shkolla asokohe ishte atje ku është sot Spitali Ushtarak. Një vit me vonë shkuam atje ku ishte Shkolla e Bashkuar e Oficerëve...

Viti 1956 ishte viti i lëvizjeve të mëdha, viti i formimit të shumë kooperativave dhe bujqësia kishte nevojë për kuadro e për njerëz të kualifikuar. Me kërkesë të rrethit të Dibrës, të fshatit tim që tashmë ishte bërë kooperativë, ndërrova profil, kjo në kundërshtim me shkollën ushtarake, mbasi isha nga nxënësit e shkëlqyer në mësime. Forca e kohës më kaloi në vitin 1956 në Teknikumin Bujqësor Fier.

***Cilat ishin prirjet dhe pasionet tuaja ne shkollën e mesme?***

Në këtë moshë kam qenë i dhënë shumë pas leximeve, sidomos në shkollën "Skënderbej". Lëndët ekzakte i përvetësoja shpejt dhe më ngelte kohë të lexoja e të shfletoja edhe librat që kishte biblioteka, një bibliotekë mjaft e pasur. Më pëlqente të lexoja letërsi artistike, libra historikë etj. Pasionin për librin e mora që vitin e parë në shkollën "Skënderbej". Këtë pasion për leximin ma ka nxitur më shumë mësuesja e letërsisë e kësaj shkolle, një vajzë që ne, nxitur nga "Iliada" e Homerit, e thërrisnim "Penelopa". Fatkeqësisht nuk ia mësova emrin kurrë. Ajo kishte kulturë të gjerë dhe ishte e pasionuar pas letërsisë, sidomos asaj greke dhe romake, pas Homerit, Virgjilit, Dantes, Euripidit, Sofokliut, Eskilit...

Në shkollën e mesme bujqësore të Fierit do të mësoja shumë nga dy mësues të mi shumë të dashur e të nderuar të letërsisë e gjuhës, Nikolla Margilaj dhe Nexhip Gami. Në bibliotekën e Fierit kam qenë lexuesi i rregullt. Në bllokun tim të kujtimeve kam edhe një shënim nga bibliotekarja Urani Verria.

***Mund të na kujtoni diçka nga periudha në shkollën e lartë. Si e keni kaluar atje?***

Shkolla e lartë është një pjesë nga më të bukurat e jetës sime. Ajo ishte e vendosur në kodrat e Kamzës, atje ku gjendet edhe sot. E fillova në shtator 1961, pasi kisha punuar dy vjet si agronom i mesëm. Në atë periudhë më pëlqente shumë të ndiqja shfaqjet e kohës, veçanërisht operat klasike. Merrja me vete edhe rrezikun e humbjes së darkës e të bëja 10 kilometra rrugë më këmbë nga Tirana deri në konvikt, mbasi autobusi i fundit nisej në orën 8. 30 të mbrëmjes, ndërsa shfaqja mbaronte më vonë. Mund të them se në ato vite nuk kam lënë opera të klasikëve të mëdhenj të muzikës pa parë. Në ato vite janë vënë në skenën e Teatrit të Operës dhe Baletit shumë opera të mëdha, opera që sot nuk e di pse janë harruar. Të njëjtën gjë do të thosha edhe për veprat dramatike. Teatri Popullor si dhe Teatri i Operës, me atë kulturën që rrezatonte, hyrjen duke veshur rrobat më të mira që kishe, me shërbimin në gardërobë, me qetësinë në sallë më ngjall gjithnjë prehje dhe nostalgji. Me mall dhe dashuri kujtoj skenën në dramën "Dhelpra dhe rrushtë", dy më të mëdhenjtë e skenës dhe të ekranit shqiptar, Kadri Roshin dhe Margarita Xhepën, atëherë shumë të rinj.

Dua të theksoj se në atë periudhë kishim një shoqëri dhe miqësi të ngushtë me njeri- tjetrin, e donim shoqi-shoqin pa interes.

***Në këtë periudhë keni filluar edhe të shkruani. Diçka për fillimet tuaja në fushën e gazetarisë?***

Shkrimi i parë imi i përket shkollës së mesme në Fier dhe është i vitit 1957. Bëmë një

cyan magenta yellow black

# intervistë

ekskursion në Apoloni, Pojan, me shkollën. Apolonia e asaj kohe ishte një grumbull dheu relikembuluar, kishte edhe një kishë të vjetër, ishte shumë larg asaj që është sot. Bëra një shkrim për këtë aktivitet dhe e dërgova tek gazeta "Sporti Popullor". Ajo ka qenë gazeta e parë ku unë kam vendosur ndjenjat dhe emrin tim. Më vonë po nga Fieri fillova të bashkëpunoj me gazetën "Zëri i Rinisë". Vitet 1957-1959 kanë qenë vitet që unë kam bërë shumë shkrime dhe po të hapësh e shfletosh gjen edhe pjesë të historisë së Shkollës së Mesme Bujqësore të Fierit.

***Dhe e vazhduat dhe e përsosët këtë pasion edhe në Institutin e Lartë Bujqësor?***

E vazhdova edhe dy vjet që punova në Dibër, nuk e ndërpreva, sepse ishte një dëshirë që buronte nga brenda. Edhe atje shkrova për Dibrën. Bëra disa reportazhe, përshkrime, portrete, intervista.

Kur isha në Institutin Bujqësor për pesë vite me radhë gati numër për numër isha i pranishëm në gazetën "Zëri i Rinisë". Isha i mirëpritur dhe shkrimet që dërgoja mund të them që kalonin drejt e tek daktilografistet e pastaj në shtypshkronjë. Me këtë rast dua tu shpreh mirënjohjen dhe dashurinë time redaktorëve të asaj kohe që u bënë miq dhe shokë të mi: Luan Dibra, Loni Papa, Vath Koreshi, Kliton Gjilani, Pirro Tase, Zef Gurakuqi, sekretares së kolegjiumit Liri Lubonja, kryeredaktorit Dhimitër Verli, Dyrrit, korrektorit teknik dhe të tjerëve.

***Po shprehja juaj "Adresa jonë është mali dhe fusha, atje ku mbillet dhe korret" si lindi?***

Ishte një shprehje e momentit dalë gjatë përshëndetjes ditën e marrjes së diplomës së agronomit të lartë. E kam thënë më 16 shkurt 1966. Pata nderin që të marr diplomën nga dora e Pirro Dodbibës, Ministër i Bujqësisë dhe një ndër specialistët e mëdhenj të bujqësisë shqiptare, të më shtrëngojë dorën dhe të marr urimin e shkencëtarit më të madh të shkencave bujqësore (për mua) Gaqo Tashko, rektor i Institutit të Lartë Shtetëror të Bujqësisë, të duartrokitëm nga kolegët e mi të sapodiplomuar, nga studentët midis të cilëve edhe prej jush që ju ka mbetur në kujtesë kjo shprehje. Ishte koha kur në Shqipëri po ndodhnin lëvizje të madha. Goxha kuadro me kulturë e dije shkuan nëpër rrethe për ndihmë. Në Dibër erdhi edhe profesor Isa Shehu pedagogu im i frutikulturës me të cilin u bëra koleg. E dhashë atë adresë, se adresa e një agronomi nuk mund të jetë në vend tjetër, veç fushës dhe malit, atje ku mbillet dhe korret. Kjo për dje, por edhe për sot. Kam disa fotografi nga ai çast i bukur i jetës sime, fotografi që më ngjallin kujtime të bukura.

***Pasi mbaruat shkollën e lartë si eci rrjedha e jetës suaj. Mund të na e përshkruani më shkurt ?***

Shkova atje ku mbillet dhe korret! Por, para kësaj do të përqendrohem në dy momente përfshi edhe pas mbarimit të shkollës së mesme. E nisa punën si agronom i mesëm në kooperativën e fshatit tim, kooperativën Brezhdan-Zdojan, atje ku linda. Pastaj më emëruan në lokalitetin e Muhurrit e më pas në atë të Qendrës. U mora me piketimin e blloqeve të para frutore. Kam qenë nga ata kuadro të rinj që kam vënë piketa, kam drejtuar punën për hapjen e gropave mbjelljen e pemëve të para në blloqet frutore dhe vreshtave në sektorin e Zdojanit, në Kuben dhe Ravna. Këtu bëhet fjalë për vitin 1960, vit kur mori shtrirje të gjerë krijimi i blloqeve të mëdhenj frutorë në Dibër.

Kur u ktheva nga shkolla e lartë në 1966, në blloqet që me mjeshtrin e madh të pemëtarisë dibrane Xhavit Hysa kishim piketuar e mbjellë, në vreshtat në hyrje të qytetit, bashkë me të arrita të jem vjelësi. Në atë bllok vreshtash, dhe në të gjithë blloqet frutore të Dibrës është ngjizur puna e madhe e të lavdishmit të pemëtarisë Xhavit Hysa, të cilit meriton t'i bësh jo vetëm një libër (e kam plagë që jam larg dhe nuk mund ta bëj) por edhe një monument e ta shpallësh nderi i kombit. Duke menduar se vreshtat një ditë do të plakeshin, mbollëm qershi dhe vishnje në mes rreshtave dhe lajthi në brezare të cilat më vonë formuan një pyll të tërë drufrutorësh, të pashoq në Shqipëri.

Punova rreth dy vjet përgjegjës sektori dhe pastaj më emëruan mësues në shkollën e mesme bujqësore. Atje kam dhënë lëndën e Fitoteknisë dhe Mekaniken Bujqësore. Dëshira për të dhënë diçka më shumë më shtyu të bëja edhe një ofiçinë dhe duke punuar u bëra edhe saldator dhe axhustator. Ky zanat më ndihmoi edhe në emigracion.

Pas shkollës bujqësore shkova në kooperativë bujqësore Zerqan e pastaj në Agjencinë Telegrafike Shqiptare si korrespondent për Dibrën e Matin. Kam punuar dy vjet në Stacionin Bujqësor të Dibrës ku ndër të tjera isha nismëtar dhe organizator i "Festës së Parë Kombëtare të Mollës", veprimtari me jehonë të gjerë në saj të pjesëmarrjes nga e gjithë Shqipëria.

Kam qenë anëtar i Partisë së Punës së Shqipërisë, pjesë e jetës sime, për të cilën nuk e ul kokën.

Kam punuar në gazetën "Ushtima e maleve", bashkëpunëtor që në numrin e parë - 27 prill 1968- në atë masë sa mund të them se jam ndër krijuesit e saj. Kam punuar edhe redaktor i saj deri në fund të qershorit 1991.

***Po më vonë ku keni punuar?***

Vitet '90-të do të më gjenin gazetar në gazetën "Zëri i Popullit", vite të ndryshimeve të mëdha. Në gazetë, gjithnjë nga Dibra, kam trajtuar problemet e kohës duke e vënë penën time në mbrojtje edhe të atyre pemëve që më kishte takuar ti mbjell vetë dhe që segmente të caktuara të errësirës që erdhi bashkë me dritën, i vunë sëpatën. Kjo për mua ka qenë dhe është një nga krimet më të mëdha të periudhës së kalimit, krim që fatkeqësisht përfshiu tërë Shqipërinë duke prerë e shkatërruar blloqe të tëra me pemë frutore, agrume, ullinj etj. Në "Zërin e Popullit", si gazetar profesionist, vazhdova deri në verën e vitit 1996.

**A ju kujtohet ndonjë shkrim që u ka lënë mbresa. Keni pasur raste përplasje me ndonjë institucion apo dikaster?**

Unë nuk i veçoj shkrimet e mia. Ata janë të gjithë njëlloj për mua, janë fëmijët e jetës time. Përplasje kam pasur. Po ti thuash vetes gazetar duhet të pranosh edhe përplasjet, madje edhe plumbin kokës. Profesioni i vetëm sot në botë që sipas statistikave vdes në krye të detyrës është ai i gazetarit. Në vitet 1988-1989 kam bërë një sërë shkrimesh në "Zërin e Popullit" për harresat e qeverisë në Dibër. Ishte koha kur ishte lënë pak i lirë "freni i kritikave", koha kur guximi dhe rrezikimi ishin vëllezër binjakë. Bëhej fjalë për rrugët e Dibrës që ishin mos më keq, për rrugë si ajo që në vitin 1946 mori emrin "Rruga e rinisë" e që kishte mbetur si në ditët e përurimit, për rrugë që me përjashtim të asaj që lidhte Peshkopinë me Tiranën (edhe ajo njëkalimëshe) nuk kishin parë një dorë asfalt, për shfrytëzimin e metaleve jo metalorë, për dhunën ndaj pyjeve, etj. Në gusht të vitit 1988, pas shkrimit për mineralet jo metalorë, si kundërpërgjigje doli në televizion Ministri i Ndërtimit me një pllakë mermeri në dorë duke kundërshtuar faktet që unë kisha përcjellë. Në vitin 1989, pas një shkrimi të fortë për shkatërrimin që po u bëhej pyjeve të Lurës duke prerë pisha qindravjeçare për bishta veglash erdhi në Peshkopi Kontrolli i Lartë i Shtetit. Me ta shkova në Lurë dhe u paraqita faktet e pakundërshtueshme, fakte që nuk guxoi kush ti kthejë kundër meje dhe të pësoja pushimin nga puna, në mos edhe burgun.

Në vitet '90-të përplasjet kanë qenë të karakterit tjetër, përplasje që çuan edhe në dhunë fizike, edhe në ndërhyrje kirurgjikale, edhe në largimin e dhunshëm nga Dibra e Shqipëria pas zgjedhjeve të njohura si zgjedhje të vjedhjes masive të votës së popullit, zgjedhjeve të 26 majit 1996.

Deri më sot artikujt e mi askush nuk mi ka përgënjeshtruar me fakte. Në jetën time si gazetar kam ecur me parimet: Shkrimet e mia janë shkrimet e mia, penën nuk ja kam lenë kurrkujt në dorë dhe për gjithë ato shkrime që nga viti 1957 deri më sot, po të kem mundësi t'i mbledh, nuk hedh asnjë në kosh. Ato janë mendimet e mia, janë jeta ime. Për mua gazetari, për të qenë sa më afër të vërtetës, duhet çdo gjë ta shohë me sy, ta dëgjojë me veshë, ta incizojë, fotografojë apo filmojë, ti afrohet sa më shumë të vërtetës së plotë.



***Çfarë tipi shkrimesh parapëlqeni, reportazhin, intervistën, portretin ?***

Unë i kam lëvruar të gjitha. Ka qenë një parcelë e madhe ku kam futur të gjitha mjetet e punës dhe njëkohësisht edhe gjitha llojet e farërave. I kam mbjellë dhe i kam korrur. Më ka pëlqyer portreti, reportazhi, përshkrimi, po ashtu më ka pëlqyer të hyj në psikologjinë e njeriut, të hyj në botën e tij dhe ta pasqyroj atë ashtu siç është, pa deformime e zbukurime.

**Çfarë mendimi keni për shtypin e shkruar në emigracion, si lindi dhe si u rrit ai?**

Para së gjithash dhe mbi të gjitha shtypi në emigracion është një pasuri kombëtare. Kur kam ardhur në emigracion ishte një gazetë me emrin "Egnatia". Ajo jetoi pak dhe u mbyll. Ata që e hapën ikën në Amerikë. Një shkrim kam bërë tek "Egnatia", në vitin 1996. Unë kam përjetuar dhe kam marrë pjesë aktive në krijimin e gazetës "Vëllazërimi", gazetë që doli më 15 mars 1997, në ditët kur dyert e gazetave në Shqipëri u dyllosën, madje edhe u dogjën dhe ekzistonte vetëm një televizion shtetëror që gënjente dhe nuk thoshte të vërtetën e atyre ditëve të kobshme për vendin e popullin shqiptar. Në të trajtoheshin ngjarjet që ndodhnin në Shqipëri. Burim informacioni ishin "Zëri Amerikës" dhe BBC-ja. Po ashtu informoheshim edhe nga televizioni grek i pranishëm drejtpërdrejt në ngjarje, lidhur me ato që po ndodhnin ne Shqipëri. Kjo doli gjashtë muaj dhe u mbyll.

Më vonë unë do të punoja në një gazete tjetër jetëshkurtër "Rilindja XXI", e cila doli disa muaj dhe për arsye financiare u mbyll. Më vonë doli gazeta "Zëri i Emigrantit". Edhe kjo u mbyll shpejt për arsye financiare. Shtypi në këto vite kaloi një periudhe të vështirë financiare.

Unë kam bashkëpunuar, madje edhe drejtuar gazetën "Rilindja XXI", "E vërteta", kam qenë i pranishëm në çdo numër të gazetës "Emigranti". Këto u mbyllën si edhe të tjerat. Dy vjetët e fundit kam bashkëpunuar me "Gazeta e Athinës" dhe tani me "Plus Gazeta e Athinës". Bashkëpunimi im ka qenë dhe është vullnetar. Brezit tim siç duket nuk do ti ndahet "puna komuniste" me të cilën ishim detyruar. Por kjo po ndodh edhe me brezin e ri të gazetarëve të cilët punojnë pa asnjë lloj honorari.

***A i keni të arkivuara shkrimet tuaja dhe a mendoni se ka ardhur koha ti përmblidhni në një libër?***

Të rinjtë, të emigracionit, që nga viti 2005 i kam në kompjuter. Nga ato kam marrë dhe ia kam përcjellë lexuesit tashmë në pesë libra me afro 2000 faqe. Kam edhe shumë shkrime të tjerë të fjetur të cilët do t'i zgjoj dalëngadalë.

***Folët për librin. Mund të na thoni diçka për bibliotekën tuaj personale, çfarë kapaciteti ka dhe të çfarë profili janë librat tuaja?***

E vetmja pasuri që më ka ngelur nga e kaluara është një bibliotekë me rimeso arre në shtëpinë tonë në Tiranë. Aty kam rreth 3000 libra të të gjitha fushave; artistike, historike, shkencore, politike etj. Nisem nga parimi që libri në bibliotekë është një pasuri, pavarësisht se çfarë libri është ai. Po ashtu edhe këtu në Greqi kam një bibliotekë të pasur me libra shqip dhe greqisht.

***Sipas jush, niveli i gazetarisë ka rritje apo ngelje në vend?***

Gazetaria ka rritje, ka hapësirë shumë më të madhe, por për fat të keq është komerciale. Në faqen e pare zë vend krimi, rrugaçëria. Kjo ndodh edhe në televizion. Gazetarisë shqiptare i mungon njeriu i punës, i mungojnë vlerat pozitive të popullit. Shkurt nuk më ngroh shumë gazetaria e sotme.

***Çfarë vendi zë fotografia ne veprimtarinë tuaj si gazetar?***

Me aparatin fotografik kam udhëtuar qysh në shkollën e mesme. E kam pas "gjymtyrë të pestë të trupit". Ato mijëra filma që i kam me vete në Athinë e që kapin një periudhë 50 vjeçare, një ditë do ti kaloj në kompjuter. Ato janë një pjesë e jetës sime, një prej dashurive të mia.

**Këtu janë hapur vitet e fundit disa shkolla. Ju keni bërë debate, përfshi edhe atë me ambasadorin Vili Minarolli. Cili është komenti juaj ?**

Unë e kam thënë fjalën time si gazetar dhe intelektual nëpërmjet dy librave; "Rilindësit e kohës sonë" dhe "Shkolla shqiptare e Athinës-Rilindësit e kohës sonë 2". E kam vazhduar më tej me shkrime të tëra sa edhe ato po ti mbledhësh bëjnë një libër të tretë për arsimin shqip në mërgim. Shkollimin e fëmijëve duhet ta marrin në dorë prindërit. Ata duhet tu mësojnë fëmijëve të flasin shqip. Ne i çojmë të mësojnë anglisht, frëngjisht etj. dhe harrojmë gjuhën e të parëve tanë.

Unë nuk pres që shteti shqiptar të kthej fytyrën nga fëmijët tanë. Unë e replikova me ambasadorin se ai në një intervistë nuk i jepte zgjidhje këtij problemi. Ambasadori përfaqëson shtetin dhe shteti për mua ka heq dorë nga kjo punë. Mua më pëlqen puna që ka bërë e bën Lorenc Koka. Ai bën një punë me të vërtetë atdhetare.

***Ju falënderoj zoti Abdurahim për intervistën kaq të çiltër dhe interesante që më dhatë. Ajo do jete pjesë e librit "Bashkëbisedim me njerëz... "***

Ju po ikni në Amerikë, por dijeni se po lini një boshllëk të madh në emigracion. Jeni njeriu që po merrni me vete një pasuri të madhe, kilometra të tërë filmimi të jetës së emigrantëve, një pjesë të mirë të njerëzve me të cilët jetuat e punuat për më se dhjetë vjet. Jeni nga të rrallët që keni punuar me kaq përkushtim. Ju admiroj.

***(Botuar me shkurtime)***

# Në Zakynthos, ishullin e shpellave nënujore

Zakynthos është ishulli i shumë bukurive marramendëse, me ujëra të kristalta dhe shpella nënujore, me breshkën e detit Kareta-Kareta. Qyteti ngrihet në jugperendim të bregdetit. Pas tij lartësohet kështjella venetiane. Më tej "Stranu Hills" me pamje fantastike. Brenda ndodhet një shëtitore e madhe me ndërtesa neoklasike, kisha me kulla të larta, rrugë të gjera, shtëpi me harqe dhe porta dekorative. Një qytet pohuajse i rindërtuar pas tërmetit të fuqishëm të 1953-shit që e shkatërroi pothuajse komplet. Vendet për t'u vizituar janë; "Metabizantine Museum", "Museum of Solomos", "Zakynthianët e famshëm" dhe "Kisha e Sainti Dyonysios", i konsideruar si mbrojtësi i ishullit, si dhe rrethina e bukur nga Bohali. Rrugët nga qyteti të çojnë në gjithë ishullin. Krahas bukurive përrallore dhe plazheve fantastike, ky ishull të habit edhe për historinë e lashtë plot ngjarje dhe figura të rëndësishme. Është sunduar nga maqedonasit, venetianët, romanët, bizantët dhe britanikët. Më 1809 britanikët formuan Shtetin e Jonit dhe Zakynthos-i u bë kryeqytet. Më 1863, anglezët i dhanë fund dominimit të ishullit dhe ishulli u bë pjesë e Greqisë. Njihet në historinë greke si ishulli i dytë i banuar. Gjatë mbretërimit të Odiseut të famshëm, 15 nga mtonjësit e Ithakës ishin nga Zakynthosi.

Këtu ka lindur poeti kombëtar i Greqisë, Dionisios Solomos, i cili ka shkruar Himnin Kombëtar të Greqisë. Një vizitë në muzeun e tij na njeh me jetën dhe veprën e tij madhore. Fama e tij në Greqi dhe në botë i detyrohet veprës së famshme "Imnos is tin Eleftheria " (Hymni i Lirisë), që është Himni kombëtar i Greqisë. Njëra nga pjesët e kësaj vepre u inspirua nga lufta e grekërve më 1821. Me vdekjen e tij më 1857 mbarë Greqia vajtoi për të. Të gjitha këto bukuri dhe ngjarje kanë shërbyer dhe shërbejnë si karem për miliona turistë nga e gjithë bota që vijnë në këtë ishull plot plazhe fantastike, disko famoze, si ato të Laganasë dhe gjelbërim të paanë, plot ahe e ullishte. Në këtë ishull të rrallë ka lindur më 7 tetor 2009 edhe djali im i vetëm, Mario. Në ishull banojnë shumë dibranë, të cilët me punën dhe duart e tyre të arta kanë zbukuruar tej mase këtë pjesëz të bukurisë greke. Ata janë të shumtë, por këtë herë, po flas për dibranin Haki Ferhatin, i cili është shqiptari më i vjetër dhe më i njohur i ishullit.

*Mentor Hoxha me shkrimtarin e njohur grek Dino Kubati (në mes) dhe shkrimtarin shqiptar Iliaz Bobaj.*

*Mentor Hoxha në Zakynthos*




## NJË KAFE ME HAKI FERHATIN

# Gurëgdhendësi që nderohet në gjithë Zakynthos-in

**Haki Ferhati** ka 20 vjet që jeton në këtë ishull. Është nga Sllova, por që nga viti 1985 banon në Tiranë. Në Zakynthos ka ardhur në vitin 1990. Pas triumfit të demokracisë, edhe Hakiu, si shumë shqiptarë të tjerë mori rrugën e vështirë të emigrimit me këmbë. Rrugën e parë për në Greqi e ka bërë me Arif Micin, Selami Lamin dhe Mina Elezin. Selami Lami kapet në Patër nga policia greke, ndërsa Hakiu, Selamiu dhe Minai përfundojnë në Zakynthos. Këto ishin edhe shqiptarët e parë të ishullit. Më pas Hakiu tërhoqi në ishull edhe shumë dibranë të tjerë, të cilët me duart e tyre të praruara i dhanë tjetër pamje qytetit. Fillimisht merr vëllain e tij të madh Lutin, që sot ushtron aktivitet privat në Tiranë, ndërsa më vonë afron tre vëllezërit e tjerë, Flamurin, Idrizin dhe Ibrahimin. Që të katërt u bënë specialistë të gurëgdhendjes, aq sa kërkesave të shumta të grekërve për t'iu ndërtuar shtëpitë dhe hotelet luksoze nuk mund t'u përgjigjeshin për shkak të punës së madhe që kishin. Hakiu, si

më i zgjuari, nxori një liçencë për ushtrim aktiviteti dhe për të qenë në rregull me ligjet e shtetit grek. Kështu që kërkesat ndaj tij u rritën akoma më shumë. Për ta përballuar këtë punë ai formoi tre skuadra ndërtimi me specialistë të gurëgdhendjes dhe të shtrimit me pllaka guri, duke ndihmuar me punë shumë dibranë, si dhe duke u mësuar atyre artin e bukur të skalitjes së gurit, për të cilët grekët e preferojnë aq shumë. Shtëpitë e gurit të ndërtuar nga duart e arta dhe mendja e intuita e Haki Ferhatit si drejtues dhe si mjeshtër arrijnë në 5 mijë, duke i dhënë një tjetër pamje ishullit. "Kur erdha në vitin 1990, kishte shumë pak shtëpi dhe pak bar-restorante e hotele. Sot ishulli është mbushur plot hotele, shtëpi dhe bar-restorante. E gjithë kjo punë gjigande dhe arkitekturore është bërë nga shqiptarët, sidomos nga dibranët", - na tregon Hakiu, teksa pinim një kafe në qytetin e Zakynthos. Më shumë se sa fjalët e mia dhe të Hakiut flasin këto foto me disa nga punët e tij. Hakiu ka dy fëmijë, një djalë, 15 vjeç dhe një vajzë 10 vjeç. Para se të emigronte, ai ka ushtruar sportin e mundjes, përkrah emrave të njohur të këtij sporti, si Abedin Lame, e të tjerë. Dashurinë për sportin i'a ka trashëguar edhe djalit, i cili është aktivizuar me një skuadër të njohur futbolli në Tiranë. Në Zakynthos takova dhe shumë dibranë të tjerë, duke marrë prej tyre dhe prej vendasve përshtypjet më të mira. Dibranëve ju flet mendja dhe dora. Ata janë pak të njohur në vendin e tyre, por shumë të njohur në ishullin magjepsës. Pa to, Zakynthosi do të ishte një ishull i zbrazur dhe pak i njohur në hartën turistike. Ishin pikërisht këta skulptorë dibranë që rikthyen lavdinë e këtij qyteti, i vunë kurorën e gurtë mbi atë ujore, duke e bërë ishullin të flasë krenar udhëve të botës. Çdo turist kur shkon në Zakynthos merr me vete dhe një pjesëz të mrekullisë dibrane. Nga pak ndërtesa madhështore që ishin para '90-ës, sot janë mijrafishuar nga dibranët. Dibranët mijrafishuan baret dhe restorantet, ngritën shtëpitë turistike prej guri si në antikitet, skalitën rrugët dhe sheshet, duke lënë zakinthianët dhe turistët e shumtë gojëhapur. Kudo që shkelën lanë gjurmët e punës dhe të talentit të tyre. Artin dhe dorën e tyre e gjen në çdo cep të ishullit; në ndërtim, turizëm, bujqësi, hoteleri, bar-restorante, biznes. Pra, kudo. Gjithçka që u serviret turistëve buron prej tyre. Janë pikërisht këta dibranë, si Hakiu, që ndryshuan faqen e Zakynthosit. Me artin e punës së tyre mbushën celuloidin e kamerave të shumta të turistëve, si relike të çmuara në vigjilje të kujtimeve, duke e kthyer ishullin e vogël në një vend pelegrinazhi për turistët dhe vendasit, ndërkohë që Shqipëria vajton ikjen e tyre nga prehri atëror.

***M.Hoxha***

Vetë fakti që njeriu jeton me gjësendet dhe natyrisht se ato formojnë kornizën e tij sociale, do të thotë se njeriu gjithmonë kërkon të "transcendentojë" këtë gjendje dhe të lidhet me diçka më të qartë se vetja, por që del nga vetja.

# Miti i Mërkunës së zezë "dita e Martë"

*Nga:*
**Dr. ROVENA VATA**

Përderisa imagjinata e ka krijuar botën,është ajo që e udhëheq atë.

Me këtë shprehje nis romani "Mërkuna e zezë" i shkrimtarit Agron Tufa.

Arti në përgjithsësi dhe letërsia në veçanti janë botë e imagjinimit dhe botë imagjinare. Kur letërsia buron në imagjinatë atëherë ajo ngrihet mbi imagjinimin e autorit/subjektit krijues i cili pastaj me anë të shkrimit e objektivon atë imagjinim dhe krijon botë imagjinare apo "botë-besim".

Kendall Waltson do të thoshte se imagjinimi mund të jetë spontan dhe intencional. Teza kryesore e Waltson-it është teza se fiksioni është art i imagjinuar që na bën të besojmë në të. Mirëpo ajo që duhet ritheksuar është fakti që letërsia e mirë jo vetëm që na shtyn të besojmë botën e saj të imagjinuar mirë, por edhe na tregon se është botë e imagjinuar. Pra, letërsia është një ftesë e autorit që na fton në botën e tij të imagjinuar: "Ju ftoi të imagjinoni botën time!".

Mirëpo, letërsia është burim i autorit që imagjinon në mënyrë të thukët, evokative, të rrjedhshme dhe kontemplative duke krijuar botë imagjinare mbi karaktere dhe ngjarje që rrezatojnë botën reale. Ajo nuk bazohet në imagjinatë që lejon lexuesin të konsumojë atë vetëm sipërfaqësisht. Letërsia e imagjinuar e mban lexuesin *në maje të gishtave për të parë botën nalt matanë*.

Letërsia e mirë është "botë-besim" matanë që e ndihmon lexuesin të gjejë udhën e vet në botën në këtë anë duke bërë pyetje, duke menduar, duke u fisnikëruar e duke gjetur domethënie. Letërsia si qenie e botës imagjinare ajo ka status të saj specifik që matet me qenësi estetike: pra, duke e parë se sa e thukët dhe sa e imagjinueshme, sa imagjinare dhe sa imagjinim-nxitëse është ajo.

Roland Barthesi, merr rolin e demistifikuesit të miteve të kulturës masive dhe tenton të na bëjë me dije se mitet nuk janë vetëm deluzione, truke apo struktura të fshehta që na e sajojnë botën para nesh, por ato rëndojnë rëndë edhe filmat, fotografitë, plastikën, sapunin, televizionin, veturat etj.

Duke marrë shkas nga thënia e Bardhësit në një ese të titulluar: "Sociologjia apo socio-logjika", ku thotë se çdo shoqëri tenton të strukturojë realitetin dhe për këtë arsyje nevojitet të kemi analiza struktuale. E njëjta shprehje vlen edhe për romanin në fjalë.

*"Gjatë gjithë asaj dite, si dhe ditët që vijuan, i ndihmova gjyshes të ushqenim bagëtitë. Më bëri përshtypje numri i madh i deleve të zeza. Gjyshi këtë e quante shenjë të keqe. Ai thoshte se ndër 100 dele të bardha, qëllon një e zezë. Kurse në tufën e gjyshit prej nëntëdhjetë e nëntë delesh, vetëm njëra ishte e bardhë. Për ta zbutur pak këtë raport, gjyshja kishte porositur pesëmbëdhjetë dele të bardha në lagjen e poshtme që thoshte se do t'ia binin ato ditë. Gjyshja thoshte se delet e bardha nuk rronin, sëmureshin ose ngordhnin. Në pranverë thuajse nuk mbijetonte asnjëra. E keqja qe se kurrë nuk u mor vesh ndonjë sëmundje. Gjyshja thotë se kjo ndodh prej mësyshit, ndonëse ka kohë që s'e beson as vetë këtë gjasë".*

Syri i keq haset edhe marrje mësysh. Ashtu si në Lindjen e Mesme, në Shqipëri mendohet se një vështrim keqdashës vetvetiu mund të bëjë dëm. Prandaj, njerëzve që besohet se kanë një vështrim të tillë, pra sy të keq, nuk u dilet përpara. Fëmijët e vegjël, bagëtitë e tufës ose gjërat me vlerë nuk bën të lëvdrohen para të tjerëve, në mënyrë që të mos i zerë syri i keq. Rreth qafës së bagëtisë shpesh varej një lugë druri, kurse në ballë të foshnjës në djep vihej një monedhë, ose në hundë i ngjyhej një pikë bojë ndryshku, që të shërbenin si hajmali kundër syrit të keq.

"- Zanati, moj loçka e gjyshes, nuk epet: ai rrëmbehet, vidhet. Zanati i dhanun nuk asht i hajrit, nuk asht i amël. Ai asht vetë msheftësia. Asht vetë rravgimi i femnës, jeratisun prej Mërkunes.

- Kush asht kjo Mërkuna, gjyshe?- pyeta i çuditur.

Gjyshja më pa me mosbesim. – falë i qofshim kah na rri mbi krye me furkë e gërshanë në dorë! Falë i qofshim kah na thur e shthur fatet tona, Zanës tonë shejte! Ajo asht Zana e grave qi mbarson e zanon, bir i gjyshes!

-Unë dua ta shoh, gjyshe. – Larg qoftë, loçk' e gjyshes! Ajo i shtangon burrart.... S'ka punë me ta!

- Po ti, gjyshe, a e ke parë Mërkunën?

- Jo bir, ajo të del me t'rraposë kur i hyn në hak. Por unë e kam ndie afër Frymën e mbarë të asaj Fatbardhe..."

Sipas besimit popullor, nga të gjitha ditët e javës, e Marta quhet në Shqipëri, ashtu si në Turqi, "dita më terse". Është terse sidomos për t'u nisur për udhë. Shumë gra shqiptare nuk bëjnë punë shtëpie të martave, sepse e marta e ka "një sahat ters". Plakat nuk e lanin kokën të martave, as nuk e derdhnin ujët e enëve pasi i lanin. Ky besim është i përhapur në Shqipëri edhe sot. Punëtorët e ndërtimit shpesh nuk hedhin themele të reja shtëpish të martave, kurse shumë njerëz në këtë ditë nuk i bëjnë sefte rrobat e reja. Kleriku Italian Ernesto Cozzi (1870-1926) nga Trentoja ka shënuar shprehjen gegërishte: "Zoja e marte asht e idhun."

E mërkuara sipas besimit popullor kanë qenë quajtur ditë të pavolitshme për të qethur dhentë.

Djalli shfaqet në shumë trajta në mitologjinë tonë dhe për të ka një numër të madh termash: djall, nga lat. diabolus, 'djall; dreq, nga lat, draco, 'dragua'; satan; termi mysliman shejtan, nga hebraishtja satanas; dhe lucifer. Për arsye tabuje, zakonisht përdoren edhe eufemizmat: qoftëlargu, larg këtej, e barasvlershme me gr. e sot., i mallkuar, i paudhë. Djajtë shpesh marrin trajtën e cjapit.

" - A të kanë ngucë mysafirët e natës?", - e pyeta.

"Mbramë ka qenë hata e madhe", - tha. "Vlonte vendi nën hanë. Kishin msy edhe shpirtna të xhuxhtë, femna shtatshkurtna, shëmtaqe, cubele. Disa sosh, mbulue prej flokësh kryekreje".

Kur m'i shploi kambët i qenë mbushë pika-pika kafe, si vezë fëllanxe. Tha se kishte dremitë nji copë herë, por kur qe sque, tue plasë drita, kishte pa ato fshesa të vogla, të ngjyme në asi lëngu qoftëlargu.

Ta kesh burrin sa më larg
Ndilli burrat var-e-varg
Zgjidhe njenin topemadh
Me t'a kullot njat livadh
Me t'kullot at'bar prendvere
Qite burrin tand përdere,
Mos le mashkull nën çati,
Kshtu t'urdhnon motra Kumri.
Se për vjerrin jena vet,
Nadje lig e kem zatet".

Në këtë sekuencë jepet shfaqja e Mërkunes në trajtën e një njeriu që ka vdekur që 7 vite, duke i paralajmëruar gratë që kishin punuar në ditën e saj që kjo gjë herë tjerër të mos përseritet se marrja e shpirtit të tyre prej saj do të jetë në mënyrë fatale.

- "Unë nuk jam hallë Gurija. Ajo ka shtatë vjet kallur në dhe. Unë jam Mërkuna, Nata e Mërkurë! Sa herë ju kam thanë të mos punohet në natën timë?! Të mos qe hatri i kësaj sabie (ajo dëftoi me gisht djepin ku flinte ferishtja), të mos që mikpritja jote zemërbardhë (ajo dëfteu me gisht grumbullin e arrave, mollave, ftonjve e dardhave dhe filxhanin e filluar të kafesë), do të ta merrja shpirtin me vete për gazep, atje përfund, në dynja të poshtme!", -tha, duke m'i shti duert e gjata me thonjt e verdhë rrastas për fyt. Si i tha këto, e pashë vetë qysh u shndërrua në firomë, qysh rrëshqiti prej meje dhe u fut në katrorin e vogël të shporetit, qysh u ngjit me brambullimë e poterë për burive të sobës, tue u tretë e u ba fir".

Mërkuna e zezë është perëndia e grave e gjithëpushtetshmja që i mbronte gratë, por edhe i ndëshkonte me vdekje, kur ato nuk i bindnin urdhrave të saj që të mos punohet punëdore ditën e martë, pra e marta e zezë, kjo gjetje është e autorit dita e Mërkure dhe jo e Marte edhe pse e thote diku brenda romanit ditën e Marte që nuk duhet punuar punëdore.

"- Shshshsh! C'hall të ka zënë moj Fatkë? Pa tregoji vëllait...- thashë, duke

gjakuar ta marr me të mirë. – Si nuk e kupton? Ato janë shtriga! Ato thirrën ardhjen e Natës së Mërkurë! Shihe, këtë shi do ta ndajë dëbora. Për këtë i hodhën veglat e punëdores në pus. Ata iu lutën Natës së Mërkurë. E Mëkura e Zezë është shpirti i përjetshëm i femrave që ngrihet kundër kësaj feste".

"Unë nuk dëshiroj ta shoh. Por e ndiej. Po të dua dhe mund ta shoh, por mos mendo se mund ta shohësh thjesht si një shoqe. Ajo shfaqet në trajta shumë të parrokshme, në gjendje gjysmëkllapie, njohurish, ashtu sikur iu shfaq gjyshës atë natë.. në trajtën e hallës Gurije".

Barthes-i kërkonte që kultura të ketë 'pak dije, pak urti, aspak fuqi...por sa më shumë shije' (duhet dalluar fjalën shije këtu sepse Bardhes e përdor këtë duke konotuar impresionin sensual që jep teksti e jo shijen estetike të bazuar në kanon, apo tradtë estetike).

Në këto vargje jepet funksioni i Mërkunës së zezë që rrënonte burrat dhe mbronte gratë, por vetëm atëherë kur këto të fundit kishin vepruar siç ka urdhëruar zonja Mërkunë:

"Mërkunë e Madhe kësoane, shkreti,
shkreti burrat tanë!
Jepna fronin e shtëpisë, parësinë
mbi rrung-e-trung,
Hapna udhën t'u vëmë këmbën
meshkujve që na gërganë
Edhe femrave sojsëze, lidhjua
fatin nyje, cung!

.....

O Mërkuna jonë e Madhe, Mërkunë
e Zezë e këtij viti!
Shpirtin tonë që t'u robtua, si qëmoti
bëje rojë!
Rritna thonjtë t'ua çjerrim zemrat
burrave që të koriti
Delezezën, shpirtin tënd, përdhunuar
shkrumb-e-plojë.

Vetë fakti që njeriu jeton me gjësendet dhe natyrisht se ato formojnë kornizën e tij sociale, do të thotë se njeriu gjithmonë kërkon të "transcendentojë" këtë gjendje dhe të lidhet me diçka më të qartë se vetja, por që del nga vetja.

BASHKËPUNO EDHE TI
< rrugaearberit@gmail.com >

Presidenti i Republikës, Prof. Dr. Bamir Topi, ka nderuar këngëtaren dibrane, Lirie Jushi (Rasha) me Urdhrin "Mjeshtër i Madh", "Për kontribut shumëvjeçar në pasurimin e jetës artistike shqiptare, për interpretimin e rrallë mjeshtëror të këngës popullore, veçanërisht asaj të trevës së Dibrës".

# "Mjeshtër i Madh" për Liri Rashën

***"Ndërsa Liri Rasha këndonte, e sidomos në fund të këngës, qe e pamundur të vendosej qetësia në sallë: spektatorët ngulnin këmbë në përsëritjen e saj jo vetëm njëherë. Dikujt i shkonin lotët nëpër faqe dhe, ashtu i dehur nga melodia dhe fjalët prekëse thërriste me të madhe që këngëtarja të vazhdojë. Atëherë drejtuesi artistik ndërhyn dhe tërheq Lirinë pas perdes e i thotë të mos dalë më përpara publikut se "po pengohet programi". Kjo ishte e drejtë, po në sallë është spektatori ai që bën ligjin. Atëherë shkova prapa perdes dhe e gjeta Lirinë duke qarë. Ajo dëshironte të dilte përsëri se, siç më tha, "kjo është kënaqësia e artistit, ky është shpërblimi më i madh që mund të më jepet". Kështu shkruan Ymer Minxhozi për sukseset e këngëtares Lirie Rasha në Hamburg, gjatë turneut të Ansamblit të Shtetit në Gjermaninë Perëndimore në vitin 1983.***

***Edhe sot, ngado ku janë shqiptarët, sapo dëgjojnë këngët e Liri Rashës emocionohen dhe mallëngjehen, duke pasur po ato emocione që sjell kënga e saj, si ditën e parë që e kanë dëgjuar.***

***Presidenti i Republikës, Prof. Dr. Bamir Topi, duke shfrytëzuar 100-vjetorin e Kryengritjes së Malësisë së Madhe dhe ngritjes së flamurit kombëtar nga Heroi i Popullit, Dedë Gjo Luli në Deçiq, në një koncert festiv në mbajtur në teatrin Migjeni në Shkodër, me titullin ""Ku e muer emrin Malësia", gjeti rastin dhe nderoi edhe këngëtaren dibrane, Liri Jushi (Rasha) me Urdhrin "Mjeshtër i Madh", "Për kontribut shumëvjeçar në pasurimin e jetës artistike shqiptare, për interpretimin e rrallë mjeshtëror të këngës popullore, veçanërisht asaj të trevës së Dibrës".***

***Liri Rasha, në aktivitetin saj artistik, ka ruajtur me fanatizëm traditën popullore shqiptare. Në udhën e saj artistike, asnjëherë nuk e ka deformuar këngën e bukur popullore. "Kam kënduar gjithmonë me një pasion të jashtëzakonshëm për këngën popullore. Kam qenë shumë e përkushtuar pas këngëve të trevës sime".***

***Liri Rasha ka përcjellë emocionet e këngës popullore shqiptare anembanë vendit dhe jashtë kufijve. Në vitet e mbylljes totalitare, kënga e saj ka ngritur peshë zemrat e shumë bashkatdhetarëve nëpër botë, të ndarë nga vendlindja dhunshëm prej izolimit. Kudo ku shkonin grupet shqiptare, nuk kishin kuptim pa pjesëmarrjen e Liri Rashës. Kështu, ajo qe bërë herë pas here pjesë e grupeve të ndryshme artistike, si ansamblin "Migjeni" të Tiranës, ansamblin "Gjallica" të Kukësit, ansamblin "Mirdita", ansamblin e Shtetit, etj, duke kënduar jashtë kufijve si në ish-Jugosllavi, Kosovë, Turqi, Gjermani, Zvicër, Austri, Itali, Greqi. Kënga e Lirie Rashës ka qenë "ambasadorja e parë" në SHBA, para se të rivendoseshin marrëdhëniet diplomatike.***

***Këngët e Liri Rashës si "Xhamadani i Kuq si gjaku", "Kur e përcolla Y lberin", "Moj Fusha e Korabit", "Kënga e Rexhës", "Shtatë Liqejt e Lurës", "Amaneti" e dhjetëra këngë të tjera, janë edhe sot e kësaj dite po aq të pëlqyera e emocionuese, duke i dhënë folklorit shqiptar një kontribut të çmuar.***

***Suksesi i Liri Rashës nuk ka ardhur vetëm prej zërit të saj, por edhe nga puna dhe përkushtimi i atyre që kanë punuar me të; kompozitorë e instrumentistë, poetë e shkrimtarë. Kompozitorët Përparim Tomçini, Edmond Zhulali, Xhelil Imeri, Laim Kola, Imer Seferi, Adriatik Lammallari etj., dhe hartuesit e teksteve Naim Plaku, Gjok Beci e Hilmi Kolgjegja, i kanë bërë këngët e Liri Rashës t'i rezistojnë kohës.***

***Kënga e parë në skenë e Liri Rashës, në moshën 13 vjeçare titullohej "Mora rrugën, mora"... Ajo pa dashur ka kënduar një këngë që do të kthehej në himn dhe frymëzim gjatë gjithë karrierës artistike, jo vetëm pse ndoqi një rrugë të traditës familjare, por sepse edhe po e përcjell trashëgim te vajza... Brezat do të kalojnë, por rruga e këngës së Liri Rashës do të jetë e pafundme.***

***BUJAR KAROSHI***

Në foto: Një foto pas ceremonisë së marrjes së çmimeve.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PRESIDENTI I REPUBLIKËS

I jep

Zonjës LIRI JUSHI (RASHA)

Urdhrin "Mjeshtër i Madh"

*"Për kontribut shumëvjeçar në pasurimin e jetës artistike shqiptare, për interpretimin e rrallë mjeshtëror të këngës popullore, veçanërisht asaj të trevës së Dibrës."*

Tiranë, më 23.03.2011
Nr. Dekretit 6942

PRESIDENTI
BAMIR TOPI

Kënga e parë në skenë e Liri Rashës, në moshën 13 vjeçare titullohej "Mora rrugën, mora"... Ajo pa dashur ka kënduar një këngë që do të kthehej në himn dhe frymëzim gjatë gjithë karrierës artistike, jo vetëm pse ndoqi një rrugë të traditës familjare, por sepse edhe po e përcjell trashëgim te vajza... Brezat do të kalojnë, por rruga e këngës së Liri Rashës do të jetë e pafundme.

Liri Rasha u shfaq si një talent i rrallë në interpretimin e këngës popullore dhe posaçërisht si një dukuri e rrallë në interpretimin e këngës dibrane. Ajo hyri fare natyrshëm në skenën madhështore të artit popullor, me një shkëlqim vezullues dhe do të mbetet si një relikt e përjetshme në piedestalin historik të saj.

## Naim Plaku: "Talenti ka gjetur shtëpinë për të ndritur përjetësisht në hapësirat e artit popullor"

Liri Rasha u shfaq si një talent i rrallë në interpretimin e këngës popullore dhe posaçërisht si një dukuri e rrallë në interpretimin e këngës dibrane. Ajo hyri fare natyrshëm në skenën madhështore të artit popullor, me një shkëlqim vezullues dhe do të mbetet si një relikt e përjetshme në piedestalin historik të saj.

Liria shfaqi origjinalitetin e saj në dy linjat më kryesore të këngës popullore, në atë lirike dhe epike. Të dyja ishin aq të dashura për të, ndaj dhe i interpretoi me virtuozitet e përsosmëri. Por ky talent shkëlqeu në sajë të kulturës muzikore që ka Liria, të këmbënguljes së saj për të arritur më të mirën, intuitës së saj për të zgjedhur më të bukurën, njohjen në detaje të prurjeve më të mira në shekuj të vargut e melodisë. Ajo vjen nga një trevë ku kënga popullore kishte djepin e saj që mbante erën e luleve të bjeshkës, hijeshinë e maleve dhe lëndinave, flakët e qëndresave historike të një populli pamposhtur e krenar. Kështu u bashkuan aq bukur te kënga e saj lulja dhe flaka, çiftelia dhe pushka, dashuria dhe trimëria.

Në skenën dibrane, prej nga ku i ka fillesat talenti i saj, ajo erdhi fare e re, me një forcë premtuese për të kapur majën. Liria ka patur në vijimësi një këmbëngulje prej artisti të vërtetë për të arritur më të mirin. Mua më kujtohet fare mirë gjatë bashkëpunimit të saj me krijues të tjerë, kompozitorë e poetë për të njohur më të bukurën, vargun më të mirë, fabulën më të gjetur, melodinë më të përshtatshme. Ajo dhe na sugjeronte dhe na bënte vërejtje apo na korrigjonte për temat, figurat, vijën muzikore etj., me po atë këmbëngulje që punonte për vete. Motivet popullore i njihte aq mirë sa çdo ndikim apo mosgjetje e dallonte menjëherë. Prandaj dhe repertori i saj ka pasur e ka gjithmonë këngë të mira, që populli i kupton, i ndjen dhe i mëson lehtë.

Në formimin e talentit të saj, përveç traditës dhe zërit të mrekullueshëm që i kishte falur natyra, pati edhe fatin të bashkëpunojë me kompozitorë e letrarë të njohur si Tonin Rajta, Zef Çoba, Përparim Tomçini etj. Por ky ndikim ishte i ndërsjellë. Këta punonin me këngën e Liries e për Lirien dhe Liria me zërin dhe virtuozitetin e saj i frymëzonte në krijimtarinë e tyre.

Një anë tjetër e figurës së kësaj artisteje ishte dhe kërkesa që kishte ndaj vetes. Ajo punonte shumë që të arrinte deri në përsosmëri në interpretimet e saj. Korrigjonte vetveten vazhdimisht për të arritur atë që dëshironte. Ndoshta edhe tani, sepse Liria vazhdon të debutojë me sukses në skenën shqiptare, ajo ka mbetur aq kritike ndaj artit të interpretimit, sa ç'ishte në rininë e saj.

Tek personaliteti i Liri Rashës mund të them pa frikë se talenti i mrekullueshëm ka gjetur shtëpinë e tij për të ndritur me shkëlqim në hapësirat e artit popullor përjetësisht.

cyan magenta yellow black

portret

# Këndoj gjithmonë me pasion për këngën popullore

## Përparim Tomçini: "Fenomeni vokal Liri Rasha"

Që në fillim, dua të them se Lirie Rasha ishte edhe është vlerë kombëtare. Së pari, Liria ka një vokal karakteristik që rrallë këngëtarë mund ta ketë një fat të tillë, ku janë kombinuar karakteristikat të vokalit folklorik me një vokal të importuar profesional, fenomen të cilin rrallë e konstatojmë tek këngëtarët dhe që mund ta quajmë vokal klasiko-folklorik ose fenomeni vokal Liri Rasha. E veçanta tjetër e Liries, është gama e gjerë e repertorit të saj, e cila fillon me këngët e dasmës, këngët e ndryshme lirike, këngët epike, baladat etj., të cilat ajo i ka kënduar bukur dhe ka lënë gjurmë dhe duke krijuar unin e saj në secilin interpretim të gjinive të ndryshme të këngës. Ajo ç'ka është më kryesorja dhe ku Liria për shumë e shumë breza do të jetë e pazëvendësueshme, është shpirti i saj krijues dhe interpretues, sidomos te këngët e kurbetit apo te baladat.

Të gjithë i kemi parasysh interpretimet e papërsëritshme të Liri Rashës të këngët: "Fusha e Korabit", "Kur e Përcolla Ylberin", "Kënga e Rexhës" etj., të cilat i kanë kënduar edhe këngëtarë apo këngëtare të tjerë, por nuk i kanë interpretuar. Shpirtin dhe jetën që ju ka dhënë Liri Rasha këtyre këngëve është shumë e vështirë, për të mos thënë e pamundur, se mund t'ua japë ndonjë këngëtar tjetër. Liri Rasha është dhe do të jetë këngëtarja e rrallë që di të eksplorojë natyrshëm shpirtrat njerëzorë me dinjitetin e saj artistik.

**-Ju u nderuat me titullin "Mjeshtre e Madhe", vlerësim i cili erdhi si një kurorëzim i karrierës suaj si këngëtare. Si ndiheni dhe çfarë momentesh ju dhuroi ky titull?**

Unë kam mbi 40 vjet që këndoj dhe asnjëherë nuk kam menduar që do të shpërblehesha me një titull të tillë. Më parë unë jam nderuar me titullin "Artiste e Merituar" dhe së fundi mora dhe këtë titull, i cili për mua ka një vlerë shumë të veçantë. Marrja e këtij titulli ishte një gëzim i madh për mua si këngëtare, e para sepse ky titull mu dha në një moshë kur ende këndoj në skenë dhe e dyta ka të bëjë me faktin se këtë titull unë e kam marrë në qytetin e Shkodrës, ku u propozova nga shoqata shkodrane "Kënga jonë", dhe ishte një nderim i madh që më erdhi mua nga kjo shoqatë dhe nga publiku, i cili më ka mirëpritur vazhdimisht me këngën time.

**-Gjatë karrierës suaj si këngëtare ju jeni shoqëruar me shumë vlerësime dhe tituj, të cilët kanë nisur që në vitet '80?**

Që në një moshë të re unë kam marrë urdhra "Naim Frashëri", që ishin të kategorive të ndryshme, ndërsa në vitin 1988 unë jam nderuar me titullin "Artiste e Merituar", i cili ishte gjithashtu një moment shumë i veçantë dhe emocionues në karrierën time si këngëtare e këngës popullore, për të ardhur më pas tek titulli i fundit "Mjeshtre e Madhe".

**-Këto çmime erdhën pas një jete artistike shumë aktive me këngën popullore, por nëse kthehemi pas në vite si i kujtoni fillimet tuaja me këngën popullore shqiptare?**

Talenti im në këngë vjen dhe falë familjes sime, sepse unë kam një familje të madhe e cila e ka dashur dhe e ka ruajtur folklorin shqiptar dhe ka qenë me shumë tradita kulturore. Në ato vite kishte dhe shumë vështirësi, pasi pothuajse elektronika nuk ekzistonte, vetëm ndonjë radio dhe kaq. Nuk dëgjonim shumë këngë dhe nuk ishte informacioni i mjaftueshëm mbi muzikën. Unë kisha lindur në fshatin Zardarllë dhe në Peshkopi mu hapën më shumë rrugët e artit, duke qenë se unë nuk kisha një praktikë në të kënduar fillimisht më jepeshin këngë që nuk ishin shumë të vështira në të kënduar, gjë që i shkonte dhe moshës sime në ato vite. Unë kam kënduar gjithmonë duke mos menduar shumë për tituj, pasi unë e kisha me një pasion të jashtëzakonshëm këngën popullore. Isha shumë e përkushtuar tërësisht pas këngëve të trevës sime fillimisht, për të vijuar dhe me këngën e trevave të tjera të vendit.

**-Thatë që e nisët karrierën me këngën e trevës suaj, ndërsa më vonë ju filluat një karrierë si këngëtare profesioniste në Estradën e Peshkopisë. Si ishin ato vite pranë kësaj trupe artistësh?**

Aktiviteti gjatë atyre viteve ka qenë shumë i ngjeshur, kishim shumë koncerte. Në ato vite kishte një program të pasur artistikisht dhe në Peshkopi punohej shumë për të sjellë një repertor të pasur dhe të bukur tek publiku. Peshkopia kishte 170 fshatra, ndërsa kishte dhe një plan artistik dhe për qytetin. Ne mirëpriteshim pothuajse në të gjithë rrethin e Dibrës, por dhe qytete të tjera. Çdo vit ne kishim turne në të gjithë vendin.

**-Nëse flasim për vitet kur ju shëtitnit në çdo cep të Shqipërisë duke dhënë koncerte, cilat ishin këngët që pëlqeheshin më shumë nga publiku?**

Kanë qenë shumë këngë të cilat edhe sot e kësaj dite këndohen dhe pëlqehen nga populli. Unë u bëra e njohur që në vitet '70 me krijimtarinë muzikore popullore dhe këngët e mia kanë mbetur deri në ditët e sotme dhe janë pëlqyer si në veri ashtu dhe në jug, por unë nuk e ndjeja dallim mes tyre. Ndër këngët e mia që nuk janë harruar dhe sot e kësaj dite janë këngët dibrane, kanë qenë këngët e kurbetit, kënga "Moj fusha e Korabit", "Kënga e Rexhës", "Çu çu rrushja" etj.

**-Po jashtë trevave shqiptare, cilat ishin këngët që pëlqeheshin më shumë?**

Për shumë vite unë kam kënduar dhe në diasporë, ndërsa jam angazhuar shumë në karrierën time si këngëtare dhe me Ansamblin Shtetëror. Më kujtohet që në vitin 1977 ishim me një turne në ish Jugosllavi dhe në Greqi, për të vijuar më pas dhe në shumë shtete të tjera, përmend këtu Gjermania, Franca, Italia, Amerika etj. Edhe jashtë trevave kënga popullore shqiptare nuk bënte dallim, të gjitha ishin të mirëpritura.

**-Gjatë këtyre dekadave me këngën a keni pengje në jetën tuaj artistike?**

Kur isha e re mungesa e shkollës më mundonte, megjithatë unë konkurrova. Më kujtohet këngëtarja e madhe Marie Kraja, e cila kur unë mbarova konkurrimin më tha që ti mund të bëhesh soprano koliaturë shumë e mirë, por nëse do më dëgjosh mua mos e ndrysho vokalin sepse ti ke një vokal shumë të mirë për muzikën popullore. Unë i besova, sepse kisha shumë vlerësim për atë këngëtare.

**-Njiheni për këngën e veriut, por këngët e trevave të tjera si janë për ju?**

Nuk më ka penguar asnjëherë të këndoj këngët e trevave të tjera, sidomos edhe këngët e kurbetit që i këndoj shumë. Këto kanë dhe ngjashmëri me këngët e jugut dhe të them të drejtën unë këndoj këngën e veriut, por shpirti më fle tek këngët e jugut.

**-Ju këndoni këngën popullore atë që është e tabanit kombëtar, por çfarë mendoni sot kur shikoni që këto këngë në shumë raste vijnë të përpunuara në mënyrë të atillë, që iu humbet edhe origjinaliteti i tyre?**

Është fatkeqësi që po degradon folklori shqiptar dhe sot disa këngëtarë të rinj nuk dinë të dallojnë këngën e trevës, këngën e kombit të tyre me këngën që ata e sjellin si shqiptare. Kënga duhet ruajtur, mendoj se duhet të kishte më shumë kontroll ndaj muzikës. Më vjen keq kur shikoj se sot më shumë këndohet kënga e huaj se sa ajo që është e traditës shqiptare dhe kjo është fatkeqësi, pasi po e drejtojmë shijen e publikut drejt një muzike e cila nuk ka asnjë të ardhme. E reja duhet por gjithmonë duke u mbështetur në tabanin kombëtar. Në stacione të ndryshme televizive ne dëgjojmë këngë të ndryshme që na i sjellin në shqip, brezi i ri edukohet me këtë në një kohë kur ne brezit të ri duhet ti japim këngën shqiptare. Ai duhet ta njohë muzikën e kombit. Një këngë në turqisht nuk mund të sillet në shqip është e papranueshme, po ashtu as ajo greke dhe bullgare.

**-Si po vijon jeta juaj artistike?**

Kam aktivitete të ndryshme dhe do kisha dëshirë të bëja një album, por siç e dini pirateria tani po bën kërdinë dhe është një humbje e madhe për një artist. E drejta e autorit pothuajse nuk zbatohet fare tek ne. Do të vijoj të sjell këngë të trevës së veriut.

## Gjokë Beci: Laureshë e këngës popullore mbarëshqiptare

Të shkruash një kujtim për Liri Rashën, laureshën e vërtetë të këngës dibrane dhe asaj popullore mbarëshqiptare, është e vështirë. Pasi kam qindra kujtime të bukura e emocionuese, të cilët i kemi ndarë bashkë në udhën e këngës. Por, po tregoj një rast për këngën mbi Fehmi Aganin.

Liri Rasha (Jushi) dhe bashkëshorti i saj e krahinasi im Pashku, më ftojnë për kafe. Nuk mendova se rasti i kësaj ftese do të na provokonte lot të përbashkët, por sapo erdhi në shprehje fundi tragjik i një emri të madh të shqiptarisë, Fehmi Aganit, as brilantet e lotëve nuk mund të na rrinin më prapa qerpikëve. Tashme edhe ata filxhanë që na u vunë përpara ishin kafe ngushëllimi. Folëm gjatë e me emocion. Dinim njësoj dhe ndjenim njësoj për figurën e madhe të profesorit, të politikanit, të atdhetarit dhe kjo, natyrisht, nuk i mjaftonte sprovës artistike që synohej prandaj iu nënshkruam procesit të krijimit të tekstit, diskutimit me njëri-tjetrin dhe sidomos me kompozitorin, të njohurin dhe thuajse kontributorin unikal, posaçërisht për tema të tilla të mëdha patriotike, z. Edmond Zhulali, për të ardhur në atë që një fis tjetër njerëzor do ta quante vendimmarrje.

Tragjedia nuk kishte shumë kohë që kishte ndodhur, dhimbja ishte e thellë dhe loti i nxehtë, por kjo nuk na pengoi të dilnim ndoshta të parët, për të dëshmuar se këtej dhe andej kufirit dhimbja ishte njësoj e rëndë për humbjen e Prof. Fehmi Aganit.

Kënga tashmë kishte mbaruar, por jo, ende meraku krijues. Shqetësonin pyetje të tilla: a mungonin ato që s'duhej të mungojnë në një tekst kënge si është informacioni i bollshëm jetësor i heroit, vendndodhjet e ngjarjeve, dialogjet reale e gjurmëlënëse që na përcjell tradita etj. Dhe, mos është abuzuar kjo në favor të një teprie jo bindëse me emfazë atdhetare. Na ngjau e kundërta dhe ashtu qoftë!

Në zërin e këngëtares Liri Rasha, që sipas meje, pikon yndyrën e shpirtit njerëzor, ashtu si shumë të tjera para saj, kënga doli ajo që prej vitesh po dëgjohet me po aq emocione si herën e parë.

### THËNË PËR LIRI RASHËN:

**Liri Rasha është këngëtare e dimensioneve të mëdha, është për Jugun dhe për Veriun. Liri Rashën e pëlqen e tërë Shqipëria.**
*Irini Qirjako "Mjeshtre e Madhe"*

**Emri i saj është gdhendur në vlerat më të mira të artit dibran, duke u bërë një përfaqësuese e krenarisë dibrane në muzikën tonë kombëtare.**
*Edmond Zhulali, kompozitor*

**Zotërimi i një teknike vokale profesionale i jep asaj mundësinë, që me velizmat dhe ronamentikën që ajo përdor, ta qëndisë këngën dhe të jetë origjinale në interpretim.**
*Xhelil Imeraj, muzikant, kompozitor*

cyan magenta yellow black

# Festivali, 150 artistë sjellin këngën qytetare në Peshkopi

*Nga*: **Dr. FEJZULLA GJABRI**

E veçanta e këtij organizimi është ruajtja e kritereve të kësaj tipologjie të këngës popullore, pa shpërdoruar origjinalin

E veçanta e organizimit të këtij Festivali është ruajtja e kritereve të kësaj tipologjie, pa shpërdoruar origjinalin, pa deformime në melodi e tekst, duke mënjanuar veglat muzikore të zhanreve të tjera artistike dhe elektronike, duke mbajtur parasysh veshjet karakteristike të qyteteve të ndryshme etj. Pra, synohet ruajtja pastër e këngës, mbështetur në origjinalin e saj. Por kjo nuk do të thotë se kënga rri e ngrirë; gjithsesi ajo është e gjallë, ka zhvillimin e saj gjithnjë në shtratin e vet.

*Në skenën e Festivalit*

**PAK HISTORIK**

Festivali Folklorik Kombëtar Tipologjik i Këngës Popullore Qytetare është një ndër festivalet më jetëgjatë që Qendra Kombëtare e Veprimtarive Folklorike ka organizuar që nga themelimi i saj. Ky Festival numëron gjithsej 10 edicione dhe këtë vit do të organizohet edicioni i 11-të, i tij në qytetin e Peshkopisë. 6 edicionet e para të këtij Festivali janë mbajtur në qytetin e Elbasanit, ndërsa 2 të tjerat janë mbajtur në Shkodër, Kavajë, Ebasan, për t'u zhvilluar më 2011 në qytetin e Peshkopisë.

Dikush edhe mund të thotë pse në Peshkopi, kur tradita më e hershme është në qytete mijëravjeçare. Pyetja është e justifikueshme, por kjo nuk do të thotë se këngë qytetare është pronë e një qyteti, apo vetëm një qendër di të organizojë festivale të tilla kombëtare. Nga ana tjetër ka një arsye edhe më të fortë: Që në vitin 2007 është vendosur se vend organizator do jetë qyteti i atij grupi që merr vendin e parë. Në mars 2010 Festivali pati fitues grupin e qytetit të Peshkopisë. Kështu, sipas traditës, Festivali i vitit 2011 kaloi në Peshkopi. Dibra dhe Peshkopia, si pjesë e saj, ka traditë të hershme në zhanrin e Këngës Popullore Qytetare. Ajo është evidentuar në fund të shekullit 19-të e në fillim të shekullit 20-të me këngëtarin Halil Bej Sturçe në Dibër të Madhe, Musa Piperku, Haxhi Maqellara, Violeta Turkeshi etj, si dhe Muharrem Xhediku, Munir Shehu, Përparim Tomçini etj, nga Peshkopia. Interpretues të kësaj kënge janë shumë, ndër të cilët përmenden Melita Shehun, Flora Shabani, Agim Skarra, Liri Rasha, Abdyl Sturçe, Fatime Bojaxhi etj.

* * *

Në datat 26-27-28 Maj 2011 në qytetin e Peshkopisë u organizua edicioni i XI i FFTK të Këngës Popullore Qytetare. Shpallja e këtij aktiviteti u bë në fillim të muajt janar, ku QKVF parashikoi që do të merrnin pjesë 18 grupe nga Shqipëria dhe nga vendet shqipfolëse si Kosova, Maqedonia e Mali i Zi, duke u dërguar kriteret shkencore dhe organizative Bashkive: Shkodër, Tiranë, Peshkopi, Burrel, Krujë, Tiranë, Elbasan, Durrës, Kavajë, Korçë, Pogradec, Fier, Berat, Vlorë, Lushnje si dhe grupet nga Prizreni, Gjilani dhe Tetova.

QKVF organizoi gjithë punën parapërgatitore bazuar dhe vendimit Nr. 1 të Komitetit Organizator, duke ndjekur nga afër pregatitjet e grupeve nëpërmjet komisioneve përzgjedhëse duke garantuar kështu prurje origjinale dhe me nivel të lartë artistik nga të gjitha grupet pjesëmarrëse. U pregatit marketingu i Festivalit (Postera, Çertifikata, Diploma).

Organizimi i Festivalit këtë vitë solli problematika të ndryshme në marrëdhënie me Qendrat Kulturore si dhe me pjesëmarrjen e disa prej grupeve në këtë edicion. Për shkak të situatës zgjedhore dhe mos financimit nga ana e Bashkive nuk morën pjesë në Festival grupet e qyteteve të Fierit, Lushnjes, Durrësit dhe Korçës. Grupi i Pogradecit ashtu siç edhe Ju kemi bërë me dije edhe në Festivalet paraardhëse nuk merr pjesë në këtë evenimet për arsye të një konflikti me MTKRS siç deklarohen ata. E njëjta situatë është edhe me grupin e Tiranës, i cili ka që prej vitit 2008 që nuk merr pjesë në këtë Festival me gjithë insistimet tona të përvitshme që ky qytet të përfaqësohet. Nuk mori pjesë gjithashtu edhe grupi i qytetit të Vlorës sipas tyre arsyet ishin financiare.

* * *

Natën e parë të Festivalit u ngjitën në skenë grupi i Peshkopisë, Burrelit, Tetovës dhe Prizrenit, natën e dytë grupi i Kavajës, Krujës dhe Gjilani, ndërsa natën finale garuan grupi i Elbasanit, Beratit dhe Shkodrës.

Vlen të thuhet se të gjitha grupet treguan seriozitet duke sjellë repertor origjinal të qyteteve prej nga vinin dhe lojë me nivel të lartë artistik. Pjesa më e madhe e tyre kishin bërë ndërthurje profesionale midis elementëve të vjetër me ata të rinjë duke respektuar kështu një nga pikat e kritereve tona shkencore për përfshirjen e këtyre të fundit, duke garantuar kështu transmetimit e këtij zhanëri ndër breza.

Paraditen e ditës së tretë grupet, të cilat vazhdonin garën bënë vizita në Muzeun e qytetit si dhe në Llixhat e Peshkopisë, vend ku u shtrua dhe një kokteil nga pushteti vendor. Mbas kësaj u mbajt Tryeza e rrumbullaktë për të cilën ishin pregatitur dy tema.

*Drejtori i Festivalit, z.Esat Ruka duke i dorëzuar "Mirënjohje" Besim Cutres*

## MIRËNJOHJE BESIM ÇUTRËS

Besim Çutra ka lindur me 5 Maj 1929 në Maqellarë, Dibër. Filloi të merrët me këngën që në moshë të re dhe në festën e 28 Nëntorit 1951 njihet si këngëtar popullor, nën drejtimin e kompozitorit Tonin Rrota, në koncertin për Pavarsinë.

Është pjesëmarrës në Estradën e Peshkopisë që nga viti 1959. Në vitin 1997 del në pension. Ka marrë pjesë në këto aktivitete:

- Viti 1957, në Festivalin kombëtar të muzikës qytetare Tiranë; Në vitin 1960 merr pjesë në Festivalin Kombëtar të muzikës qytetare në Vlorë, ku vlerësohet me çmim të dytë; Në vitin 1968, merr pjesë në Festivalin Folklorik të Gjirokastrës, si dhe në veprimtari të tjera. Repertori i tij është mjaft i pasur.

Në viti 1966 dekorohet nga Kuvendi Popullor me motivacion "Për merita të shquara si këngëtar i madh i muzikës popullore qytetare dibrane" dhe më 1997 vlerësohet me çmim special. Në FFT të Këngës Qytetare, Peshkopi, 2011, Qendra Kombëtare e Veprimtarive Folklorike për kontributin e tij në ketë zhanër e vlerësoi me "Mirënjohje" me motivacionin *"Për interpretim me origjinalitet të Këngës Popullore Qytetare"*.

**TRYEZË PUNE**

Në ditën e tretë të Festivalit Tipologjik kombëtar të Këngës Popullore Qytetare, në një nga sallat e Pallatit të Kulturës Peshkopi, u organizua tryeza e punës me pjesëmarrjen e shumë këngëtarëve, instrumentistëve, studiuesve, punonjësve e drejtuesve të kulturës e dashamirës të artit.

Tryeza u drejtua nga z. Esat Ruka, kryetar i Komitetit Organizator të Festivalit, Veli Vraniçi - drejtor i Qendrës Kulturore Peshkopi, Muzikologu Zef Çoba-kryetar i jurisë dhe muzikologu nga Prishtina Sami Piraj.

**Magistër Eduard Nurkaj**- Përgjegjës i sektorit të muzikës në QKVF referoi temën : Prurjet e reja në këngën popullore qytetare, të ilustruar me projeksione e filmime nga këngëtarë e orkestrina të këngës qytetare ndër vite. Dhe më pas shefi i muzikës në Qendrën Kulturore Peshkopi- Përparim Tomçini, referoi temën: Kënga qytetare në Dibër.

Pjesëmarrësit në tryezë dhanë mendime e sygjerime për organizimin e festivalit dhe ruajtjen e transmetimin e këngës popullore qytetare tek brezat më të rinj.

Z. Bashkim Rama-drejtor i qëndrës kulturore në Krujë, theksoi se kërkohet më shumë punë e këmbëngulje nga punonjësit e kulturës që mbështetja nga pushteti vendor të jetë më e plotë. Z. Rama kerkon që këto tema që referohen në këto tryeza, të botohen e të dërgohen edhë në bazë.

**Bardhyl Hysa,** shef i muzikës në Qendrën Kulturore Shkodër, mendon se në të ardhmen ne duhet të specifikojmë se si duhet të ecim, çfarë duhet të sjellim në këtë festival e çfarë në festivalin e Gjirokastrës. Organizimi i punës për festivalet duhet të jetë i tillë, -tha ai, -që ne të mbështetemi me fonde në qytetet tona, pasi ka shumë probleme e ne nuk paraqitemi dot në to. Ne duhet të organizojmë shumë veprimtari për ta ruajtur të pastër trashëgiminë tonë nga deformimet e rrymat e huazuara.

**Muzikologu Zef Çoba** tha: -Kënga Popullore Qytetare duhet të shihet në gjithë kompleksitetin e vet. Sot tregu e ka futur këtë zhanër në dasma, gezime studio regjistrimi. Duhet të kujdesemi me punën tonë për ta ruajtur origjinalitetin e këngës popullore qytetare duke sjellë krijimtari të re të natyrshme.

**Dr. Fejzulla Gjabri:** -Edhe fjala në këngën popullore duhet të ruaj traditën. Gjuha, fjala, muzikaliteti i fjalës, duhet të japin prejardhjen e trevës nga vjen kënga. Edhe në këngë të ruhet leksiku i trevave.

**Dr. Isak Shehu:** -Këto janë festivale shumë të mira, që i shërbejnë brezave. Ju lumtë për punën në këto kushte. Duhet të punojmë e forcojmë unitetin kombëtar. Faleminderit që isha në këtë festival! Grupet e punës të QKVF, duhet të përzgjedhin paraprakisht grupet pjesëmarrëse dhe repertorin.

**Z. Sami Piraj,** drejtor në Ministrinë e Kulturës në Prishtinë: -Ju faleminderit që në këtë festival morën pjesë edhe grupe nga Kosova. Këto këngë popullore qytetare shqiptare këndohen e pëlqehen shumë edhe në Kosovë. Akoma më shumë duhet të punojmë për ruajtjen e këngës qytetare nga specialistë e muzikantë e duhet të organizojmë edhe ne festivale për këtë zhanër.

**Z. Esat Ruka,** falenderon për mendimet duke premtuar se këto do të bëhen objekt i punës së QKVF.

* * *

Bashkëpunimi me pushtetin lokal të Peshkopisë si dhe Qendrën Kulturore të këtij qyteti ishte shumë i

Çmim të parë: **Grupi i Beratit**
Çmim të dytë: **Grupi i Shkodës**
Çmim të tretë: **Grupi i Tetovës dhe Elbasanit.**
Çmim Karriere: **Grupi Vokal i Burrave-Kavajë, z. Shkëlqim Farrici-Burrel dhe znj. Enkelejda Arifi-Gjilan.**
Çmimi orkestrina më e mirë: **Orkestrina e grupit të Peshkopisë**
Çmim special: **Grupi i Prizrenit dhe grupi i Gjilanit.**

Poeti Islam Çenga, ka një poezi të lirë në kuptimin se ajo lind nga zemra e poetit në mënyrë të vetvetishme kur shpirti dhe zemra vërtet kanë diçka për të thënë dhe e thonë ashtu si dinë.

## MEHEDI GUNI

Lindur më 16 shkurt 1954. Ka filluar karrierën e tij në vitin 1975 si këngëtarë amator në ansamblet e klasës punëtore të Ndërmarjeve prodhuese të rrethit të Krujës. Shumë shpejt u aktiviziua në veprimtaritë artistike të Qendrës Kulturore Krujë. Këngëtarë me një zë karakteristik sidomos në interpretimin e këngës popullore krutane. Aktivitetin e tij e ka përcjell në shumë tribuna kombëtare dhe ndërkombëtare si Maqedoni, Kosovë, Mali I Zi, Itali, Iran etj.

Tridhjet e gjashtë vjet të jetës i kanë dhënë atij një vënd nderi jo vetëm në familjen e artistëve, por edhe në të gjithë komunitetin krutan. Me të drejtë në tribunat kombëtare prezantohet "këngëtari i mirënjohur popullor krutanë, Mehdi Guni".

## MUKADES ÇANGA

Mukades Çanga e cilësuar "Zonja e Kenges Popullore Qytetare Shkodrane" lindur në Shkodër më 1959, në një taban familjar me tradita muzikore, që ndikoi në formimine saj muzikor. Ka nisur punë në Teatrin 'Migjeni' që kur ishte vetëm 14 vjeçe, si pjesë e Estradës Profesioniste dhe që nga ajo ditë nuk është shkëputur nga skena. Ajo është trashëgimtarja e denjë brezit të këngëtarëve të mëdhenj shkodranë, është një nga zërat që po shpëton traditën e muzikës popullore shkodrane. Mban mbi supe" 3000 shfaqje në të gjitha skenat vendit dhe në skena jashtë vendit. Ka më shumë se 600 këngë dhe shumë çmime. Në vitin 2006 merr Çmimin e Karrierës nga QKVF, si dhe shumë çmime të tjera të mëdha. Këshilli Bashkiak i Shkodrës i ka dhënë titullin "Mirënjohja qytetit". Në FFK të Këngës Qytetare, Peshkopi, 2011 merr "Mirënjohje" me motivacionin: "Për interpretim me origjinalitet të Këngës Popullore Qytetare"

**Grupi i Beratit, fitues i Festivalit**

frytshëm. Këta të fundit bazuar edhe në Vendimet e Komitetit Organizator morën masa për pregatitjen e skenografisë, ndriçimit, fonisë, regjisë, prezantimit, aktivitet dytësore etj. QK e Peshkopisë për arsye të ndryshme nuk arriti të realizojë koncertin e mirëseardhjes, duke e zëvendësuar me një program të posaçshëm në momentet kur Juria u tërhoq për të vendosur vlersimet për grupet. Bashkia Peshkopi vlerësoi disa figura të këngës qytetare të Peshkopisë me titullin "Nderi i Kulturës Dibrane", në darkën e fundit, ku nderoi me "Mirënjohje" gjithashtu grupin e Beratit, Gjilanit, këngëtarin Shkodran Bujar Qamili, përfaqësuesin e Ministrisë së Kosovës z. Sami Piraj si dhe drejtorin e QKVF z. Esat Ruka.

Mbas përfundimit të Festivalit Juria dha këto çmime:

Çmim të parë: Grupi i Beratit.

Çmim të dytë: Grupi i Shkodës.

Çmim të tretë: Grupi i Tetovës dhe Elbasanit.

Gjithashtu u vlerësuan me çmime:

Çmim Karriere: Grupi Vokal i Burrave-Kavajë, z. Shkëlqim Farrici-Burrel dhe znj. Enkelejda Arifi-Gjilan.

Çmimi orkestrina më e mirë: Orkestrina e grupit të Peshkopisë

Çmim special: Grupi i Prizrenit dhe grupi i Gjilanit.

Në vazhdën e traditës së krijuar u dhanë 3 MIRËNJOHJE për interpretues të këngës qytetare, si; Besim Çutra i Peshkopisë, Mukadës Çanga e Shkodrës dhe Mehdi Guni i Krujës.

* * *

Për promovimin e këtij Festivali në media megjithë përpjekjet tona që TVSH ta xhironte dhe transmetonte të gjithë këtë aktivitet, nuk u përmbush plotësisht, u arrit që të realizohej vetëm një dokumentar i zgjeruar, i cili do të transmetohet sëshpejti. Gjatë tre netëve nuk munguan dhe mediat lokale si dhe korespodentët e televizioneve të ndryshme në Tiranë.

Gjatë tre netëve në skenën e festivalit u ngjitën rreth 150 artistë. Ky edicion i përmbushi më së miri të gjitha kërkesat organizative të QKVF me përjashtim të mungës së grupeve të sipërpërmendura, të cilat nuk janë në varësi të institucionit tonë. Niveli i lartë i përgjegjshmërisë si dhe prurjet orgjinale nga grupet pjesëmarrëse na inkurajojnë për të vazhduar punën tonë të mëtejshme me seriozitet dhe profesionalizëm.

# "Mimozat e Marsit", poezi nga Islam Çenga

*Nga:* **Xhafer Martini**

Libri me poezi "Mimozat e Marsit" të Islam Çengës e lexova me kënaqësi. Libri vetë më nxiti të shkruaj për vlerat e kësaj poezie, që vjen e thejshtë, pa bujë, plot ndjenjë dhe mendim. Shumë kohë më parë i kam pasë lexuar disa tufa me poezi të këtij poeti. Më pëlqenin në përgjithësi, por kishte edhe prej atyre që nuk më ngrohnin. Islami i pranonte vërejtjet, sepse ishte njeri që kishte kërkesa të larta ndaj vetes. Me atë nivel poezie ai mund të botonte jo një, por disa libra. Po Islami nuk i dërgoi për botim. Këtë gjë e bëri njëzet vjet më pas, kur unë mendoja se ai ishte ndarë përgjithmonë nga poezia. Por jo. Dhe për kënaqësinë time dhe të gjithë lexuesve, poezia e tij nuk është më ajo e dikurshmja; tashmë kemi një poet të formuar, me një profil të vetin, me individualitet të spikatur. Një vëllim me poezi do ta justifikonte botimin edhe në qoftë se në të ka vetëm katër – pesë poezi të bukura. Për fat të mirë në këtë libër ka mbi dhjetë poezi që të lënë mbresa. Dëshira për të cituar vargje dhe poezi të tëra është e madhe kur shkruan për librin "Mimozat e Marsit", se tek secila poezi gjen diçka të veçantë që ka të bëjë jo vetëm me këndin e shikimit, por edhe me mjetet dhe figurat artistike që janë në funksion të shprehjes së mendimit poetik. Me që është e shkurtër, po e citoj të plotë poezinë "Gjymtim historie", që ta ndajë me lexuesin kënaqësinë që buron nga leximi i saj:

"Më kanë plagosur, më kanë vrarë,
Dhe më kullojnë plagët
Ato të shpirtit, jo të kurmit…

Vargun ma kanë përgjysmuar,
Fjalës i heqin zanoret
Dhe më merret goja.

Një dorë ma kanë prerë
Më kanë prerë një këmbë
Një kokë ma kanë prerë…

Prapë blejë një palë doreza për duart
Dhe blej një palë këpucë
Dhe një qeleshe prej bore
Për ditën e neserme."

Besoj se edhe lexuesi është në një mendje me mua se kjo është një vjershë e bukur që i kushtohet atdheut, Shqipërisë, por nuk është nga ato të zakonshmet, "patriotiket", me fjalë të mëdha të zhurmshme, me rrahje gjoksi dhe me betime.

Ose le të citojmë vjershën "Plakat e Kalasë së Dodës", që është disi më përshkruese, por gjithsesi e ndjerë, me një vështrim njerëzor, çka dëshmon se poezia nuk është pozë, nuk është britmë, por ndjenjë:

"Plakat e Kalasë së Dodës flenë vonë
E ngrihen heret për të fshirë qiellin
Hipin dhe zbresin lehtë në shkallë
Mos zgjojnë diellin.

Është heret…

Nipër dhe mbesa flenë si qengja në pllajë
Dyert e haureve lagen nga qumështi valë,
Plakat thyejnë eshtrat dhe ndezin zjarrin
Si alkimiste të vjetra

Janë plaka…

Të kësaj natyre, vjersha që meritojnë të hyjnë në fondin e artë të poezisë, janë edhe këto: *Harroje vdekjen, Nuk desha, Shtëpia e vjetër në fshat, Vendlindja, Ju s'jeni unë,Sakati* etj.

Vargu i këtij poeti është i pëzier: ka vargje të lira, por edhe vargje të rregullta. Brenda vargut të lirë ka rregullsi, çka tregon se ky poet nuk e shpërdoron vargun e lirë, sepse ky lloj vargu vërtet nuk ka numër të caktuar rrokjesh, rimë, por nuk mund të çlirohet nga ritmi, figuracioni dhe nga pesha e mendimit, ndryshe nuk do të quhej varg…Poeti është i lirshëm në kuptimin që begatia e figurave vjen si shprehje e mendimit poetik.Vargu i rregullt, për mendimin tim, i shkon më shumë Islam Çengës dhe me këtë lloj vargu ka edhe poezitë më të mira, si për shembull: *Simfoni e mbrëmjes në fshat, Natë në Anadoll etj.*

Poeti Islam Çenga, siç e thamë, ka një poezi të lirë në kuptimin se ajo lind nga zemra e poetit në mënyrë të vetvetishme kur shpirti dhe zemra vërtet kanë diçka për të thënë dhe e thonë ashtu si dinë. Por ky poet ka edhe poezi të kërkuara, të sforcuara, të shkruara me zor. Këto poezi mund të kenë edhe figura të bukura, edhe mendim, por nuk janë këto që e bëjnë poezinë. Poezia është "kap ç`të kapësh", një vetëtimë e zjarrtë që përshkon zemër e shpirt në punë sekondash. Pas kësaj mbetet jeta e rëndomtë, minutat, orët dhe ditët e miërzitshme. Prandaj poezia është e pakët, e rrallë…

"Mimozat e Marsit" është nga librat e pakët që më ka pëlqyer. Duke qenë në kohën e rinisë edhe vetë poet, poezia e Islamit më çoi mallin e ndjenjat e asaj moshe që nuk kthehen më.I faleminderit dhe i uroj suksese.

# *Kanuni i përkitur - ESSE nga Fatmir Minguli*

*Nga:* **ALBERT PEPKOLAJ**

Kam kënaqësinë e madhe që sot t'iu prezantoj një libër të ri që autori ua kushton mirditasve e Mirditës, njerëzve dhe vendit, që janë ikonë e pavarsisë, citat i cili shkruhet në faqe të parë nga autori. Unë ndjej detyrimin tim si mirditor dhe si artdashës të prezantoj tek ju këtë libër që i vlen të lexohet jo vetëm ng mirditorët, por nga të gjithë në përgjithësi për shkak të vlerave që mbart si libër. Që në hyrje të tij autori i tregon lexuesit që ky libër përkit me shkrimin e tij biografinë e popullit të Mirditës, të Mirditë së njohur dhe të panjohur ndër shqipëtarë, si dhe e paimagjinueshme për të huajt. Autori dhe pse vetë është nga Jugu, njeri bregdetar, ka bërë kërkime e studime rreth atyre që quhen perla të Mirditës, siç janë Kanuni i Lekë Dukagjinit, Oroshi dhe fisi i Gjomarkajve, Oroshi dhe Internati, Oroshi dhe Abacia, Preng Bib Doda dhe mëvetësia e Mirditës, autenticiteti i kulluar shqipëtar dhe habia e të huajve, njerëzit e zgjuar dhe feja e konsoliduar(Citime nga introduktë). Nuk kanë qenë vetëm kërkimet e studimet e tij që kanë mjaftuar për të bërë të mundur këtë libër, por dhe njohjet autorit me shumë intelektualë mirditorë. Autori thyen ata kufinj paradoksalë të malit me fushën duke njohur vlerat e gjithësecilit nën siglën e asaj që na bën vëllezër, të qenurit Shqiptarë.

Fatmir Minguli në këtë libër i bën përkitje të shkuarës e të sotmes, fakteve dhe të gjitha këto të ndërthurura më kanunin e mirditorët, personaliteteve dhe autorëve të tjerë që kanë shkruar për Mirditën e perlat e saj. Referimet e tij tek një literaturë e pasur dhe ndihma e miqve të tij mirditorë, e bën këtë libër të veçantë dhe tepër të vleshëm në pasurimin e historisë në ditët e sotme.

Ndërthurja e kapitujve me të shkuarën, me historinë, me faktet, me të tashmen e vetë mirditorët, e bën këtë libër një guidë vlerash e principesh që kanë qenë e mbeten të larta. Në këtë libër do gjeni mirditorin e Mirditën, që diti t'i ruajë vlerat e principet e veta, krahas asaj të pasurimit të këtyrave vlerave ndër shekuj, deri në ditët e sotme. Së fundmi duke ju ftuar ta bëni tuajin këtë libër, i uroj suksese Fatmir Mingulit dhe përgëzime për punën e bërë në librin Kanuni i përkitur.

vetëm 600 lekë në vit

kontribuo për gazetën merr kopjen tënde duke u pajtuar

eshte koha per tu pajtuar...

telefono: (04) 22 33 283

Email: rrugaearberit@gmail.com

Pajtohuni në gazetën "Rruga e Arbërit"

BËHUNI PJESË E GAZETËS!

*Pajtimi në gazetë kushton 600 lekë në vit dhe gazeta ju vjen me postë në shtëpinë tuaj**

**Tel. (04) 22 33 283. E-mail: rrugaearberit@gmail.com.**

Numri i radhës së gazetës do të dalë çdo të diel të fundit të muajit.

* Për ata që duan që gazeta t'ju shkojë me postë në shtëpi, ju lutem konfirmoni në redaksi adresën e saktë

Shkruaj dhe ti mendimin tënd!

DEVA design

Design, layout and printing
Internet and Web Site services
Marketing & promotional solutions

HOME | GRAPHIC DESIGN | WEB DESIGN | PRINTING | PHOTO | CONTACT

***Email:*** **info@devadesign.net.** ***Phone:*** **612 203 5960.** **www.devadesign.net**

# kulturë

NËPËR GJURMËT E NJË FISI TË MADH...

## "Me fal gjakun, të të sjell nusen në shtëpi"

*Nga:* SHEHAT CAMI *

Bëhet fjalë për qindra vjet më parë, për kohën kur Hoxholli i Dibrës, ishte jo thjesht pari e Dibrës së Madhe, por edhe më shumë se kaq. Ishte koha kur Dibra i kishte përcaktuar Oxhaqet e saj, kur paritë e Dibrës kishin parë tek Hoxholli, jo vetëm një shtëpi të madhe, të fortë ekonomikisht e ushtarakisht, por edhe një shtëpi të mençur e tradicionale, thënë shkurt ishte kryeoxhaku i Dibrës. Kjo shtëpi e madhe kishte bërë një miqësi me Vezirin e Shkodrës. Bëhet fjalë për Mehmet Pashë Bushatlliun, i cili mori gradën e Vezirit. Kjo i jepte atij shume hapësira administrimi. Hoxholli, si nuhatës i këtyre punëve, më shumë i interesonte miqësia sesa armiqësia me këtë Vezir. Ndaj Hoxholli kishte fejuar djalin me vajzën e Vezirit. Kjo ishte konsideruar një miqësi e madhe. Edhe oxhaqet e Dibrës e kishin parë si një lidhje që forconte më shumë sigurinë në vend. Zakoni ishte që Hoxholli të dërgonte krushqit për të marrë nusen. Kështu u bë, u zgjodhën njerëz të mençur e trima nga gjithë krahina e Dibrës. Krushqit nisen dhe shkojnë të marrin nusen, por çfarë ndodhi? Veziri i Shkodrës, si një prijës i zgjuar, i vuri krushqit në provë. Të parëve u preu nga një palë rroba dhe i përcolli për Dibër. Krushqit, që shkuan herën e dytë, u provokuan më shumë. Këtyre, pasi u prenë rrobat, u morën edhe kuajt, se gjoja i duheshin Vezirit për një punë të rëndësishme. Në Dibër nuk bëhej fjalë tjetër. Veziri i Shkodrës nuk ka poshtëruar vetëm shtëpinë e Hoxhollit, por gjithë Dibrën. E oxhaqet e Dibrës mblidheshin e shpërndaheshin duke diskutuar se si do të vazhdonin. Të prishnin miqësinë, apo të bënin edhe një tentativë për të marrë vajzën e Vezirit. Njerëz të mençur të Dibrës vendosën të gjenin krushq, që t'i shkonin për shtat Vezirit të Shkodrës. Kjo punë u mendua shumë. Askund nuk po gjenin një njeri që të ishte kaq i vendosur për të mos u kthye pas. Një njeri që t'i jepte përgjigjen e duhur Vezirit të Shkodrës. Pasi u diskutua, një nga parite e Dibrës i propozon Hoxhollit të Dibrës: "nëse e keni me gjithë mend me marrë vajzën e Vezirit për djalë, duhet të çoni në krye të krushqve CAMIN". Në këtë kohë, Cami ishte në mal për arsye të një hasmërie që kishte. Hasmi i Camit ishte mik i Hoxhollit e Hoxholli e dinte këtë shumë mirë. U mendua dhe e thirri Zenel Camin në shtëpi të tij, në besën e tij. Në këtë kohë Zenel Cami rrinte në mal vetëm me një vëlla, pa hise, me Kolecin. Punën e Kolecit do të ta tregoj një herë tjetër-më thotë mixha Esat. Pasi u mbush një herë me fryme filloi të më tregonte se si vazhdoi me tutje historia e Zenelit me Hoxhollin. Zeneli shkoi menjëherë për të dëgjuar Hoxhollin. Kishte disa breza që CAMI, nga përplasjet me gjakësor nuk po shtohej. Nga tre vëllezër qe ishin, kishte mbetur vetëm Zeneli e, për të mos e lënë vetëm e shoqëronte edhe Koleci. Hoxholli i tregoi të gjithë historinë se si i kishte ndodhur me Vezirin e Shkodrës. I thotë Zenelit se ti je mundësia e fundit. O vazhdojmë siç jemi, ose prishet gjithçka. Të kam kërkuar edhe për konak, por edhe për mal. Me thuaj se çfare do prej meje. Zeneli u mendua gjatë. Bile, disa pleq të vjetër thonin se përgjigjen ia ka dhënë në mëngjes. Pasi u mendua, i drejtohet Hoxhollit.

-O zotni, unë një kaçak jam sot, por ka gati tre breza që më shumë kam qëndruar në mal se sa në shtëpi. Unë jam gati ta kryej këtë punë, me një kërkesë "Me fal gjakun, të të sjell nusen në shtëpi".

Hoxholli edhe pse kishte dëgjuar për trimëritë e Zenel Camit, përsëri ishte mosbesues. Hoxholli bëri pajtimin e gjakut me një ceremoni të madhe. Tani Cami dhe Leka do të ishin vëllezër. Shumë shpejt ato u bënë edhe miq duke marrë e duke dhënë vajza tek njeritjetri. Krushqit u bënë gati dhe nisen për tek Veziri i Shkodrës. Në hyrje të sinorit i presin disa sejmenë të Vezirit. Sipas zakonit dorëzojnë armët dhe kuajt dhe i çojnë në një dhomë të madhe. Vjen një rrobaqepës, me një shirit metri në qafë, e u kërkon miqve që t'u bëjë disa matje.

Or mik-i drejtohet zeneli rrobaqepsit-Hoxholli i Dibres ka rroba e ushqim për gjithë ushtrinë e Stambollit e jo më për krushqit e shtëpisë së tij. I bëj të fala Vezirit tand se Hoxholli këtë herë na ka çuar me një mendje. Duke pare vendosmerinë e Zenelit, Veziri kërkoi që të bëhet gati përcjellja. Por, edhe pse karvani po nisej, një oficer i Vezirit i kërkoi Zenelit gjoja mirëkuptim, që të niseshin nesër në mëngjes. Po u thoshte, se për të arritur në Dibër, u takon të ecni edhe natën. Në këtë moment Zeneli nxorri nga brezi, që mbante të mbështjellë në mes, nje allti. Alltia e Zenel Camit ishte e larë me ar e shkëlqimi i saj ia vrau shikimin oficerit të Vezirit.

-Dy rruge ka Zenel Cami: ose i gjalle e me i çue nusen për djalë Hoxhollit të Dibrës, ose me vdekë të tanë. Prandaj na qoftë për hajër o mik. Kështu krushqit filluan të lëvizin. Pak metra më tutje ishte sinori ku do te merrnin edhe armët që kishin dorëzuar sipas zakonit. Por për çudinë e të gjithëve, në sinor kishte dalë vetë Veziri. Ai iu drejtua Zenelit:

-Si e ke emrin?

-Zenel Cami ma thonë.

-I bëj të fala Hoxhollit se Veziri i Shkodrës pa u siguru mirë se vajza e tij është e sigurt për me udhëtu nuk do ta jepja. Tani që u binda, se ajo gjallë a vdek, do të shkojë te fati i saj, dola me u përcjellë. Ju qoftë rruga e marë! Ushtarët e Vezirit i shoqëruan krushqit deri në të dalë të Matit, ku kishin dalë për t'i pritur disa forca të Hoxhollit. Ardhja e vajzës së Vezirit u prit me një ceremoni të jashtëzakonshme. Zenel Cami ishte heroi i kësaj historie. Pasi mbaruan dasmën, Hoxholli e thirri Zenelin për ta falenderuar e për t'i thënë, se ai kishte menduar, që t'i jepte disa saraje në Gjoricë, tani si një mik i afërm i kryeparisë dibrane. Miqësia me Hoxhollin u bë shumë e madhe. Hoxholli kishte në shtëpi një vajzë, të cilës i kishte vdek burri. Ajo kishte edhe një fëmijë të vogël. Zeneli për ta bërë sa më të fortë këtë miqësi, por edhe për të treguar besë e respekt njëkohësisht për sarajet që i dhuroi Hoxholli, ia kërkoi vajzen Hoxhollit. Njëherë Hoxholli i thotë se unë nuk kam vajzë për Zenel Camin. Por Zeneli përsëri këmbënguli dhe e bëri këtë miqësi. Në këtë periudhe, ai sapo e kishte ndertuar një shtëpi, apo një kullë siç i thonin atëherë. Ajo ishte me pod, pra me dy kate. Në katin e dytë priteshin e përcilleshin vetëm burra. Më vonë kjo kullë do te ishte edhe një odë e madhe kuvendesh. Pas një rruge të gjatë lëvizjesh, mundimesh, përpjekjesh, CAMI ulet këmbëkryq në Gjoricë. Kështu filloi rrjedha e fisit tim, rrjedhë që më vonë do të bëhej shumë e madhe. Kur kjo rrjedhë u bë shumë e fuqishme, njerëzit do të thonin "Camët i mund vetëm po i përçave, po qenë të bashkuar as gjermani s'ka çfarë t'u bëjë". Kështu nisi historia e një fisi, që shumë shpejt do të bëhej faktor jo i vogël në krahinë e më gjerë. Nisi historia me luftëra e përpjekje për të mbrojtur këto troje që ne gëzojmë sot. Kjo është kurora fillestare e fisit tim; GJORICA; VIÇISHTI; GOLEVISHTI; SEPETOVA; DIBRA E MADHE. Për këtë kurorë përrallore, dhanë jetë me dhjetëra burra të fisit. Them kurora fillestare, sepse sot Camët janë të shpërndarë, pa as më të voglin hezitim, në të gjithë Shqipërinë. Këtë histori e kam mësuar nga gjyshi im e më vonë ma ka treguar më me detaje mixha Esat. Me ndihmën e Allahut të tjera histori do të shkruaj, për të zbardhur sado pak kalvarin e mundimshëm të të parëve të mi.

** Një fragment i shkurtër i paraardhësve të mi:Sipas tregimeve gojore të gjyshit Jashar Cami dhe mixhës Esat Cami.*

*U shënua solemnisht 90 Vjetori i KF "Korabi" të Dibrës.së Madhe*

## Sfida dhe suksese 1921 - 2011

Asnjherë më parë nuk ishin mbledhur kaqë sportistë, veteranë të sportit dhe sportdashës, siç ndodhi të shtunën në mesditë, më datë 28 maj 2011 në Akademinë solemne sportive në restorantin "Penestia" në Dibër të Madhe, ku u shënua 90 Vjetori i themelimit të Klubit Fudbolliostik "Korabi".

Në këtë manifestim merrnin pjesë stafi drejtues dhe furbollistët e "Korabit", veteranët e këtij klubi, tifozët "Sokolat", Argëtim Fida, kryetar i Komunës, Ruzhdi Lata, myftiu i Dibrës së Madhe, Murat Mela, kryetar i klubit "Korabi" nga Nju Jorku me bashkëpunëtorët e tij, përfaqësues të institucioneve, të biznesit dhe dashamirë të sportit.

Siç u tha këtu në këtë ditlindje të madhe të KF "Korabi", dibranët ndjehen krenarë për klubin e tyre futbollistik që respekton kontributin e tërë gjeneratave të futbollistëve.

Me këtë rast u intonua Himni Kombwtar Shqiptar dhe me një minutë heshtje u bë homazh për të nderuar e përkujuar të gjithë ata futbollistë që kanë ndëruar jetë e që sot nuk gjendn në mesin tonë.

Sejfulla Jani, kryetar i këtij klubi falenderoi futbollistët aktualë, trajnerin Hekuran Ushtelenca për ndeshjet e tyre të suksesshme, tifozët "Sokolat" dhe të gjitha ata që financiarisht e ndihmuan KF "Korabi" që tashmë ka hy në Ligën e Dytë futbollistike të Maqedonisë.

Argëtim Fida, theksoi se, " futbollistët dibranë janë pjesë e gjallërisë së qytetit. Merita e tyre është që ne sot 90 Vjetorin e klubit e festojmë me suksesin e hyrjes në Ligën e Dytë Futbollistike të Maqedonisë. Kjo tregon se Dibra e Madhe ka rini të shëndoshë plot enthuziazëm, dhe se këtë rini e presin ditë edhe më të mira. Dibra e Madhe në arsim, kulturë e sport është në krye të veprave atdhetare, duke dhënë personalitete të shquara. Ne si pushtet vendor frymojmë sëbashku me popullatën dhe do ta ndihmojmë edhe në të ardhmen këtë klub sportive", tha Fida.

Ruzhdi Lata, shtoi se, " emri i KF "Korabi" përveç në Dibër të Madhe është shpërndarë në Peshkopi dhe në Nju Jork të SHBA-ve, duke u bërë bërë simbol i Dibrës dhe i dibranëve. Kjo na inspiron dhe jep shpresë se sporti ten a do të vazhdojë. Njeriu që merret me sport është më i lirë, më fisnik dhe më i lumtur. "Korabit" tani i nevojitet ndihmë edhe më e madhe morale dhe financiare. Ata që i dhanë shpirt këtij klubi janë tifozët "Sokolat" që dëshmuan kulturë dhe mirësjellje qytetare dibrane. Është amanet i gjeneratave të mëparshme që të vazhdojë rruga e sukseseve të "Korabit" në lartësinë sa është i lartë vetë mali Korab", tha myftiu Lata..

Këtë tubim e përshëndetën edhe Murat Mela, përfaqësues i Klubit "Korabi" nga Nju Jorku, Gafur Bllata veteran i futbollit, Fuat Spahiu, përfaqësues i ekipit aktual të "Korabit", Terlit Përnaska, ish trajner i klubit dhe Albert Kuka, organizator dhe ideator i 500 tifozave "Sokolat" nga Dibra e Madhe.

Arben Jajaga, i cili ka përgatitur për botim një libër për KF "Korabi", foli për historikun e themelimit të këtij klubi futbollistik në vitin 1921 dhe rrugëtimin e tij 90 vjeçar, plot svida e suksese gjer në ditët e sotme.

Të djelën, më 29 maj në stadiumin e qytetit pasdite u mbajt pjesa e dytë e këtij manifestimi solemn, me një koncert me këngë e valle nga SHKA "Haki Stërmilli" nga Dibra dhe mysafirë të ftuar. Pas kësaj në stadiumin e qytetit u luajt loja miqësore festive mes "Korabit" të Dibrës dhe "Shkëndijës" së Tetovës.

***Rexhep TORTE***

*Reklamoni biznesin tuaj!*

GAZETA "RRUGA E ARBËRIT"
VË NË DISPOZICION
HAPËSIRAT E NEVOJSHME
PËR REKLAMËN TUAJ!

Tel: **(04) 22 33 283**

*Email:* **rrugaearberit@gmail.com**

*Ballafaqimi i tyre bie fjala me Testamentin e Pjetër Budit (1618-1621) apo të Arbëreshit Luka Matranga (1592) do të pasuronin gjuhën kombëtare e do të jepnin shembuj të tjerë bindës mbi lashtësinë e gjuhës Dibrane e më gjërë.*

# Në gjurmët e lashtësisë të dialektit dibran

Dr. **SELMAN MEZIU**

Mjedisi shumë relievësh gjeografik shqiptar ka ndikuar në shtratifikimin e dialekteve të larmishëm. Studimet gjuhësore në fushën e morfologjisë, e të fonetikës kanë nxjerrë në pah dukuri gjuhësore, të cilat për gjatë shekujve kanë pësuar ndryshime, por duke ruajtur në substancë origjinalitetin e tyre. Këto rrjedhojë e shtegtimit provizor apo e shpërnguljeve për shkaqe ekonomike, luftrash, gjakmarrjesh të një ose shumë familjeve apo individëve të veçantë, e kalimit të pushtuesve të shumtë dhe e proceseve historike e gjeografike gjithmonë në lëvizje e zhvillim, në kohë e hapsirë.

## PËRZGJEDHJA E MATERIALIT

Duke studiuar dorëshkrimin e priftit arbëresh, *Bonifaçio Tamburit* do të përpiqemi të gjejmë fjalë apo shprehje që përdoren në të folurën Dibra-ne. Shkruar në tridhjetë e gjashte faqe, në prillin e vitit 1834 me shkrim dore, paraqet interes studimi në lëmin e gjuhësisë. Qëllimi i ketijë testamenti të krishterë ka qenë që të përdoresh nga vëllai i tij *Françesco Antonio Tamburo*, në kishën Shën Gjovani Batista ku shkonin edhe shumë Arbëresh, në krahinën e Kozencës të Italisë Jugore.

Autori i dorëshkrimit ka përshtatur alfabetin italian pët të shkruar në gjuhën shqipe. Traditë kjo e përdorur edhe nga studiues të gjuhës Arbëreshe të Italisë si *Demetrio Camarad* (*1864*), *Marko la Piana* (*1939*). Për tiu afruar sa më shume tingujve në gjuhën tonë autori ka përdorur disa shkronja greke si :*f* përdorur në vend të sh; ë e ngjajshme me ll; s si shkronjën nj; è e përdorur si dh; ì e përdorur si shkronja dh; Ù e barazvlershme me germën ë; Ü në trajtën e a,

Në përdorimin e foljeve të kaluar në zgjedhimin e tyre, të cilat janë të pranishme në të folmen e fshatrave të ndryshme të Dibrave. Psh ''... kush na kri'arti e na 'vu; mbi-'dhe:// (f. 17) Ose... . mos *t'*-kamarosh të *premtet*... . e t'-bjermi 'je:rlin tën// (f. 73), *t'shë mundën shif sejs* ( f. 21), ashtu -'*koft*// (f. 23), *na-do* më 'mir neve/ (f. 29), vjem medhense i biri t-in *zot'muar* shpirt/ (f. 31), se-'t-*vemi* ndë-'pa'rajsit// (f. 47), e t-*kungosh* ndë pashk ' mbdha:// (f. 59), e-'*mer* të gjall// (f. 65), tshë 'ti *na-kalzova*/ e *na-kalzon ë-sh çish* / (f. 69), e t-'*bjermi gjelin* të:n//(f. 73) sa s-'ke *ku-t-jesh* 'më:/(f. 79), ëm-në *gradzjun* tënde ndëshpirtit të:n *mbana* dorën sipër/ (f. 81), 'operate-'mira tshë-'kemi të bëmi '*ture* bër kumanda'mendet e-t-in'zot/ (f. 55), e-'*mer* të gjal// (f. 65)

Përdorimi i përemrave psh. Koft bekuar emri 'it/art rejra *jote*. . (f. 47), . . është mbrenda ndë *krejt* (f. 19)

Po keshtu edhe në mbiemrave, cilësor, sasior e dëftor psh... se im'zot ësh i-*'dret*/ e ju dhikon të -*'dretat(f. 21)-'... pstana* kujt i '*-truhemi* (f. 49) / e *per'ziejti* ' me vet'hen/ *e'leu*' ka *sh-muria* e virgjër// (f. 31), /mbe*ha-rakosur* //, ... 'mos të-*'zami* emrin (f. 55), '*vret* shpirtine-'tij//, / e judhi'kon të- *dretat*/ / 'kuj *i-nget* ' pisa mund i-'jap pa'rajsin// (f. 45), 'tsili ësht *i-dijti* shu'rbes/(f. 47), pstana *kuj i-'truhemi'*// (f. 49), *sh-janjit* batist ( Vasil) (f. 51), e për-'dhe-se *na-i-takse* ti tshë-s-'mund thuaj në të *reme* (f. 75), ti *mbjedhsh t-'hujtmit* // (f. 83) 'një *i-vetmë ësht* inzot// (f. 25), E çë u le ka Shën Mëria e Virgjër... (f. 104), e ata tshë-'ve:ndë-*pis* pse thuhen/ (f. 43), për'dhese'ka:n'mbëkaten *murta:l* ndë shpirtit/ (f. 43), t-'i 'mbjedhsh *t-hujtmit*// (f. 83).

Le të hymë në hullin e të shkruarit të emrave, e shprehjet mohuese apo pohuese, psh e vdis *nden*' (f. 21), kriqe... mos dishromi *petkun*(f. 31). 'bukën e-'*grinj*// (f. 65), ''dritën 'tënde ndë-*tru:t* 'tona... (f. 81); ne *mangu* gra:t/ (f. 57)... t'-jemi e-sul s-ngrëni (f. 61). . 'buk e *grinj*, mbi *shëjtançish* /, / mos u-*shkata-rua*/ (f, 37), *'tata ' i:in*/ (f. 47), 'po '*reshtna ka'*: gjith t'-ligat// (f. 47), të-afrosh ndë-vi'gjilie/ e ndë-'*kre*-(f. 57), 'ka një *privtë* ar'breshë (f. 13) tsh-'ë *gjella,* e-'shpirtit (f. 43), t-'jemi e-*'sul* s-'ngrëni/ (f. 61).

Ndërsa në fomimin e mbimrave dëftor e pronor ndiqet një formim tjetër që i ngjan guhës së folur Dibranee, e'pse *kta* të-'tre *vet* (f. 27), dunka, *tsilli 'ksi* 'vet 'ke më i-'pari (f. 27), 'art re'jira ''*jote* / (f. 47), e të *ligjvet* 'pis:an për sembri//.

Edhe në përdorimin e nyjeve e të pjesëzave shkruesi i përdor duke rimuar me fjalën e më pasme. Psh... *ka* kriqa ku *ma vu:n*// (f. 33)

Si mund të formohen fjalë të reja, nga rrënja me fillesë një emër, duke e përdorur më pas si folje, duke pasuruar kështu fjalorin e gjuhës sonë. Psh. 'mos t-kamrosh të premtet/ (f. 57) *'mer kurmin'*// (f. 63), të *shèrishmi* 'gjakun tën/(f. 73), e gjith *tribulit e'jets* / (f. 79), për *gjindia* e -'shën *vasilit*... (f. 13), 'vate u-*kall:ar* ndë pist të *trajtën* dit u ngjall... (f. 23), mos e *ti'ranistin*' djalit (f. 35). parka'les për ne: të-*mkatruamit* na'ni/ (f. 51), sa s'ke *ku:t-'je* /(f. 75), 'bore pa'rajsin/ e *gadhnjeva* ' pisën/ (f. 79)

Në vargjet e rrjeshtave të këtijë testamenti të krishter mund të zbulojmë edhe toponomistikën në trevën Dibrane, e konkretizojmë me disa gjetje.

'sa: 'ja:n si'njalet *e-scomo-li:* të mi:r// *(f. 63), sh-më'ri:* e virgjër/(f. 71), . . per opera e Shpirtit *Shejtë, leu ka Sh-Mria e Virgjër*. . (f. 21), e'leu ka *Sh-um'ria* e 'virgjër// (f. 31).

Për të kuptuar lehtësisht, domethënien e fjaleve, është shkruar i gjithë vargu, pavarsisht se është përdorur shtresëzimi sipas, emrave, foljeve, mbiemrave, etj e këto mund ti gjejmë nga njëra te tjetra. Dukuri e cila nuk duhet të çoi në gjykime të gabuar morfologjike apo sintaksore.

Në një vështrim të thjesht fjalësh, shkruajm që te autori është ndikuar nga gjuha italiane, Psh. *Operate= inf. Operare* ( me veprue), *vigilia*= në prag *duncue* = pra, *vate* = inf. *Andare* = me shkue, *nani* = i vogël, ose xhuxho; *sembri* = me u duk, *gradzizjan* =it. (Inf. ) *Grazie* = falemindërit.

Kjo nderfutje është e natyrshme e pranueshme ashtu si në gjuhën e sotme shqipe e veçanëisht në gjuhën Dibrane e më gjëre gjejmë fjalët Turke, Sllave, Italiane e me pak Greke, dukuri të vëna në dukje nga studiues të huaj si G. Meyer (1895), P. Skok (1931), F. Viscidi (1944), N. Andriotis (1967), H. Mihanescu (1968), M. G. Bartoli (1912), G. Stadmuller (1966) e më vonë gjuhtarët vendas si E. Çabej (1976), Sh. Demiraj (1973) A. Kostollari (1969) etj.

Meqënse shumë fjalë janë të moçme e sot nuk përdoren në shqip po japim kuptimin e vërtet, për të kuptuar më mirë domethënien e vargjeve e qëllimin e këtijë shkrimi: t-shë =çë; sej = sehir; medhense= me thënë; mbedha = mëdha; ë-sh = është; çish=çfar; Ëm-me = ma jep, me dhënë; pstana= pastaj, judhikon= ua tregon; pis ose pisa= vend i pistë, i flliqur, i papastër, t:sili = çë; sh. Janjit = shën Vasilit; përd-

> Kushdo që do të përpiqet të hedhë dritë mbi fjalëformimin e gjuhës në trojet Dibrane, do të gjendet përballe të papriturave të këndshme, në shqiptimin elegant, e plotë muzikalitet, në fjalë me plotë kuptim e të përdorshme nga poet, shkrimtar, gjuhtarë, vetëm kështu me këto kërkime do të pasurohet leksiku i gjuhës së shqipëtarëve.

hese = përse, pse etj; shkatarua = me u shkatërrue; art Regjira = arti i drejtimit; parkales = të lutem, fjalë greke, e ndërfutur nga autori; Tata = baba; bore = në kuptimin e humbur.

Këto jane të paktat fjale që janë gjetur në vargjet që ne kemi përdorur pë të nxjerrë në pah fjalët qe përdoren në dialektin e të folmes së zakomshme. Bashkësia e fjalëve, të tjera kuptohet lirshëm, duke e krahasuar me gjuhën e sotme letërare.

Për të kuptuar vendosjen e nyjeve, pjesezave, parafjalëve, e vetë fjalëve janë përdorur, apostrofi, viza horizontale, ndërsa për të treguar zgjatjen e një tingulli të zanoreve apo dyfishimin e zanoreve janë përdorur dy pikat e ku mbaron nje varg janë vendosur një ose dy viza të pjerrta.

## KËRKIME E PËRQASJE GJUHËSORE

Në të shkruarin e emrave, mbiemrave, foljeve, përemrave, lidhëzave e pjesëzave, shohim thjeshtëzime në të shkruarin e tyre, apo siç thuhet *rënie të shkronjave* psh: *esul* e jo esull; *reme* e jo rreme; *gjale* jo gjall; *na do* e jo na don, *mer* e jo merr; *ndë* e jo ndër; *dret* e jo drejt, *gadhnjeva* ndërsa tanimë njihet mire rregulli sotëm i drejtshkrimit, *ngadhnjeva*.

Një tjetër dukuri është perdorimi i zanoreve të hapura e jo e atyre të mbyllura, pra të shqiptuara letësisht e jo grykore, në emra, nyje, parafjal etj; psh. *Muar* e në drejtshkrim mori; *zami* në gjuhën e sotme zemi; *na kriarti* e sot thuhet na krijoi, *çish* e me gjuhën e sotme qysh, *na* vu; *na* do; *na kalzova* ; në vend të *na ; mbana* në vend të fjalës së njëvlershme mbaj.

Përdorimi i pa karar i ë, në te folmen e toskërishten është bërë si rregull për të gjithë, ndërsa autori i testamentit e përdor atë me shumë kursim duke dhënë mësime të reja në ortografinë e gjuhës shqipe e duke iu afruar gjuhës së folur Dibrane, *ësht* e me drejtshkrim shkruhet është; *kto* e me drejtshkrim këto, *vet*, *jan* sipas rregullave tëdrejtshkrimit të vitit 1972 shkruhen me ''ë, , në fund, etj.

Duhet të nënvizojme se kemi edhe përdorimin e një bashtingëllore për një tjetër, rregullsi të të folmes krahinore të Dibrës psh *privet* e sot flitet e shkruhet prift; ose *truhemi* e në drejtshkrim e në të folmen e jugut druhemi; *koft* e në të shkruarin e folmen zyrtare qoftë.

Si shenjë e rëndesishme pikësimi apostrofin në vargjet e tijë autori e përdor si eleminues të bashtinglloreve apo zanoreve, psh *t'vemi* sipas rregulave drejtshkrimore: të veme; *t'jesh* tanimë normalisht shkruhet: të jesh, *t-'vetim,* ndërsa rregulli i sotëm: të vetin.

Le te analizojm e gjykojmë mbi një tjetër emër, psh *gjelin* ka kuptimin *jetë*, përdoren shpesh shprehjet '' i erdhi *Egjeli* sot e vdiç, , ''Kur të vjen *Egjeli,* s'ke çfar tìi bëjshë, , Në këtë rast kemi të bëjmë me një fjalë shumë të vjetër, të cilën në ditët e sotme duke i vëne një e e përdorim në formën mohuese, më shqeto: *i mori jetën, i këputi jetën*.

Ndërsa një përfundim tjetër i rëndësishëm është po të analizojmë *fjalen:kamrosh*. Rrënja e kësaj fjae është fjala e përdorur gjërsisht në gjuhën Dibrane e më gjërë *Kama*, emër i një pjese anatomike të shumicës së gjallesave që përdoret *për të ecur*, psh, kam njeriu, dhie, lope etj ose edhe shprehja ''nën kamët e malit, , . Pa ngurim mund ta përdorim si *folje:me kamëru*. Nuk duhet të ngurojmë përse përdoret në gjuhën italiane të kësaj fjale: *Caminare*. Tanimë njohuritë mbi gjuhen e pellazgëve e bashkëlidhjen me një shumicë fjalë të Ilireishtes e më pas të shqipes janë te mirënjohura. E më tej e gjejmë si toponim, Kamen, lagje në lindje të qytetit të Peshkopisë; Kamniku, vendbanim shumë i lashte sipas zbulime arkeologjike, në krahinen e Kolonjës; Kamëz, qytezë në veri-perendim të Tiranës.

Formimi i fjalëve me përdorimin e prapashtesave apo parashtesave është dukuri gjuhësore morfologjike e kahershme, e cila ka pasuruar e vazhdon të çoi më tej numurin e fjalëve, duke pasuruar fjalorin e të shkruarit e të folurit, kjo vlen si për dialektin dibranë ashtu edhe për testamentin të marre si objekt studimi. Po e konkretizojme me shembuj;dhe ja *Mekatruami* e formuar nga bashkimi i një emër e një folje *mekat* edhe këtu në vend të ë është përdorur e, ndërsa në të folmen e zakonshme është zëvendësuar me fjalën turke *gjynah*, e dibrançe *xhinof*, *ruami* ku kemi rënie të *j* e në vend të ë përdoret i, *tiranistin*t e përbëre nga *tiran* e prapashtesa *istin*, *tribulit* formimi i së cilës ka në vetevete numurin *tri* e emrin *bule*, e cila përdoret në kuptimin *Bula uji*, ose më shqeto *pika uji* etj, apo si emër njeiu *Bule, Makbule*; pra një numur i caktuar, vetish, cilësish, karakteristika të një objekti të caktuar.

Në një dokument të Vatikanit të vitit 1635 shkruhet: ''Shën Maria e Malit pothuajse e shkatërruar, ka 27 të krishterë, , Sot ky mal me lartësi 1161 m. ka marrë emrin e kishës pra *Mali i Shmrais*, e një tjetër toponim *Ara e Shmresë* qe gjëndet në lindje të Qafës së Shënelleshe. nga ku shikohet Hurdh Muhurri. Një fshat në rrethin e Kukësit quhet *Shëmria*, ndërsa në jug lindje të Gramshit ndodhet një vendbanim tjetër që quhet *Shëmëriza*. Ne testament Prifti arbëresh Tamburi e përmend në këto forma: *Shnëria, Shmria* e *Shmuria*, pra kuptohen qartë ndryshimet morfologjike të këtijë emri, dhe forma e sotme që shkruhet e folet në krahinën e Dibrës.

Ndërsa *Shën Vasili* quhet një toponim në afërsi të Shorokanit, vendbanim në mes fshatrave të Muhurrit e Vajmdheve, ku ndodhen germadhat e një kishe që thirret si më sipër e përmendur disa herë në dorshkrim. E vertetuar edhe në dokumentat e Vatikanit, e Tefterin turk të vitit 1467 po kështu kemi një emër fshati në rrugën Delvinë kala e Sopotit, sipas tefterit Turk të vitit 1583.

Le të gjykojmë mbi fjalen *Premte*, emërtohet dita e pestë e javës, e zëvendësuar në të folmen dibrane me fjalën turke e *Xhuma*, por këte fjalë e gjejmë si emër vendi *Qafa e Shënepremtes*, e cila gjëndet ne mes Arapit të Epër e Lishanit të Epër në Dibrën e poshtme.

Të pushton habia, kur analizon ndryshueshmërinë e fjalës *Skomolli*. Nga historiani grek Polibio e kronisti i Pushtimeve romake Tito Livio shkruajne për malet *Skardus, Scordi, Scodrum* deri ne ditët tona. Po të afrohemi në kohë kemi një përrua qe quhesh *Prroi Shkamjanit* e malin e *Sorokolit* me lartësi 2178 metër. Kuptohet qarte evolimi gjuhësor, morfologjik, filiologjik i fjalëve përgjat kamërimit të shekujve.

**PËRFUNDIME E REKOMANDIME**

Gjeografikisht krahina e Dibrës bën pjese në veriun e Shqipërisë e për pasojë edhe gjuha e shkruar dhe e folur bën pjesë në këtë qerthull pra ''Shqipëria e veriut, pra territori më malor i sajë, i vërtetuar nga shumë burime se ka origjine shumë të lashtë, , - shkruan Profesori i Universitetit të Kopenhagenit Kr. *Sanndfeld*. Struktura gjuhesore e materialit të mësipërm hedh dritë mbi një leksik fjalësh të moçme. Ruajtja e të cilave është kryer në mënyre të përsosur në vendbanimet e thella malore të trevës Dibrane.

A kemi të dhëna të mjaftueshme për vendorigjinën e priftit arbëresh B. Tamburit? Nuk kemi burime te besueshme, veçse dimë që parardhësit e tije jane mergimtarët nga Shqipëria, pas vdekjes së Kastriotit të Madh. Por përse vallë në në 36 faqet e dorshkrimit të tijë gjejme fjalë të trevës ne fjalë? Pyetje së cilës përgjigjen e gjejmë te studuesi *M. Helbig* i cili në vitin 1904 shprehet në një studim të tijë mbi gjuhën Arbëreshe: ''Nga njëmijë fjalë të shkruara, rreth 465 jane Shkodrançe, ndërsa rreth 360 jane në dialekti shqiptar që flitet në Siçili e Kalabri, , Lind natyrshëm pyetja. A bën pjese Shkodra në Gegëri? Sigurisht, bashke me Dibrën. Përfundimi është i thjeshtë por me vlera për *universalitetin e gjuhës Shqipe e konservimin e saj përtej brigjeve të Adriatikut për shekuj të tërë e po kështu në gjirin e maleve e luginave të Shqipërisë në mijëvjeçar*. E vërtetuar më së miri nga studiuesit Aref Matieu(2008), Girolana De Rada (1846), Gustav Mayer (1844), Elena Kocaqi (2000), Max Lambertz (1914), Norbert Jokl (1917), Carlo Taliavini (1942) etj.

Sa dobiprurëse do të ishte për historigrafinë, gjuhësine, gjeografinë, etnografinë, mbledhja e shprehjeve dhe fjalëve të dialektit Dibran për rastin tonë që nga Draj Reçi, Arrëmolla, Gurë Lura, Kacnia, Okshtuni iVogël, Ostreni, Zogjajt, Zimuri, Kalaja e Dodës, Lajthiza e të tjera fshatra të kësaj treve të virgjer në këte fushë. Ballafaqimi i tyre bie fjala me Testamentin e Pjetër Budit (1618-1621) apo të Arbëreshit Luka Matranga (1592) do të pasuronin gjuhën kombëtare e do të jepnin shembuj të tjerë bindës mbi lashtësinë e gjuhës Dibrane e më gjërë.

Kushdo që do të përpiqet të hedhë dritë mbi fjalëformimin e gjuhës në trojet Dibrane, do të gjendet përballe të papriturave të këndshme, në shqiptimin elegant, e plotë muzikalitet, në fjalë me plotë kuptim e të përdorshme nga poet, shkrimtar, gjuhtarë, vetëm kështu me këto kërkime do të pasurohet leksiku i gjuhës së shqipëtarëve.

*Burimet e shkruara*

1- Francesco Solano, Il Catechismo Albanese di San Basile. Roma 1983
2- Fulvio Cordignano. Geografia ecclesiastica dell'Albania dagli ultimidecenni delsecolo XVI alla mete del, secolo XVII. Roma 1934. Drejtshkrimi i gjuhës Shqipe, Tirane 1973
3- Kr. Sandfeld. Linguistique Balkanique, Paris 1930
4- Fjalori enciklopedik Shqiptar, Tiranë 1985
5- Studi Abanologici, Balkanici, Bizantini e orientali. Firence 1986
6- Fatos Mehdi Daci. Enciklopedia e Dibres, Tirane 2006
7- Hazis Ndreu, Kastriotët dhe Skënderbeu në trojet Arbnore. Tirane 1977
8- Kristo Frashëri, Në gjurmët e qyteteve peneste. Në ''Studime Historike. . N. 4 Tiranë 1975

# Enigma dhe polemika dibrane në vargje

Faik Prençi, megjithëse i ka kaluar të shtatëdhjetat e viteve të jetës vazhdon të jetë "student" në Universitetin e Dibrës, megjithëse jeta e detyroi në fillim të migrojë baltave të Laçit e më vonë, tash shumë vjet, rrugicave të Athinës.

Faik Prençi lindi në Reç, në atë "Mal" të Dibrës ku Drini i Zi futet në shtrungë e malet merren n'grykë për të përcjell vesh më vesh bëma që shkruar janë në eterin e valëve të kujtesës popullore.

Në vitet e fëmijërisë e rinisë u shkollua për mësues për të matur me këmbë gjatësinë e luginës së Drinit e lartësinë e maleve, klasave me nxënës...

Nuk e pati derën të hapur për të hyrë në auditorë universitarë. Të hapur, si gjithë të tjerët, e pati derën e auditorit të Odës Dibrane në Universitetin e Dibrës, atje ku në shekuj njeriu hyn e mbetet student tërë jetën.

**"Unë kam mbaruar universitetin e Oksfordit, por mbarova edhe një universitet të dytë, atë të Dibrës ", thotë Reginald Hibbert në "Albania Life "**

Faik Prençi, megjithëse i ka kaluar të shtatëdhjetat e viteve të jetës vazhdon të jetë "student" në Universitetin e Dibrës, megjithëse jeta e detyroi në fillim të migrojë baltave të Laçit e më vonë, tash shumë vjet, rrugicave të Athinës.

E tregon këtë edhe kjo përmbledhje poetike e titulluar "Enigma dhe polemika dibrane në vargje", nga kroi i së cilës mbusha një bucelë me ujë për ata që dinë ta pinë e freskojnë shtatin...

**A. ASHIKU**
**Athinë, 20 tetor 2010**

*Faik Prençi*

## BUJARIA

**- Më thoni**
**një rast,**
**kur dibrani**
**s'e ka qas:**
**lipsin,**
**udhëtarin,**
**pazarliun**
**e bezdisshëm,**
**me kalë,**
**me lopë,**
**me dy- tre dele**
**me dy- tre dhi,**
**për në pazar...,**
**ta ketë lënë**
**jashtë,**
**të piqet në vapë,**
**apo të ngrijë**
**në dimër,**
**për një copë bukë**
**e disa kg. barë?**

**- Një dua**
**e unë,**
**le të mbes**
**gënjeshtar....!**

## TRIMËRIA

**Më thoni një rast,**
**në tërë luftërat**
**jug – veri,**
**që s'ka pasur**
**(Aty) dibranë?....**

**Dua tani**
**të më thoni:**
**- cila krahinë,**
**i erdhi në ndihmë,**
**Dibrës në luftë?....**

**Çdo dhelpër,**
**lëvdon bishtin**
**e sajë,**
**edhe kur një qime,**
**i ka mbetë....!**

## ENIGMA DIBRANE

**Përse mbeti**
**(pikë),**
**(enigma)**
**te dibrani?...!**

**Me enigmë,**
**organizohej**
**në luftë,**
**kundër (hasmit).**

**Me enigmë**
**(pikë),**
**nxjerr vrer**
**e shkul rrënjë:**
**- për të pabesit,**
**hajdutit,**
**dembelit,**
**apo të tjetrit....!**

## HEJ!

**Hej thërriste,**
**tellalli në raste**
**delikate:**
**- Nesër delet,**
**I sillni**
**të pinë ujë,**
**në Drinin e Zi!**
**- A më dëgjuat?....!**

**Fjala**
**nuk ishte**
**për delet,**
**(Ajo) ish**
**për trimat,**
**me zënë shtigjet!**

## NJË HERË TJETËR....

**Tellalli në janar**
**me daulle në dorë,**
**bym, bam, bym**
**thërriste:**
**- Hej, hej,**
**gruri duhet korrë,**
**korbat janë shumë,**
**po arritën në arë,**
**një kokërr**
**s'kemi për të marrë.**
**- A më dëgjuat mirë?....!**
**Duhej të armatosen:**
**- gratë, vajzat, plakat,**
**të mbrojnë kullat.**
**Burrat, djemtë, pleqtë,**
**nga 16 – 70....**
**këmbë për këmbë**
**me hasmin në fushë.**

## FODULLI I PUSHKËS

**Njëri pushkën**
**në krahë**
**me litarë,**
**e mbante**
**me grykë poshtë.**
**Tjetri me rripa**
**e llamarina**
**që vezullojnë,**
**me tytën lart.**

**I tha plaku, plakut:**
**- Ajo e të parit,**
**me litarë e**
**grykën poshtë,**
**nuk më pëlqen!...**
**- Mos të pëlqen,**
**ajo vezulluesja**
**me tytën lart,**
**pa bërë**
**asnjëherë**
**bam....?**

**- Or budalla!**
**Të parin,**
**e mbron**
**pushka var**
**në mur.**
**Nuk i del**
**askush përball**

## FODULLI I SOFRËS

**Dibranët thonë:**
**- Shih sofrën e ha,**
**shih sofrën e mba....!**

**Pyesin:**
**- Ku ishit?**
**- Te filani...**
**- U ngopët,**
**apo u kënaqët?...**

**Lezeti**
**tek tjetri,**
**është muhabeti!**
**.....**
**- Barku vëlla i detit!**

## FODULLI I ODËS

**Në anët e oxhakut,**
**respektohen:**
**- Jabanxhinjtë,**
**të moshuarit,**
**të mençurit.**

**Kuvendin në odë**
**ata, e komandojnë!**
**Të tjerët, pyesin**
**e dëgjojnë.**

**Kur dy krerët**
**e oxhakut,**
**s'janë të aftë,**
**fillon enigma lojë:**
**- A, i erdhi goja**
**filanit?....**
**- Jo!...**
**- I kish humbur**
**dëgjimi dhe vëllait!**

**Ramis Daci ishte ndër deputetët e parë të parlamentit të parë të vitit 1921. Ai bashkë me Gani Strazimirin, Irfan Ohrin e të tjerë, të prefekturës së Dibrës, i zgjedhur në komisionin për punë të administratës e të ushtrisë, i kërkoi qeverisë që të ngrihej administrata civile në Dibër, kur dihej se ajo ishte pushtuar deri në "Kufirin Strategjik" të 1918-tës nga serbët.**

# Ramis Daci, një nga shtyllat kryesore të lëvizjes dibrane

*Nga:* **XHELAL ROÇI**

Në qytetin e Dibrës së Madhe ndodhet edhe vendi i quajtur Sokaku i Dacit rrugicë që ka marrë emrin nga Kulla e Dacit. Kjo ka ndodhur në pjesën perëndimore të qytetit dhe këtu jetonte kryesisht fisi i dacave të Dibrës që kanë bërë emër të mirë në historinë e Shqipërisë. Kulla e Dacit është ndërtuar rreth vitit 1873. Të parët e familjes Daci thuhet se i ka sjellë në qytetin e Dibrës Hoxholli, ish oxhak kryesor dhe me funksione të rëndësishme qeveritare për shtetin turk, rreth shekullit XVIII dhe XIX. Ata erdhën nga fshati Zogje, i Malit të Grykës Vogël, të Dibrës së Epër dhe i ka vendos me banim pranë pallatit të tij. Këtu kanë banuar familjet e Liman Dacit, Jeshar Dacit, Selim Dacit dhe Sehit Dacit. Një ndër bijtë e këtyre familjeve ishte edhe Ramis Daci. Ramis Daci lindi në vitin 1883 në qytetin e Dibrës Madhe në një familje Atdhetare e Patritotike. Të parët e fisit të tij kanë dale nga fisi Leka i Zogje i përmendur për tradita Atdhetare. Aktualisht fisi Dace banojnë në Zogje, në Diber të Madhe, në Gjoricë, Shupenzë, Tiranë, Peshkopi, Bulqize e tjerë. Ata kudo që janë shquhen për trimëri, bujari, besnikëri. Edhe pinjolli i tyre Ramis Daci, me vëllezerit Shaqir e Qamil Daci në Dibër të Madhe, janë gjaku i Lam Dacit dhe i Mahmut Dacit të Zogje të Grykës së Vogël. Shaqir Daci në vitin 1894 hapi në fshatin Homesh të Grykës së Vogël të parën shkollë shqipe. Dhe vetë shërbeu si mësues[1]. Qamil Daci Atdhetar i flaket, kundërshtar kryesor i sundimit osman. Shtëpia e tij u kontrollua disa herë për aktivitet politik gjatë sundimit turk. Ky vetë u burgos disa herë nga autoritetet e qeverisë turke dhe vdiq në qytetin e Dibrës së Madhe në vitin 1935 [2].

Ramis Daci studimet e para i kreu në qytetin e Dibrës së Madhe. Me vendim të Bashkisë së qytetit të Dibrës, ai dërgohet në Stamboll në shkollën ushtarake fisnike *Hashiret Mektebi* prej të cilës doli oficer me gradën nëntoger. Ai në Stamboll ra në kontakt me atdhetarë Shqiptarë të cilët ndikuan në botëkuptimin e tij dhe i krijuan bindje atij për t'i shërbyer çështjes kombëtare shqiptare. Ai si oficer i ri u lidh me patriotët më të dëgjuar të kohës. Revolucioni turk *Xhon Turk* Ramis Dacin, e gjen me detyrë ushtarak komandues në Rekë. Entuziazmi dhe besimi i ditëve të para, si tek shumë patriotë dhe atdhetarë të tjerë: * Se Xhon Turqit do të plotësonin kërkesat e tyre politike për Shqiptarët edhe tek Ramis Daci u shua shumë shpejtë. Ramis Daci që në moshë të re bashkëpunonte me Sahit Najdenin (Hoxhë Vokrin), Vebi Agollin, Dibrën, Sherif Lëngun dhe me të tjerë udhëheqës popullor që punonin për liri, pavarësi e përhapjen e gjuhës shqipe. Këto luanin role të rëndësishme për çështjen kombëtare. Ramis Daci që në Kongresin e Dibrës në vitin 1909 u dallua me qëndrimin e tij, në luftën për të drejtat e popullit Shqiptar Bashkë me patriotët e tjerë dibran u bë folësi më i zjarrtë i vendosjes së një alfabeti në gjuhën shqipe. Ai ishte një ndër iniciatorët kryesor për hapjen e shkollës normale të Elbasanit. Ashtu si Rilindas të tjerë Shqiptarë e dibranë, Ramis Daci, punonte për të parë shqipen të përpunuar e të zhvilluar. Ashtu si Said Najdeni, Haxhi Vebi Agolli, Dibra, Sherif Len gu, Fuat Dibra ( ky i fundit shkriu gjithë pasurinë për t'i ardhur në ndihmë çështjes kombëtare) edhe Ramis Daci punonte që të. Përhapej sa më shumë mësimi i gjuhës shqipe. Ai luftoi me grykën e pushkës dhe me forcën e fjalës. Turkofilet e pengonin hapjen e shkollave në gjuhën shqipe Qëndresa antiturke e Ramis Dacit dhe e patriotëve të tjerë dibran bëhet e njohur në kongresin e Dibrës. Megjithëse Kongresi u thirr si një mbledhje osmane, atdhetarët shqiptarë me Sahit Najdenin, Haxhi Vebi Agollin Dibrën, Dervish Himën, Sherif Lëngun dhe Ramis Dacin e shëndruan atë në një arenë të luftës kundër reaksionit Xhon Turk për mbrojtjen e të drejtave kombëtare të popullit Shqiptar. Ramis Daci ishte ndër të parët që mori pjesë në ngritjen e flamurit në Vlorë më 28 Nëntor 1912 dhe vihet në shërbim të qeverisë së Vlorës. Ai më vonë mbështet princ Vidin dhe lufton kundër Esat Pashës e tradhtarëve të tjerë. Esat Pashë Toptani pasi u muar vesht dhe hyri në lidhje me elementet dhe krerët reaksionar të Dibrës, ai erdhi në qytetin e Dibrës së Madhe. Këtej lumit "Drini" dhe Dibrën e Poshtme e kishte në dorë Isuf Beg Agolli, Dohoshishti, i cili kishte organizuar një qeveri autonome. Esati pasi bëri marrëveshje me këto krerë, erdhi në qytetin e Dibrës së Madhe me 3000 vullnetar. Xhelal Zogu dhe Hysen Beg Golja nisen me 200 forca prej Peshkopie në Dibër për t'i dalë përpara e për ta shoqëruar Esatin nga Dibra për të ardhur në Peshkopi. Rrugës afër Maqellarës një grup nacionalistësh shqiptarë si Ramis Daci, Izet Maqellara Maliq Agolli, Kërçishta, Hasan Ballanca e të tjerë i bënë pritë për ta vrarë, por krahu i Esat Pashës ishte më i fuqishëm, i detyroi kundërshtarët të largohen nga prita dhe e liruan rrugën për të kaluar Esati me forcat e tij. Esati pasi erdhi në Peshkopi organizoi një mbledhje. Një pjesë e krerëve të tij e panë veten të zhgënjyer dhe u kthyen në disfavor të Esatit, pasi ky kishte ardhur në Shqipëri nga Serbia, me të cilët ata gjithmonë kishin qenë në luftë. Esati nga ana tjetër formoi një fuqi mercenaresh me 3000 veta dhe i paguente krerët si pas pozitave që u kishte dhënë, ndersa vullnetarëve u dha nga dy napolona flori.[3]

Ramis Daci përfaqesoi Dibrën në Kongresin e Lushnjës më 21 janar 1920. Ai u zgjodh deputet i Dibrës dhe senator. Kur kërciste pushka për çlirimin e Shqipërisë, Ramis Dacin e gjejmë përkrah Hasan Prishtinës, Bajram Currit, Eles Isufit e të tjerë vullnetarë që i kishin dalë zot Atdheut. Veprimet me armë i kishte nisur herët, që kur luftonte kundër çetave epirote në Korçë. Ramis Dacin e gjejmë të pozicionuar në llogoret kundër pushtuesve të rinj serb. Edhe gjatë luftës së parë botërore, kur në Shqipëri ishin austriakët, Ramizi shërbente si oficer. Pas largimit të tyre me 1919, Shqipëria ishte në kaos. Edhe në këto situata të turbullta, Ramis Daci ishte i kudondodhur, atje në ballët e betejave ku kërciste pushka për çlirimin e Shqipërisë. Sipas gazetës "Ylli i Dritës" date 13 shtator 1921, një grup deputetësh me emrin "Bashkimi i Shejtë" me organizator Hoxhë Kadriun, At Gjergj Fishtën, Ramis Dacin e të tjerë, ishin me çdo kusht për ruatjen e kufijve te Shqipërisë të vitit 1913. Ishte ajo kohë kur serbët pretendonin për "kufi strategjikë" dhe kërkonin të vendosnin kufirin Qafë Llangë, Qafë Buall, Qafë Muhurr, Lëndë Lurë e më tej. Ramis Daci në Kongresin e Lushnjes përfaqësonte krahun patriotik, ndërsa Dine Dema, Dine Beg Maqellara dhe Osman Lita, si pas tyre krahun nacionalist. Me datën 8 prill 1920, Ramis Daci kritikoi qeverinë për mfshehtësine e saj në marrjen e masave kundër grupeve turbulluese. Në shkrimet e tij Ramis Daci është për një demokraci të ndershme. Në gazetën "Shkumbini" që mban datën 27 maj 1921, mes të tjerave ai shkruente"… Populli me një mendim filozofik kërkon ndryshimin e jetës së vet, dhe nuk e don më atë jetë e cila e ka lodhë, e ka shtyp prej shumë shekujsh. Shkurtazi don të zotërojë vetë e jo ta zotërojë një diktator, një feudal i cili të mbështetet e të sundojë si i do zemra mbi popullin. Vegjëlia nuk ka më i duruar më… Parlamenti Shqiptar u hap, grupet u ndanë dhe partitë po formohen. Dhashtë Zoti e erdhët një mbarësi. Por të mos harrojmë se vegjëlia kërkon një ndryshim të vërtetë, një qetësi të plotë, një konstitucion të dobishëm për fatin e vet".

Ramis Daci ishte ndër deputetët e parë të parlamentit të parë të vitit 1921. Ai bashkë me Gani Strazimirin, Irfan Ohrin e të tjerë, të prefekturës së Dibrës, i zgjedhur në komisionin për punë të administratës e të ushtrisë, i kërkoi qeverisë që të ngrihej administrata civile në Dibër, kur dihej se ajo ishte pushtuar deri në "Kufirin Strategjik" të 1918-tës nga serbët. Qeveria u detyrua të pranojë propozimin e tij, por me kusht që të mos kalohej ky, që për kohën ishte për lumit "Drini".

Në këtë shkrim duket largpamësia e tij dhe Atdhetarizmi i flakët. Aty dalin në pah pikëpamjet e tij demokratike në mbështetje të vegjëlisë e kundër diktaturave feudale e prijësve injorant e tradhëtar, të cilëve u bën thirrje për ndryshim, për drejtësi e barazi, kundër shtypjes e shfrytëzimit.

Ramis Daci ishte ndër deputetët e parë të parlamentit të parë të vitit 1921. Ai bashkë me Gani Strazimirin, Irfan Ohrin e të tjerë, të prefekturës së Dibrës, i zgjedhur në komisionin për punë të administratës e të ushtrisë, i kërkoi qeverisë që të ngrihej administrata civile në Dibër, kur dihej se ajo ishte pushtuar deri në "Kufirin Strategjik" të 1918-tës nga serbët. Qeveria u detyrua të pranojë propozimin e tij, por me kusht që të mos kalohej ky, që për kohën ishte për lumit "Drini".

Ndërsa vazhdonte Lufta e Vlorës, nënkolonel Ramis Dibra, senatori Ramis Daci dhe Jeshar Erebara në muajin korrik 1920 u nisën nga Tirana për në Dibër. Ata bënë mbledhje në fshatin Arras, ku morën pjesë të gjithë krerët e arratisur e të tjerë të fshatrave përreth, si dhe krerët e parësisë Ramis Dibra, Eles Isufi, Dine e Izet Beg Maqellara, Ramis Daci, Shaqir e Dine Dema Dine Hoxha, Selim Noka, Murat Kaloshi, Dervish Lusha e të tjerë. Me datën 7 gusht 1920 në Arras u mbajt një tubim ku Ramis Daci në prani të 3000 vetëve foli për fitoren e Luftës së Vlorës dhe detyrat që shtroheshin para dibranëve. Në mbledhje u biseduа çështja e një aksioni kundër Serbisë (Jugosllavisë) pa u këshillua me qeverinë e Tiranës. Qëllimi i këtij aksioni ka qenë të detyroheshin forcat serbe të tërhiqeshin në kufijtë e vitit 1913 dhe përveç kësaj të çlirohej qyteti i Dibrës së Madhe. Dibranët do të detyroheshin të luftonin si vlonjatet, për Dibrën nuk mendonte as qeveria dhe as viset tjera të Shqipërisë.

U bisedua për koordinimin e forcave në një shtab të përbashkët dhe u caktua komandant Elez Isufi, gjithashtu u caktua edhe dita e kryengritjes. Më 13 gusht 1920 u mbajt Kuvendi i Arrasit. Në këtë kuvend marrin pjesë burrat e Dibrës të ardhur nga e gjithë krahina e Dibrës por kishte të ardhur edhe nga krahina e Matit. Nga paria e Dibrës kishte elementë të veçantë që mbanin ndaj pushtuesit veprime të lëkundura, bënin lojë të dyfishtë, përhapnin panik e frikë për kryengritjen. Në kuvend u bisedua çështje e kryengritjes kundër ushtrisë serbe. Qëllimi ishte që të detyrohej Serbia të tërhiqej në kufijtë e vitit 1913 dhe të çlirohej Dibra e Madhe që banohej vetëm nga shqiptarë. U diskutua dhe u vendos që të lihen me një anë gjaqet dhe hakmarrjet. Në Kuvend foli Ramis Daci i cili ndër të tjera tha "Kanë luftuar të paret tanë e ne na i kanë lënë t'i gëzojmë këto troje. Sot na i ka pushtuar serbi, do të luftojmë ne t'i gëzojnë fëmijët tanë. Do të luftojmë ore burra se na ka ardhur radha." Secili nga krerët do të përgjigjej për forcat që do të sillte në front. Në Kuvend u morën një sasi vendimesh. Së pari u përgatit plan i veprimeve luftarake, mësymëse të forcave popullore kryengritëse. Planin e përgatiti Ramis Daci, Ramis Dibra, Dulejman Çela që të tre ish oficera që kishin kryer shkolla ushtarake. U zgjodh një komitet luftarak. U organizua bashkëbisedimi në mes fshatrave e krahinave për veprimet luftarake. U muarën masa për ushqimin e luftëtareve. Komandant i Frontit u caktua Eles Isufi. Secili nga krerët ishte komandant në sektorin e tij, me forcat që vepronte. Këto forca sollën rezultate që më 16 gusht 1920 Dibra u çlirua dhe u pastrua nga serbët. Ramis Daci u çmua se bashkëpunoi me personalitetet më përparimtare të vendit që aspironin dhe luftonin për një Shqipëri të lirë dhe për demokratizimin e saj. Ndërmjet tyre mund të përmendim Fan Nolin, Luigj Gurakuqin, At Gjergj Fishtën, Dervish Himën dhe të tjerë. Interesante është një letër që Ramis Daci i dërgon Fan Nolit në lidhje me "Historinë e Skënderbeut". Në letër i sugjeron për përkatësinë e Kastriotëve dhe shtrirjen e tyre në Kastriot të Dibrës së Poshtme.

Në muajin mars të vitit 1922, Ramis Daci, bashkëpunon me elementet përparimtarë për organizimin e një lëvizje antizogiste, thirrjen e asamblesë kombëtare dhe normalizimin e vendit. Lëvizja e marsit edhe pse nisi dështoi. Ahmet Zogu nuk mund ta harronte kërcënimet e Ramis Dacit në parlament deri në tentativë për ta goditur me karrige në kokë në prani të gjithë deputetëve. Ramis Daci niset nga Tirana dhe vjen në Dibër, me që ishte deputet i Dibrës dhe propogandonte hapur kundër qeverisë së Ahmet Zogut. Porsa vjen në Peshkopi, Ahmet Zogu i jep urdhër Fiqiri Dines për ta arrestuar, me që ky i fundit kryente detyrën e qark komandantit të xhandarmërisë në Dibër. Ramis Daci ishte nip i Fiqiri Dines. Përveç se nip Ramis Daci kishte dy motrat të martuara në Peshkopi, Telutën me Shefqet Shehun, ndërsa Melihanë me Qamil Shehun, kurse Fiqiri Dinja ishte i martuar me Rukije Arif Shehun. Motra e Fiqiri Dines, Sania ishte e martuar me Sul Shehun në Peshkopi. Pra kemi të bëjmë me miqësi të kryqëzuar. I zënë ngushtë nga këto marrëdhënie miqësore, Fiqiriu e kundërshtoi në fillim arrestimin dhe asgjësimin e Ramiz Dacit. Vetëkuptohet se ky veprim e poshtëronte Fiqiri Dinen në Dibër. Ahmet Zogu i dha urdhër të prerë. Fiqiri Dinja kreu arrestimin e Ramis Dacit dhe e dërgoi të arrestuar tek daja i tij Shaqir Dema të shoqëruar nga xhandarë. Shaqir Dema përsëri të shoqëruar me xhandarë e dërgoi Ramis Dacin në Zerqan ku ishte rreth komandant Hysni Dema, djali i vëllait të Shaqir Demës dhe kushëriri i parë (djali i dajës, Hysni Dine Dema) i Fiqiri Dinës. Ky gjoja do ta niste për në Tiranë dhe kur po kalonin te Ura e qytetit ku ndahet Valikardha me Fushe Bulqizën e vrau pas shpine gjoja Ramisi tentoi të arratiset ndërsa po urinonte. Vrasja e Ramis Dacit u krye më datën 10 qershor 1922. Kjo vrasje tronditi botën përparimtare. Atë e ndjeu fort lëvizja demokratike. Lëvizja që punonte për një Shqipëri të lirë dhe demokratike. Levizja që punonte vetëm kundër armiqve të popullit shqiptarë. Elementë të ndryshëm përparimtarë protestuan me mënyra

Vërtet kështu ishte luftëtari, i rëndë nga gishti, luftën nuk e pushoi gjatë gjithë jetës. Shpirtin e bardhë dhe zemrën që rrahu për Atëdheun, si i gjithë populli i Grykës së Vogël dhe Dibrës.

# JAM I BARDHË NË SHPIRT

*Lam Daci*

*Nga:* **Zabit LLESHI**

Turqit i kishin t'merr djemtë e Daceve, sepse shtëpitë e tyre ishin çerdhe luftëtarësh që mbanin lidhje midis patriotëve të maleve me ato të Dibrës së Madhe, Manastirit, Kosovë e Stambollit

Daci është një fis në Zogje, dalë nga Leka (Vëlla me Markën e Lleshin). Gjatë shekujve kanë jetuar në këto troje, në një territor të kufizuar kodrinoro-malor të Grykës së Vogël. Si rezultat i shtimit të popullsisë (fisit), pronat e pakta dhe të pamjaftueshme shumë familje migruan në Gjoricë, Shupenzë, Dibër të Madhe e Tiranë. Ata nuk e harruan vendin e të parëve, ruajtën lidhjet e marrdhëniet me vatanin, origjinën, zakonet dhe traditat e maleve të Dibrës e të vendlindjes.

Në Dibër të Madhe Dacët krijuan një lagje me emrin "Sokaku i Dacit". Krijuan influencë të madhe, arritën të bënin shumë simpantizantë e miq edhe pse ishin banorë të rinjë. Njerëz të shquar e patriot me zë kanë dalë nga gjiri i këtyre familjeve. Të njohur me veprimtarinë e tyre patriotike në dobi të Atëdheut u bënë Shaqir Daci (veprimtar i lidhjes Shqip të Prizërenit) Qamil Daci në lidhjen e Pejës, Seit Daci veprimtar për mësimin e gjuhës shqipe, për të ardhur te Ramiz Daci deputet i Drinit në parlamentin Shqiptar në vitet 1920 – 1924.

Turqit i kishin t'merr djemtë e Daceve, sepse shtëpitë e tyre ishin çerdhe luftëtarësh që mbanin lidhje midis patriotëve të maleve me ato të Dibrës së Madhe, Manastirit, Kosovë e Stambollit [1].

Pas çlirimit të Shqipërisë më 1944 në Tiranë erdhën djemtë e patriotit Ramadan Daci, ndërsa pas vitit 1990, 4 familje erdhën në Tiranë dhe 4 në Durrës. Ata bëjnë një jetë normale e punojnë rregullisht, një pjesë e fëmijëve të tyre edhe pse në emigracion mbajnë e ruajnë kontaktet me të afërmit, të tjerët vazhdojnë shkollat duke u integruar plotësisht në jetën plot vrull e intensitet të kryeqytetit.

Siç tregonte Shefki Lleshi por edhe veterani Kalosh Daci nga Dacët kanë dalë Miftarët e Hysët mjaft të nderuar dhe respektuar në rrethet Shqipëtare të Maqedonisë, por edhe në Prishtinë e Shkup. Shquhet prej tyre Z. Mahmut Hysa profesori i gjuhës Shqipe në Universitetin e Prishtinës.

Rreth vitit 1835 lindi në Zogje në një lagje të vogël, por që i dha emër të madh, Lam Daci. Ashtu si edhe fshati, familja e Lamit merrej me bujqësi e blegtori. Gryka e Vogël kishte pak tokë. Varfëria ishte e pranishme edhe nga luftrat e pandërprera brez pas brezi që zhvillonin dibranët kundër perandorisë osmane. Kurbeti dhe lufta ishin plagë të përhershme edhe në shekullin e 19. Bashkëvendasit e Lam Dacit, ndërsa ai rritej, shihnin trimin e ardhshëm dhe luftëtarin e paepur për mbrojtjen e trojeve nga pushtuesit e huaj kryesisht ato osmanë. Ishte koha e reformave të Tanzimatit por 9 malet zgjodhën kundërshtimin e vendosur unanimisht. Kjo solli tronditje në perandorinë osmane (tension, nerva, dyndje ushtrish) që nuk kaluan lehtë për Dibrën. Asaj do ti kushtonte luftë të gjatë, humbje njerëzore, varfëri dhe njëkohësisht punë të jashtëzakonshme për mbijetesë. Në këto kushte tek-tuk kryheshin grabitje nga grupe të vogla në Maqedoni dhe në vise që kontrolloheshin nga turqit edhe pse ishin në kundërshtim me vendimin e maleve për ndalimin e veprave të tilla. Karari i maleve kishte vendosur të ndalonte çdo lloj grabitje sidomos për ato që ishin afër kufirit. Lam Daci u përball me një detashment turk në grykën e Radikës dhe në përpjekje e sipër vret disa prej tyre. Ky lajm bëri bujë të madhe dhe kudo në Dibër diskutohej trimëria e Lam Dacit me shokë.

Qeveritarët turq në Dibër të Madhe kërkuan krerët e Grykës Vogël ndër to edhe Lam Dacin për të biseduar rreth disa problemeve që lidheshin me marrdhëniet e maleve me qeverinë. Ishte pregatitur një kurth për vrasjen e Lam Dacit i cili e kuptoi qëllimin e takimit dhe nuk shkoi. Planet e makinacionit për eleminimin e patriotit dështuan.

Autoritet qeveritare osmane hartuan plane të tjera kundër Lam Dacit. Ato dërguan forca të mëdha ushtarake drejt Grykës Vogël nën komandën e Demir Pashës.

Në pranverë të vitit 1872, pasi hartuan planin nëpërmjet një kallausi (u tregoi rrugën për vendodhjen e kullës së Lam Dacit) marshuan për në Kodrën Dace ushtarë të armatosur gjer edhe topa. Demir Pasha mendonte se malet nuk do të vinin në ndihmë Lamit sepse kishte kthyer Kararin e tyre. Sapo mori vesh se trupat turke erdhën në Kovashicë, Lami u përgatit për tu bërë ballë. Së bashku me djemtë dhe shokët e mbrojtën me heroizëm kullën. Zhurma e topave alarmoi malësorët e Grykës Vogël; Erdhën Tush Lleshi, Bajram Makja, Zenel Daci në ndihmë të patriotit të cilët nxorën jashtë luftimit ushtrinë e Demir Pashës.

Krisi topi mu ke kështenja
Kulla e Lam Dacit dridhet mrena

janë disa nga vargjet e këngës së Lam Dacit. Krismat e topave u dëgjuan edhe në Luzni, djemtë e Ali Prethit erdhën pa vonesë me një frymë në ndihmë të Dajës.

Kush është ai që lufton n'atë kullë
asht Lam Daci me do cullë
nuk janë cullë por janë Luznak
pushkën Dibra e ka zanat!

Kështu e vlerësoi populli ardhjen e nipërve të Dace nga Luznia që mbështetën luftën e Lamit e të luftëtarëve të tjerë nga Zogjet kundër Demir Pashës.

Ashtu si dhe mjaft pashallarë të tjerë turq lanë ushtrinë në malet e Dibrës edhe Demir Pasha iku kokë ulur:

Demir Pasha qan me lot
S'un e mora Lamin sot!

Demir Pasha bëri shumë përpjëkje për ta njohur Lam Dacin, prandaj herë pas here e kërkonte qoftë me patriotët ose njerëz të tjerë mjafton ta afronte atë. Mundësia u krijua kur Lami u bind se ishte midis njerëzve ku pashai nuk mund të realizonte qëllimet e tij djallëzore.

Zanin t'a kisha ndigjue, or Lam Daci, por me sy ma mirë mos të kisha pa- i tha Pashai Lamit.

Jam i vogël nga trupi, por i randë nga gishti.
Jam i zeshkët në fëtyrë por i bardhë në shpirt[2]
– përgjigjet Lam Daci.

Vërtet kështu ishte luftëtari, i rëndë nga gishti, luftën nuk e pushoi gjatë gjithë jetës. Shpirtin e bardhë dhe zemrën që rrahu për Atëdheun, si i gjithë populli i Grykës së Vogël dhe Dibrës.

të ndryshme për këtë vrasje makabër. Qeveria që erdhi në fuqi pas ngjarjeve të qershorit 1924 bëri përpjekjet e duhura i gjeti eshtrat e Ramis Dacit dhe mori masa për t'i varrosi në vendin e tij në Maqellarë. Më 23 tetor 1924, ditën e enjte para dite në qytetin e Peshkopisë, nxënës të internatit "Dibra", të rinj të shoqatës "Djemnia Dibrane", popull i ndodhur në tregun e Peshkopisë, me që atë ditë ishte ditë pazari në Peshkopi u organizuan e tubuan të bashkuar, me flamur e parulla në dorë u përgatitën që të nesërmen do të niseshin për në Bulqizë për të bërë zhvarrimin e eshtrave të patriotit Ramiz Daci.

Ditën e premte më 24 tetor 1924 në mënyrë të organizuar u nisën për rrugëtim për në Bulqizë. Te Ura e Qytetit, ishin mbledhur populli i fshatrave për rreth kishin ardhur edhe nga fshatrat e Grykës Vogël, nga fisi Dace dhe të afërm të familjes së tij. Pasi u bë zhvarrimi i eshtrave të tij, ata u futën në një arkë të përgatitur për atë qëllim. Të mbështjella me flamur kombëtar e me kurora me lule arkën e morën në krahë të afërt të familjes së tij të shoqëruar nga të pranishmit u nisen për në Zerqan. Atë nate ata qëndruan në Zerqan dhe të nesërmen në mënyrë të organizuar u nisen për në Maqellarë. Ceremonia e rivarrimi të eshtrave të tij u bë ditën e henë me datën 27 tetor 1924. Te pranishëm ishin pjesëtar të familjes së tij, shokë dashamires, përfaqësues të pushtetit lokal, ushtarakë pjesëtar të shoqatës "Djemnia Dibrane" nxënës të shkollave, fshatarë të ardhur nga fshatrat për rreth dhe shume pjesëmarrës nga rrethe të tjera edhe nga Dibra e Madhe. Varri ishte rrethuar me lule. Nga nxënës dhe të rinj u recituan vjersha përpara varrit të ti folën Dervish Hima, Tafë Agolli, Beqir Valteri nga Mati dhe D. Llazer Shantoja nga Shkodra. Shtypi i kohës me datën 28 tetor 1924 shkroi për ceremoninë e varrimit të eshtrave të deputetit Ramis Daci, ai përshkrujti për pjesëmarrjen e njerëzve duke cituar edhe pjesë nga fjala që u mbajt nga të pranishmit e në veçanti nga Llazer Shantoja. Të gjithë folëën me konsideratë për të ndjerin.

Në telegramin e datës 30 tetor 1924 ndër të tjera thuhet: "Në këtë ceremoni morën pjesë gjithë malet e Dibrës si dhe përfaqesues të ardhur nga Shkodra, Durrësi, Tirana, Elbasani, Shijaku, Kruja, Dibra e Madhe e Kosova…. ". Dorës së zezë që vrau Ramis Dacin, njeri nga shtyllat kryesore të lëvizjes dibrane, nuk do t'i hiqet njolla e tradhtisë. Historia do te flasë për veprat terroriste e tradhtare të këtyre kriminelëve. Kështu e nisi dhe e mbylli jetën e tij ky Atdhetar i Madh i Dibrës dhe i Kombit Shqiptar, vepra e të cilit nuk vdes kurre. Fisi Dace ka lënë gjurmë per patriotizëm në shërbim të Atdheut gjatë periudhave të ndryshme historike.

Ja si këndon populli i Dibrës trimërisë së Daceve në luftë kundër turqve:

Krisi topi ke gështenja
Kulla e Dacit dridhet brenda
Ç'ka ka kulla që dridhet brenda
Është Lam Daci me shtatë zemra….
Demir Pasha na shkoi Gjurrës

S'ia mori Dacit çatinë e kullës
Demir Pasha po qan me lot
Pse s'mun e mora Lam Dacin sot……"
Këngë popullore Dibrane.

1 Hazis Ndreu: Dibra në Udhën e Historisë f 156
2 Xhafer Martini. Perlat e Dibrës f 28

Për hartimin e kësaj monografie të shkurtër janë shfrytëzuar materialet e marra nga këto dokumente:

1. -Monografi e Seit Najdenit.
2. -Monografi e Dervish Himes.
3. -Dosja e dëshmorit të Atdheut Ramis Daci në Muzeun His. Të Dibrës.
4. - Ballafaqime politike në Shqipëri viti 1897-1942, Autor Sejfi Vllamasi.
5. -Lufta e Dibrës e vitit 1920 kundër serbëve. Autor Bajram Xhafa.
6. -Libri: Dibra dhe Etnokultura, vëllimi i II-të
7. Tregime gojore e kujtime nga Ali Gjoni Maqellarë, Kadri Demir Osmani Allabegi dhe Sakip Gole nga fshati Pocest. Këto të tre e kane përjetuar ngjarjen. Peshkopi, më 2 Shkurt 2011. Përpiluar nga Xhelal Ramis Roçi.

## Njoftim për bashkëpunëtorët

Të nderuar bashkëpunëtorë

Prej muajsh, redaksia ruan në arkivin për botim disa materiale, të cilat po të botohen zënë një hapësirë prej 2 ose më shumë faqesh.

Për këtë arsye, redaksia e gazetës "Rruga e Arbërit" njofton gjithë bashkëpunëtorë e saj, se shkrimet që sillen për t'u botuar, duhet të jenë jo më shumë se 5 faqe të daktilografuara (përafërsisht 10000 mijë karaktere, pa përfshirë hapësirat). Materialet që vijnë me email ose në çdo lloj forme elektronike, duhet të jenë në **Word**, me fontin **Times New Roman**, të madhësisë **12pt** dhe me hapësirë **1.5**. Gjithashtu, kujtojmë se materialet e pranuara në formë elektronike duhet të kenë patjetër germat **"ë"** dhe **"ç"**.

Çdo material i gjatë do ti nënshkrohet redaktimit dhe shkurtimit për tu botuar në versionin e shtypur të gazetës. Versioni i pa shkurtuar do të botohet çdo muaj në internet në adresën: www.rrugaearberit.com. Autorët mund ti shkurtojnë vetë shkrimet dhe të na i përcjellin në redaksi me dy versione botimi: **për gazetë** dhe **për internet**.

Duke shpresuar në mirëkuptimin tuaj, ju përcjellim konsideratat më të mira të redaksisë për bashkëpunimin e deritanishëm..

**Për sqarime më të hollësishme mund të na kontaktoni me email në adresën <rrugaearberit@gmail.com> ose në tel. 069 20 68 603.**

**REDAKSIA.**

Rruga Arbërit nr. 61
tregim

# Tërfili me katër fletë

Tregim nga ***BAJRAM HYSENI***

*Ne kujtim te të ndjerit, shkrimtarit, poetit e publicistit Bajram Hyseni, po ribotojmë këtë numër një tregim të tij të botuar 2 vite më parë në gazetën Rruga e Arbërit*

**1**

**"Tërfoja me katër fletë**
**Mjeri unë kush e ka gjetë**
**Medet se ç'u bë tërfoja.**
**M'a kërkon nuse zoja... "**
**Popullore**

Familjet e Gjokolës e të Bitrit, edhe pse nuk janë të një besimi, hyjnë e dalin e i ndodhen njëni tjetrit pranë në hidhnime e gëzime. Ded Gjakola ka vetëm nji vajzë, Mrikën, kurse Staf Bitri, vetëm nji vlla, Sufën e nanën. Sufa e Mrika, u rritën bashkë, tue ruejt gjanë. Vetëm kohët e fundit, ata nuk shkojshin në mal. Sufa i mbushi njëzetëdy vjetët, kurse Mrika pesëmbëdhjetë. Ded Gjokola e ndaloi të bijën të shkojë me kullota gjanë. Vajza, vitin e fundit, lëshoi shtat e u ba kuq-kuq në fytyrë, si molla dhe gjinjët i brofën përpjetë e gjoksi ju fry sikur do ti plaste. Por ky vendim i Dedës nuk e gëzoi Sufën. Ai i mjerë, pesë vjet me radhë, andrroj për Mrikën, po kurrë nuk e pruni fati mbarë që t'ja thotë nji gjysëm fjale për dashurinë që e kish zanë. Shpesh kishte marrë vendim, po sa e shikonte Mrikën, i lidhesh fjala në grykë e në fytyrë këndellesh si llatuk gjeli dhe e shifte veten krejt i pazoti me qit fjalë prej goje. Tash që Mrika u ndalue të shkojë në mal, kjo u ba edhe ma e vështirë, sepse Mrikën e takonte vetëm oborreve, ku edhe muret baheshin hafie po të thoshte një fjalë. Shpesh e priste Mrikën në udhë, por pa dobi. Sufa e përshëndeste dhe ajo i përgjigjesh me nji buzëqeshje kokëulun e nji të kuq që i mbulonte fytyrën si duvak dhe asgja tjetër. " Edhe ajo e ka mizën në ksulë", - kishte mendue shpesh Sufa ndër vehte. Kohët e fundit, ai nuk flinte fare, vetëm mendonte, andrronte për Mrikën, për jetën. Si do të shkojë halli, "vetëm nji zot e dinte". Veç të tjerave, ajo asht edhe e krishtenë, "punë që nuk bahet". O Zot, pse kto vajzat e krishtena i ke ba ma të hieshme? – mendonte shpesh Sufa e folte me vedi. Në fytyrë i ra nji ngjyrë e verdhë dhe u ligështue shumë. Vetëm sytë i xixëllojshin si shkëndia, ndën nji vetull si gajtan i zi. Kishte sy të trishtueshëm, por edhe të zjarrtë e plot jetë.

-Pse je ligë kaq fort, bre Sufë?- i tha atij nji ditë nji shoku i tij teksa po ktheheshin nga stanet.

-As vetë se di, po e kam diçka më duket se zemrën s'e kam mirë. Edhe nana ma ka thanë këtë fjalë.

-Pa thueje, se do Perëndia e të ndihmoj edhe unë. Na shokë jemi. Pra më fol me zemër të çilun.

Sufa ktheu kryet me të shpejt, e shikoi shokun drejt në sy, mandej i foli me gjysëm zani:

-Mos më tradhëtoni !Selim! Të lutëm! Më dalç si vlla në këtë dhe n'at botë.

- Mos e thuej atë fjalë, por fol pa frikë, unë jam shoku yt i besës. .

- Kam sevda me nji vajzë, nuk flejë, po çmendem!

-Po me cilën?- Ja priti Selimi e sytë ja kishte ngjitë në fytyrë.

- Ma mirë mos ta thom emnin e saj, se nuk ka me të ardhun mirë. Le të vuej kështu si jam, Selim! Le të vuej, le ta mbaj ndry në zemër. . ! Mos të baft vaki si mue.

-Për kryet e nanës e gjithçka kam në shtëpi, as nuk e flas, as nuk zemrohem në ty, do ta ruej në zemër, sikur s'kam ndie gja! besa besë!

-Mrikën e Ded Gjolokës!- ja priti Sufa. - teksa zemra po i rrifte me të madhe. Ajo po më çon në vorr për së gjalli, më beso ! Edhe zgjuet, edhe në andërr, vetëm Mrikën kam para syve! Ma ka vjedhë zemrën si me magji... !

-Në Mrikën ke shtie sevda? Mjeri unë për ty por ajo është e krishtenë! Si kështu?

-Krishti vetë le të jetë, ta thashë, po mbaroj, në më ndihmon, mirë, në s'më ndihmon, mshile gojën e asgja tjetër, na shokë e vllazën jena prapë.

-Zor e ke, por po të tregoj nji ilaç. Gjej nji tërfojë me katër fletë dhe e fitove davanë, asht gja e sigurtë, e kanë provue shumë njerëz. Po ta gjej unë, kam me ta dhanë. Pra, unë edhe ti, asht mirë ta kërkojmë nji tërfojë ksi soji.

- Me të vërtetë ! Oh, ty të lumtë goja, ma grofe zemrën që më ishte ba akull.

-Për zotin, nji shok kështu e fitoi. Ja shtiu fletën e tërfojës në xhep e vajza ju qep prapa e i shkoi drejt e në shtëpi. E ç'vajzë, ma e mira në malet tona!...

... Atë natë, Suf Bitri nuk bani gjumë fare, tue mendue në asht apo jo e vërtetë përralla e tërfojës me katër fletë. Në mëngjes e zgjoi i vëllai e i ngarkoi nji detyrë:

**2**

-Ti, Sufë, do të shkojsh në Zall e të kositësh livadhin se asht pjekë tërfoja e mandej shkundet. Zakovat merri të ngushta, se ka bar shumë e drue të dhamin shpatullat, digjove?

- Si jo, do ta kositi me gjith qejf, që të mos kesh marak fare. Si mprefi kosën, e vuni në krah, Sufa u nis për në Zall. Rrugës ja kishte marrë fishkëllimës e ecte tue u shatapat përmes rrugës, ndonëse mendimin e kishte te Mrika, te ajo që e kishte në sy, në zemër, si ta kishte vjedhë prej pasqyrës. Drini rrëshqiste ngadalë i çkujdesun e degët e shelgjeve ishin varë e cekshin në ujë. Hieja e tyne dridhesh si gjarpën nga valët që shkojshin njëra pas tjetrës. Zogjtë cicërojshin nga vapa, e era e tërfilit të livadhit të mbushte krahnorin. Dielli i nxehtë të përvëlonte! Si kapërceu gardhin, Sufa ra në livadh, bari i erdhi deri në gju. Tërfoja ishte mbreti i livadhit të tij, i shtruem si qylym i blertë, cep e më cep livadhit. Përtej Drinit, në zall, ja thonte nji fyell bariu, kurse te gurra mrizojshin tufat e katundit.

-Këtu ka, jo me katër fletë, por edhe me tetë!- tha Sufa gëzueshëm dhe si vuni kosën në gardh u krrus të kërkojë tërfojën me katër fletë. Hap pas hapi, ai po afrohesh midis të livadhit. Prapa i mbeteshin gjurmët si në borë. Si u lodh tue ndejnë i krrusëm, u ngrit dhe vuni duert në ijë, u përkul majtas e djathtas e përsëri nisi punën për të gjetur fletën që do t'i epte lumtuninë. Ndoshta do të gdhihej tuj kërkue... Po zani i të vllait, nga maja e kodrës: "Eja në shtëpi!", sikur e zgjoj nga nji gjumë i randë, nga nji andërr, sa e mirë, aq edhe e trishtë.

-Bobo, iku dita, për zotin ! – tha me vete, mandej ai e fshehi kosën në shelgjet që rrethojnë livadhin e u nis për në shtëpi.

-Nanë, nuk më hahet darkë, due me fjetë, jam lodhshëm! – i tha Sufa namës, por Stafa e ndigjoi e si bani buzën në gaz i foli:

-Eh ti, pizeveng, u lodhe me dhjetë zakovë, eh, ç'burrë na qënke...

-Jo dhjetë, po gjysmën e livadhit, ja priti Sufa krenarisht. Nesër shpresoj ta mbaroj krejt, - tha me vendosmëni, sikur me të vërtetë do të kishte krye aq punë, si një burrë bash kostar.

-Të lumtë, për ty kena me gjetë nji nuse, ma të mirën në këto anë. Më ka thënë nji mik se përtej Drinit, asht nji cucë, që shoqe nuk ka, ke del e ke bie Drini në det. Nesër do të shkoj në bjeshkë për furda dhe me t'u kthye, do të çoj njeriun ta kërkojë cucën. Kena me ba dasëm të madhe e do të grishim gjithë miqtë e shtëpisë sonë. Sufa e pa të vllanë në sy dhe buka iu lidh në grykë si sukull po nga turpi, se ishte nana aty, nuk tha asnji fjalë. Ndërsa me mend e veta tha: "Kurrë mos u baftë e mbarë, unë do marr Mrikën". Në mëngjes, si u përshëndet me vëllanë, Sufa u nis për të mbarue pjesën që kishte mbetë në livadh. Edhe kjo ditë shkoi si të tjerat, tue kërkue tërfojë me katër fletë, po qe e kotë. Ai e kërkoi livadhin cep më cep e tërfoja s'po gjindesh. - Edhe kjo s'asht gja!-tha me vehte Sufa, - Duhet zemër, zemër, me katër fletë. Eh, moj Mrikë, ç'po më mundon, borxh do të më jesh, në këtë dhe në atë botë!... Të nesërmen, që ishte dita e tretë, nanë Fatimja, ra të shofë kostarin. Kur u afrue pranë gardhit pa se i biri ishte krrusun në mes të livadhit, sikur kishte humbë gjylpanën.

-Ç'farë ban kështu, more kostar i nanës? Kështu e ke kosit livadhin? Po nusen si do ta ruejsh, kështu tue bredh pas flutrave?. . Sufa ktheu kryet i trembun e mandej erdhi me vrap te nana e vet.

-Nanë, mos u mërzit, unë ndiha shokët e mi e ata do më ndihin nesër. "Edhe unë nuse po kërkoj, - tha me vehte, - por s'po e gjej!..."

- Mirë, pra, hajde shkojmë në shtëpi. - Dhe të dy, nanëe bir, pranë e pranë, tue kuvendue, u nisën për në shtëpi. Në fund të rrugës takuen Mrikën e Ded Gjokolës, me bucelë në shpinë e kokëulun, shpejtonte hapin për të ra rreth Drinit.

-Ku shkon, moj Mrikë!-tha nanë Fatimja, asht vonë. -Ka ra hieja në Dri.

- Due me mbush bucelën. Vllaut i ka ra në mend me vra nji bletë për pashkët. Na ka ardhë edhe nji mik i shtëpisë sonë e duam me gostitë me mjaltë.

-Oh sa mirë, por. . Mos u tut, po të jap Sufën me të ruejt. Mandej nana iu drejtue të birit: -Dëgjo, Sufë, rri këtu fund udhës e prite Mrikën e unë po shkoj të mjel lopën. Dedës po i thom se asht Sufa rreth Drinit e të mos ketë merak për Mrikën. Hajt, pra, të pastë nana, - dhe u nis për në shtëpi.

Sufa gati sa nuk iu hodh në qafë nanës e ta puthë nga gëzimi.

"Sa e mirë asht nana e jeme!... " - mendoi ai me vehte. O Zot! Duket po më ndih edhe ti, që e sjell kaq mbarë... Sonte qoftë natë e mirë dhe mbarë, se kam me ja thanë copë. Mendoi Sufa!

-Ma mirë po bije me ty deri rreth Drinit, moj Mrikë!- tha Sufa.

**3**

-Si të duesh, or Sufë!- ia ktheu Mrika, pa ja lëshue sytë, por me za të plotë. Zhurin e kaluen pa ba za. Kur ranë rreth Drinit, Mrika e hoqi tërkuzën qafe dhe e lëshoi bucelën në ranë e mandej nisi ta mbushë. Ujët binte në bucelë me zhurmë. Sufa lëshoi disa gurë n'ujë tue luejt e mandej i tha Mrikës me gjysëm zani:

-Mrikë!...

Ajo ktheu kryet me të shpejtë dhe e pa drejt e në sy. Shikim si ky Sufa kurrë nuk kishte pa. Dy sytë e Mrikës e therën si shigjeta.

-Ç'ka don?

- A ke gjetë ndonjiherë tërfojë me katër fletë?

- Ç'ka më duhet? Nuk e kam kërkue se edhe mund ta gjej, livadhet e fushat tona janë plot.

-Eh se sa kushton! Pa gjeje, pa ta shofish se sa kushton. Ajo nuk blehet me pare. Edhe trojet janë ma të lira se ajo...

-Kush ta ka thanë?

-Nji shoku jem.

-Mos e beso, s'asht gja. Edhe unë kam pas ndie gjyshen, që folte për tërfojën me katër fletë. Janë përralla, or Sufë... Nuk ka tërfojë me katër fletë, qiell e tokë të bashkojsh. Bucela u mbush. Sufa e rroku atë dhe e ngriti me dy duert, kurse Mrika ktheu shpinën që të ujdisë bucelën e randë plot ujë.

-Po si të kishte thanë gjyshja ?... -vazhdoi Sufa teksa po i mbante bucelën.

-Ti e di vetë, or Sufë... U duhet djemve që u teket për ndoj cucë në katund, se me tërfojën thonë se i rrejnë e fitojnë jaranen! Mrika kishte kthye duert prapa e priste që Sufa t'i zgjatëte tërkuzën, po ia po bante naze, tue u rrekë sikur ishte ngatrrue tërkuza. Ai po mendonte se si Mrikën, bashkë me bucelën, t'i përlante në krah e të fluturonte. Iu duk vehtja si dif!

-Më duhet nji fletë ksisoji, Mrikë domosdo më duhet ndihmë ta gjejmë, në ke zemër!

-Kujt do të ja japësh? Thuej të drejtën e Zotit e mos e fsheh, se do Zoti e të ndihi edhe pa tërfojë. Sufa i kapi dorën e nisi të ja shtrëngonte e të ja fërkonte si i dehun. Po, ai ishte dehun nga nji raki e fortë që e ndez shpirtin si prush!

-Ty Mrikë, ... . Mrikë, ty po të thom, ty due me ta dhanë e askujt tjetër! Nuk flej, për ty, . . Mrikë!... Po më shtie të gjallë në dhe. Besomë, shpirtin ta kam ba kurban, ty, Mrikë! Besomë, Mrikë!... Mrika u turbullue edhe ma keq, po ma në fund e lidhi bucelën vetë dhe skucun flakë në fytyrë u kthye të niset për në shtëpi, por Sufa, që ishte nxe, sikur kishte marrë zjarrm, lëshoi duert mbi gjinjët e saj, që ishin nda nga terkuza e kishin dalë ma fort në pah, në të dy anët e gjoksit të Mrikës dhe dora e djathtë, si pa dashtë u shtrëngue ma shumë. Sufa kujtoi se kishte në dorë bash nji pamel zhuri. Kurse vajza thërriti oh! Dhe i luteshe me nji za të dridhshëm:

- Sufë, Sufë largo duert, mos ma cek nderin!...

- Fol, Mrikë, Mrikë, rrimë nji çikë ndër degë të shelgut? Mrikë të due fort!... Askush nuk na shef, veç valëve të Drinit e ato ikin e nuk folin gja. Beso , në ke zemër, Mrikë!... Vajza nuk bante za. Tamthat po i rrifshin fort e zemra gati sapo plaste kraharorin. Edhe ajo u turbullue si kurrë njiherë, Zemra po e tradhëtonte. "O Zot, si u turbullova kështu... " mendonte Mrika me vehte, kur me gjithë bucelën në shpinë ishte në krahët e Sufës, i cili e kishte pushtue e duert s'i shqitëte prej gjoksit, si të kishte zanë nji shqiponjë!...

* * *

Dedë Gjakola ishte i gëzuem pa masë, se për fat të mirë, atë natë që do të vrasë bletën i erdhi nji mik i mirë:Mark Jovani. Ai i kërkoi vajzën, Mrikën, për mikun e vet, që siç thoshte Marku, kishte treqind kokë dhi e dhen, e konaku i tij ishte për treqind pushkë. Tepsijat ishin mbushun me hoje. Miku kishte kapun nji copë të verdhë, e mjalti i kullonte duerve. Ai lëpinte duert e gishtat dhe sytë nuk ia ndante Mrikës, e cila rrinte kokëulun e tue ndihmue të jatin. Edhe ajo e kishte mendjen tek Sufa.

-Ambël si kjo mjaltë na vaftë miqësia, or Dedë!- tha Marku.

-Të baftë mirë, e mirë se të ka pru Zoti në shtëpinë tonë! – ia priti Deda .

-Miq si ty pritshim gjithmonë, or Mark!

**4**

Të nesërmen u hap fjala në katund se Mrika e Dedë Gjokolës na qenka fejue me nji zengjin, përtej Drinit. Por burri na qenka siç thoshin disa që e njifshin gjysmë budallë e me një moshë mbi dyzet vjeç. Lajmi e theri në zemër Sufën e shpresat iu prenë. Mbas tre katër ditësh edhe Stafë Bitri i zuni nuse të vëllait Sufës. Nuse për kryet e nuses. Thonë se ishte flokë verdhë si cucë Mërskovi. Vajzat e përtej Drinit janë të hijshme e të shëndosha, por kjo nuk e gëzoi fare Sufën. Edhe katundarët nisen me thanë, se Mrikën e Dedë Gjokolës e Sufë Bitrin i ka marrë fejesa për keq, po ligen çdo ditë e po bahen për ibret sikur pinë uthull e jo mjaltë e qumësht, që u ka falë Zoti boll. Zakonisht, në këto anë dasmat bahen "Shëmrijes", që bije aty nga 15 gushti, me kalendarin e vjetër. Në katund do të baheshin shumë dasma. Do dilte nuse Mrika. Edhe Sufë Bitri do të merrte nuse nga përtej Drinit. Mrika e Dedës e Sufë Bitri ishin takue shpesh, por askujt nuk i kishte vojt mendja për të keq e sidomos tash që i fejuen dhe që sipas kanunit, çdo gja kishte marrë fund. "Ato janë si një familje", - thoshin katundarët por At Përgjoni, prifti i katundit, sikur i kishte pa një ditë të dy së bashku prapa kishës e bile i kishte pa keq, tuj u puthë e përqafue por asgja nuk tha. Nji ditë ai e kishte ftue Mrikën që të rrëfehesh. Vajza e zanë ngushtë në prangun e martesës, shkoi në kishë dhe u rrëfye, fije për pe, përpara At Pergjonit.

-Zoti qoftë me ty, moj Mrikë, harroje Sufën!- i tha prifti.

-Aman, At, aman!... - luteshe ajo e gjunjëzueme para priftit. O Sufën, o do të mbytem në Dri! e due atë si vehten teme! Ai ma ka marrë zemrën! Çdo gja ja kam dhanë atij, o At i shenjtë! Prifti i kishte lëshue sytë si me inat Mrikës e mandej i kishte folë:

-E ke në besë Sufën? Mos të ka gabue e mandej të le në rrugë!...

-Si ty, o At e kam në besë, si perëndinë! Ai po vdes për mue, më don fort. E kam provue dashuninë e tij të dlirtë.

-Shko, pra dhe nesër eni me Sufën këtu. Do t'ju ndihmoj sa të mundem... do t'ju bekoj! Mrika u ul, i puthi kambët priftit, por ai e ngriti...

-Shko, shko!. .

At Pergjoni, vetëm ka emnin prift, por e duen të dy kastet. Edhe muhamedanët e dëgjojnë dhe e respektojnë. Sa familje ka pajtue ai midis tyne. Sa i mirë asht, edhe pse nuk e ka mirë me ata kryetarët e fesë së qytetit, prapë së prapë e duen shumë.

... Dielli ishte ngritë e gjinkallat të çjerrshin veshët. Sufa, si kceu gardhin nga prapa kishës, hyni në bahçen e saj të mbushun plot me pemë. Zemra i rrihtë fort dhe ishte mjaft i trembun: "Ç'po baj kështu, po sikur të më shofin nana me vëllanë?" Por në atë çast u ndie nji za:

-Hajde bir, hajde, pse vjen si hajdut? -Ishte At Pergjoni e u përkul para atij në shej nderimi.

- Hajde mbrenda...

Sufa e Mrika qëndrojshin krah njeni-tjetrit, e At Pergjoni, që ishte përballë, i bekonte ata me fjalët e tij të zakonshme. Kur ceremonia e thjeshtë kishte mbarue. At Pergjoni zbriti shkallët, u afrue e si i puthi në ballë, u tha:

-Perëndia qoftë me ju, Zoti u faltë dashuninë. Rruga asht e randë, por dashunia, as ngrin e as digjet. Ajo rron e ndriçon të dy botët. Lum ai që jeton me të në zemër. Tani do të merrni udhën e pyllit. Atje asht nji shenjtore, ku shërben nji katundar i mirë. Ai do të ju bashkojë me njerëz të sigurtë. I thoni se na dërgoi At Pergjoni, i thoni se na bekue At Pergjoni. Rruga e mbarë, bijtë e mi.

Dy të rinjtë u panë sy në sy. Mrikës i rodhën lot, kurse Sufa i tha asaj ngadalë:

- Unë e kërkova me ditë të tana, nëpër fushat e livadhe një tërfojë me katër fletë, por ja se këtë e paske pas në gji ti, o Mrikë e dashtun. Mandej ata të dy, me zemrat e bashkueme, muerrën arratinë. . Nuk kishin armë në dorë, po kishin nji armë të fortë si rrufeja, dashuninë e dlirtë, që s'njef fe e ligje, që se lidh me hekura, që s'e varros kurrë në dhe... U ngrit në kambë gjithë katundi, tue kërkue ata që tradhëtuen fe e zakon. Te kisha u grumbulluen të gjithë. "Tregona, - thanë Deda me Stafën, ç'të bajmë? Ku ti gjejmë? Se kjo s'ka ndodhë deri më sot. Na kena mbetë me vu në krye shami të zeza, për turpin që na ra në dyer".

- Jepni dorën njëni- tjetrit, e mos mbani mëni, dashunia nuk njeh fe e ligje... Ajo asht vetë Perëndia, fytyra e tij.

-Do t'i djegim së gjalli, po i zumë!- thanë ata nji zani, Edhe në qiell të venë do ti zamë. . Katundarët nuk banë za. Ata s'e kuptojshin ç'po ndodh, e si do të vejë kjo punë. Ky ishte fillimi, fillimi i nji kanuni të ri njerëzor...

homazh

**Jeta dhe vepra e Bajram Hysenit ka qenë në përputhje të plotë me ligjësitë e karakterit të njerëzve të mëdhenj, të idealistëve, që nuk përkulen kurrë para asnjë vështirësie. Pa dyshim, Bajram Hyseni është njëri prej njerëzve të tillë.**

# Lamtumirë Balzaku shqiptar!

***Më 30 prill 2011 u nda nga jeta në moshën 82-vjeçare, atdhetarit, veterani i luftës antifashiste të popullit shqiptar, poeti e publicisti i mirënjohur dibran, Bajram Hysen Kovaçi***

*Nga e majta në të djathtë: Isuf Hyseni, Bajram Hysenit dhe Ali Hoxha (1 korrik 1964)*

Atdhetarit, Veterani i Luftës Antifashiste të popullit shqiptar, poeti e publicisti i mirënjohur dibran, Bajram Hysen Kovaçi, në moshën 82-vjeçare, u përcoll në banesën e fundit më 1 Maj 2011.

Bajrami lindi me 29 janar 1929 në katundin Laçes të Çidhnës në Dibër të Poshtme. Arsimin fillor e kreu në fillim të viteve '40 në Internatin e famshëm të Kastriotit, arsimin e mesëm në Shkollën e Bashkuar të oficerëve, dhe arsimin e lartë në Universitetin e Tiranës në Fakultetin e Histori-Filologji, dega Gjuhë-Letërsi.

Emri i Bajramit u bë i njohur në gjithë krahinën e tij, jo vetëm për pjesëmarrjen e tij në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare në moshë të re, qysh 13-14 vjeçare dhe me pranimin e tij në parti në moshën 15 vjeçare, por edhe për trimërinë dhe zgjuarsinë e tij, si dhe për kontributin që dha në ushtri si kuadër drejtues, sidomos në organet e shtypit qysh në vitet e para të çlirimit, në mënyrë të veçantë për reportazhet e tij direkt nga vija e frontit, në pasqyrimin e heroizmit të ushtrisë shqiptare në luftën për mbrojtjen e kufijve të atdheut nga provokacionet e monarkofashistëve grekë në gusht të vitit 1949, ku edhe ai vet luftoi heroikisht në vijën e parë të frontit, si oficer i ndërlidhjes i ushtrisë shqiptare. Krijimtaria e tij letrare artistike dhe publicistike është pasqyruar gjerësisht në organet e shtypit të kohës, herë me emrin e tij të vërtetë, por edhe me pseudonimin "Ostush Kastrioti". Vëllimi i parë artistik i tij "Flaka" botuar në vitin 1958 ka lënë mbresa të pashlyera ndër lexuesit. Bajrami ka shërbyer si kuadër drejtues dhe gazetar në ushtri në gazetën "Luftëtari", dhe sekretar Kolegjiumi i Revistës "Policia Popullore". Deri në vitin 1963 ai mbante gradën Major. Ka qenë anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe i Artistëve të Shqipërisë. Ka qenë dekoruar me shumë urdhëra e medalje të luftës e të punës. Për veprën e tij meriton të shkruhen vëllime të tëra studimore në këndvështrime të caktuara shkencore e artistike, por ajo që duhet të theksojmë këtu janë dy momente, të cilat e bënë të njohur personalitetin e Bajramit në mbarë Dibrën dhe më gjerë, **së pari:** trimëria dhe guximi i Bajramit në Konferëncën e Partisë për Tiranën në vitin 1956, kur e bllokoi Enver Hoxhën me dy pyetjet që ia bëri publikisht në sallën e konferencës:

"1-Përse u dogj e gjithë Fushalia, Laçesa dhe një pjesë e fshatit Blliçe në rrethin e Dibrës në korrik të vitit 1944, në një kohë që lufta kishte mbaruar dhe kur Halil Alia me forcat e veta ishte larguar dhe se a duhet trajtuar si armik edhe sot e kësaj dite i gjithë populli i asaj krahine, ashtu siç vazhdon të trajtohet nga lufta e klasave duke mos shkolluar deri më tani në asnjë profesion asnjë nga djemtë e asaj zone?

2-Si shpjegohet që edhe sot e kësaj dite (1956-A.H.) Murat Kaloshi vazhdon të quhet bashkëpunëtor me fashizmin, në një kohë kur Murat Kaloshi qysh me 6 prill 1939 është larguar nga Shqipëria bashkë me mbretin Zog I, dhe ai vet ka vdekur në emigrim në Turqi pa u kthyer kurrë më në Shqipëri, ndërsa djali i tij Sef Kaloshi ka qenë internuar nga fashizmi në Ventotene të Italisë, më 1940, dhë më pas ka luftuar me heroizëm në brigadat partizane kundër pushtuesve italo-gjermanë, pavarësisht se në vitin 1946 ai devijoi duke dalur në mal dhe u vra nga partizanët?"

Me këto dy pyetje të karakterit politik që mund të bëheshin vetëm prej një atdhetari dhe trimi të çartur, ai vërtet e bllokoi, e zuri "shah-mat" Enver Hoxhën, i cili, pyetjes së parë nuk iu përgjigj fare, ndërsa së dytës, pyetjes për Murat Kaloshin, iu përgjigj se "e kishin informuar gabim", por ama, këtu ai e futi edhe vetveten në "rrethin e zi" të diktaturës, nga ku më pas edhe pse arriti gradën e Majorit në ushtri dhe me detyrën e sekretarit të kolegjiumit të revistës "Policia Populllore", do ta nxirrnin në lirim nga ushtria në vitin 1963 dhe vetëm një vit më pas do ta prangosnin duke e dënuar me 5(pesë) vjet burg së bashku me dy poetët e tjerë, Jorgo Bllacin dhe Pano Taçin, me motivin "për agjitacion e propagandë kundër Partisë".

Por, ajo që e përjetësoi Bajramin në kujtesën e gjithë popullit të Dibrës, duke e kthyer më pas në një simbol të atdhetarisë e të qëndresës heroike ndaj diktaturës komuniste, është pikërisht arrestimi i tij për të dytën herë, në Tiranë, më 10 qershor 1971, në të njëjtën ditë dhe orë me bashkëfshatarin e tij, ish-oficerin Hakik Kutën, po nga fshati Laçes, të cilët më pas pasi i bashkuan edhe me vëllain e Bajramit, Kapiten Isuf Hysen Kovaçin, që e kishin arrestuar një vit më parë në Berat, ku ai shërbente si oficer aviacioni në Kuçovë, i morën dhe në vjeshtën e vitit 1971 i gjykuan publikisht në sallën e kinemasë së qytetit të Peshkopisë për të terrorizuar psikologjikisht gjithë popullin e Dibrës me gjykimin e të ashtuquajturës "banda" e ushtarakëve të kryesuar nga Major Bajram Hyseni. **Ky qe momenti tjetër** ku Major Bajram Hyseni, do të shfaqte edhe një herë tjetër gjithë trimërinë dhe guximin e tij deri në vetmohim para trupit gjykues të inkuizicionit të diktaturës komuniste, kur ai i shkatërroi akuzat false të parafabrikuara me dëshmitarë të rremë, të tilla si ajo që "Bajrami, gjoja, qenka lidhur me agjenturën e UDB-së Jugosllave, në Vaun e Dejës, kur ajo (agjentura Jugosllave) kishte ardhur atje me një nëndetëse vetëm për t'i dhënë postën Bajramit".

Bajrami jo vetëm u qëndroi heroikisht të gjitha torturave fizike e psikologjike të prokurorëve dhe gjykatësve inkuizitorë, por edhe i sfidoi, bile edhe i ironizoi ata në prani të të gjithë publikut kur iu drejtua prokurorit në sallën e gjyqit me një kundërpyetje të tillë:

"Po a ka mundësi që të futet nëndetësja nëpër Drin e të arrijë deri në Vaun e Dejës, pa u zbuluar, vetëm për të më prurë mua postën?! A ka logjikë njerëzore e shkencore që e pranon një akuzë të tillë, kaq të papranueshme që të mund të lundrojë nëndetësja nëpër Drin, kur ai në vende të caktuara kalohet edhe me va (në këmbë)?!"

Me ilaritetin që u shkaktua në publik nga një alibi e tillë, në sy të publikut u shkatërrua si flluskë sapuni e gjithë akuza false e diktaturës. Megjithë diskreditimin dhe shkatërrimin e akuzës nga ana e Bajramit, diktatura e dënoi Bajramin për të dytën herë edhe me 25 vjet të tjera burg, duke i plotësuar 30 vjet gjithësej, nga i cili doli gjallë vetëm kur e nxorën komisionerët e të Drejtave të Njeriut, pas shembjes së Diktaturës Komuniste, në vitin 1991, duke ia tejkaluar në vitet e burgut edhe Nelson Mandelës, legjendës botërore dhe simbolit të rezistencës ndaj rregjimit të aparteidit racist të Afrikës së Jugut në shekullin e kaluar.

Një parantezë: Për hir të së vërtetës, e gjykoj të theksoj këtu se ishte momenti historik, ishin rrethanat e politikës ndërkombëtare dhe të luftës kundër politikës së aparteidit, diskriminimit racist të Republikës së Afrikës së Jugut në atë kohë, në fund të shek.XX, që e ktheu në legjendë Nelson Mandelën, ish-presidentin e Republikës së Afrikës së Jugut. Ndërsa, nisur nga këndvështrimi i gjatësisë së vjetëve të burgut, aq më tepër nga shkalla e torturave dhe e vuajtjeve të heronjve të demokracisë shqiptare, ish-të burgosurve politikë shqiptarë që i mbijetuan trajtimit çnjerëzor të diktaturës komuniste në Shqipëri, pra Nelson Mandela as që mund të krahasohet me heronjtë e rezistencës shqiptare për liri e demokraci. Nisur vetëm nga kushtet dhe komoditeti i dhomave të izolimit të burgjeve të Johanesburgut të Afrikës së Jugut: të gjera, të ajrosura e me dritë, të pajisura edhe me tavolina pune e karrige, bile, edhe me televizor, në të cilat ka jetuar e punuar Nelson Mandela, gjithkush konkludon se ato as që mund të krahasohen me qelitë (birucat) e burgut të Burrelit e me dhomat e kampeve të Spaçit, të Qafë-Barit etj, të denja për ilustrimin e rrathëve të "Ferrit" të Komendisë Hyjnore të Dante Aligierit, në të cilat kanë mbijetuar ish-të burgosurit politikë shqiptarë. Kur mendon se në kushte të tilla jo vetëm mbijetuan ish-të burgosurit politikë shqiptarë, por nga mendja, zemra dhe dora e tyre kanë dalë edhe kryevepra të tilla si ato të Bajram Hysenit (sigurisht në dorëshkrim e të pabotuara, disa edhe të zhdukura nga organet e diktaturës), si p.sh. poema "Kanga e Cucave" etj. (për gjithkënd që e lexon atë poemë, është e pamundur ta besojë se një kryevepër e tillë lirike është krijuar në qelitë e burgut të Burrelit), është një argument i pakontestueshëm për të nxjerrë konkluzionin se Bajram Hyseni, pa dyshim, është jo vetëm njëri nga poetët lirikë më të mëdhenj të letërsisë shqipe të kohës sonë, por edhe një nga heronjtë e vërtetë të luftëtarëve për liri e demokraci të kombit shqiptar, por i mbetur në hije sa qe gjallë.

Jeta dhe vepra e Bajram Hysenit ka qenë në përputhje të plotë me ligjësitë e karakterit të njerëzve të mëdhenj, të idealistëve, që nuk përkulen kurrë para asnjë vështirësie. Pa dyshim, Bajram Hyseni është njëri prej njerëzve të tillë.

Ashtu siç ishte vetë Bajrami në këtë dynja, i dashur me të gjithë, bile poet i dashurisë për njeriun dhe natyrën, edhe Zoti ia mori shpirtin atij në një ditë të bukur pranverore siç është dita e 1 Majit, dhe e nisi për në xhennet (parajsë). Por, ashtu siç i shkoi jeta e kësaj dynjaje me plot tallaze, paska qenë caktuar prej Zotit edhe dita e vdekjes së Bajramit të ndodhte, edhe kjo sipas unitetit të të kundërtave, në një atmosferë të nxehtë politike, siç janë këto ditë fushate për zgjedhjet e pushtetarve vendorë të 8 majit 2011, ku klasës politike as që i shkon mendja se ka vdekje, e jo më t'i shkojë ndërmend se ka detyrime për tu bërë nderimet e fundit personaliteteve shoqërore të tilla si Bajram Hyseni, të cilit i detyrohet shumë e gjithë shoqëria shqiptare. Në këtë aspekt është për tu habitur se në të njëjtën ditë që u varros veterani i Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare dhe i Demokracisë në Shqipëri, poeti dhe shkrimtari Bajram Hyseni, mediat shqiptare përhapnin lajmin e vdekjes së shkrimtarit latino-amerikan, 99 vjecarit Sabata, vetëm sepse ai ishte me origjinë arbëreshe, ndërsa për heroin e vërtetë të demrokacisë shqiptare, poetin dhe veteranin Bajram Hyseni, nuk u dha asnjë lajm, asnjë mesazh, të paktën nga Shoqata e ish-të burgosurve dhe të persekutuarve politikë, edhe pse ishin vënë në dijeni për këtë ngjarje.

Nuk qenka për tu çuditur se historia u përsëritka, pasi edhe personalitete botërore të tilla si shkrimtari i madh francez Honore de Balzak, kur u nda jeta, është përcjellë nga kjo botë për në banesën e fundit vetëm me 6 (gjashtë) vetë.

**ALI HOXHA**
Tiranë, më 5 Maj 2011



NEKROLOGJI

## Për mikun e shokun tonë të paharruar Shahin Kamberi

Më datë 7 maj nga një sëmundje e shpejtë, infarct në zemër e ndau nga jeta mikun e shokun tonë shumë të mirë Shahin Kamberin. Shahini lindi më 1932 në Zimur të Dibrës por që nga viti 1955 jetoi e punoi në qytetin e Peshkopisë. E kush nuk e kujton drejtorin e Kinemasë Peshkopi, përgjegjësin e qendrës ekonomike të arsimit në Dibër etj. Shahini bëri shumë emër e la mbresa të pashlyera në ndërtimet e dhjetëra e qindra shkollave 9-vjeçare e të mesme në të katër anët e Dibrës, nga Golloborda në Lurë e Kala e Dodës, në rrugën e Skënderbeut në Sinë të Çidhnës në qytetin e Peshkopisë etj.

Shahin ishte shok i mirë e besnik kërkues llogarie dhe shumë I komunikueshëm me njerëzit në jetë e në punë. I kishte hije mexhelisi oda dibrane po edhe tavolina I kemi të freskëta bisedat alegorike të shokut.

Kishte aftësi e zgjuarsi natyrore që futej në muhabet me çdo lloj moshe e kategori njerëzish. Nipërit e mbesat e mia kur venim te Shahu dhe vinin në Tiranë më thonin: Ah more gjysh u kënaqem me gjyshin Shah na pyeste për shkollën, për filmat, për internetin dhe na jepte porosi mësoni edhe gjuhë të huaj se sot e kërkon koha.

Shahini, me dhimbje u nda nga djali, Hazbi, vëllai Xhabir, niprit e mbesat nga motrat nga komshitë e vet që e respektonin dhe e donin shumë, nga shokët dhe miqtë e tij.

Me të drejtë Bajram Shajku e Rrahman Çenga thanë në mort na ka lënë boshllëk të "madh Shahu në qytet e në lagje...

Qoftë i paharruar emri i tij ngushëllimi i familjes.

**BAJRAM STOJKU**
**RRAHMAN ÇENGA**
**MUSA RAMA**
**RAMIZ LELA**
**BEQIR SHEHU**
**SHUAIP METHASANI**

# Biblioteka e autorëve dibranë*


















**Këto dhe shumë botime të tjera të autorëve dibranë mund t'i gjeni pranë librarisë "M&B"**

**Adresa: Rruga "Zenel Baboci", Pall. Ferar, Tiranë (Pranë Selvisë)**
**Tel. 00355 4 22 33 283.**
**Cel. 069 20 68 603**
**e-mail: mbbotime@gmail.com**

* Janë reklamuar vetëm botimet që mund ti gjeni pranë librarisë "M&B"






























cyan magenta yellow black